

# Barometri i progresit të Kosovës për vitin 2021

Vlerësim 8-dimensional i fushave kryesore të politikave



Nëntor 2022

# Barometri i progresit të Kosovës për vitin 2021

Vlerësim 8-dimensional i fushave kryesore të politikave

**Ky publikim mbështetet nga:**

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

**Deklaratë mohimi:** Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorit.

Grupi për Ballkan (BPRG)

## AKRONIMET

<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>PATP</b>	Politikat Aktive të Tregut të Punës
<b>PKK</b>	Pika e Kalimit Kufitar
<b>BPRG</b>	Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>KEED</b>	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
<b>PKGE</b>	Projekti për Konkurrencën dhe Gatishmërinë për Eksport
<b>SIMR</b>	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve
<b>KPP</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>OShC</b>	Organizata e Shoqërisë Civile
<b>CRM</b>	Tregu i Përbashkët Rajonal
<b>KEDh</b>	Kundërshtimi i Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>PZAP</b>	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
<b>KE n</b>	Komuniteti i Energjisë
<b>RrESCA</b>	Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
<b>PRE</b>	Programi i Reformës Ekonomike
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>REA</b>	Agjenda e Reformës Evropiane
<b>IHD</b>	Investimet e Huaja Direkte
<b>LHT</b>	Luftëtarët e Huaj Terroristë
<b>BPV</b>	Bruto Prodhimi Vendor
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>AAK</b>	Agjencia Kosovare e Akreditimit
<b>QAK</b>	Qendra Arsimore e Kosovës
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
<b>AKIPN</b>	Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>KGjK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>PKRE</b>	Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve
<b>PKEK</b>	Plani Kombëtar i Energjisë Klimatike
<b>PKZMSA</b>	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
<b>NRMAR</b>	Nisma Rajonale për Migrim, Azil, Refugjatë
<b>KKZ</b>	Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>PMV</b>	Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit
<b>PMMK</b>	Planet e Menaxhimit të Mbeturinave Komunale
<b>KKZhQ</b>	Këshilli Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm
<b>PKEK</b>	Plani Kombëtar i Energjisë Klimatike
<b>NZE</b>	Ndërtesë pothuajse me Zero Energji
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>KPSH</b>	Kujdesi Parësor Shëndetësor
<b>KVV</b>	Komisionet e vendvotimeve
<b>SHPPF</b>	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjësia Financiare
<b>PVNS</b>	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve

<b>PEEK</b>	Projektet e Eficiencës së Energjisë Komunale
<b>QRB</b>	Qendra Rajonale e Bashkëpunimit
<b>QRBR</b>	Qendra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor
<b>ESSH</b>	Ecni si në shtëpi
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>SZHQ</b>	Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>PBEJ</b>	Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>TKT</b>	Traktati i Komunitetit të Transportit
<b>TIP</b>	Trafikimi i Personave
<b>TiT</b>	Trainimi i Trajnerëve
<b>BP</b>	Ballkani Perëndimor
<b>FBP</b>	Fondi i Ballkanit Perëndimor
<b>AAP</b>	Arsimi dhe Aftësimi Profesional

**TABELA E PËRMBAJTËS**

<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE</b>	<b>11</b>
<b>METODOLOGJIA DHE SFIDAT</b>	<b>12</b>
<b>DIMENSIONI I: SUNDIMI I LIGJIT</b>	<b>17</b>
Përmbledhje dhe Analizë	18
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	19
Konkluzion	45
<b>DIMENSIONI II: TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË THEMELORE</b>	<b>46</b>
Përmbledhje dhe Analizë	47
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	48
Konkluzion	53
<b>DIMENSIONI III: DEMOKRATIZIMI</b>	<b>54</b>
Përmbledhje dhe Analizë	53
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	54
Konkluzion	75
<b>DIMENSIONI IV: EKONOMIA</b>	<b>77</b>
Përmbledhje dhe Analizë	78
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	79
Konkluzion	84
<b>DIMENSIONI V: ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM</b>	<b>86</b>
Përmbledhje dhe Analizë	87
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	88
Konkluzion	88
<b>DIMENSIONI VI: ARSIMI</b>	<b>100</b>
Përmbledhje dhe Analizë	101
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	102
Konkluzion	106
<b>DIMENSION VII: SHËNDETËSIA</b>	<b>107</b>
Përmbledhje dhe Analizë	108
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	109
Konkluzion	112
<b>DIMENSION VIII: MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË</b>	<b>113</b>
Përmbledhje dhe Analizë	114
Gjetjet për çdo Indikator dhe Nën-indikator	116
Konkluzion	117
<b>ANNEKSI I. PROGRESI I KOSOVËS NË NUMRA</b>	<b>119</b>

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në krijimin e institucioneve funksionale, konsolidimin e demokracisë dhe zbatimin e prioriteteve kryesore të BE-së. Kosova ka arritur të organizojë zgjedhje të lira dhe të drejta, të krijojë një administratë publike funksionale, të përmirësojë kornizën ligjore për të drejtat dhe liritë themelore, të arrijë progres në luftën kundër terrorizmit, të përmirësojë kapacitetet e saj për menaxhimin e migrimit ilegal, të punojë drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut si dhe ka arritur një sërë marrëveshesh me Serbinë në kuadër të procesit të dialogut. Për më shumë, ka ngritur prezencën e saj në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale dhe ka përmirësuar fushat e politikave që lidhen me konektivitetin e qëndrueshëm dhe sektorin e energjisë.

Megjithatë, shumë sfida mbeten ende. Paqëndrueshmëria politike e shkaktuar nga organizimi i zgjedhjeve të shpeshta shënon një pengesë të vazhdueshme. Ndryshimet e shpeshta në qeveri kanë afektuar administratën publike, në të cilën ndikimi politik mbi emërimet dhe shkarkimet mbetet një problem i përsëritur.

Në vitin 2021, Kosova ka vazhduar të përmirësoj më tej kornizën legjislativë me miratimin/ndryshimin e ligjeve dhe strategjive, megjithëse zbatimi i tyre mbetet një sfidë e vazhdueshme. Progresi është kryesisht evident në sundimin e ligjit, duke pasur parasysh përpjekjet e shtuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe rritjen e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit gjyqësor. Zhvillime të ngjashme vërehen edhe në fushat e demokratizimit dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. Kuvendi ka ratifikuar mbi 13 marrëveshje bilaterale dhe ndërkombëtare, megjithatë nevojiten më shumë përpjekje në fushat ku Kosova është më larg progresit, si arsimit, të drejtat e njeriut, shëndetësia, ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Kosova duhet të shtoj përpjekjet e saj për të arritur përparim më domethënës në agjendat e lidhura me BE-në. Përpjekjet duhet të rriten edhe më tutje në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore, veçanërisht lirinë e shprehjes, lirinë ndaj religjionit dhe lirinë e medias, përmirësimin e stabilitetit politik, reformën zgjedhore, rritjen e punësimit dhe reduktimin e punësimit jo-formal. Nevojiten gjithashtu përpjekje të konsiderueshme për diversifikimin e furnizimit me energji, përmirësimin e cilësisë së ajrit, përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe kujdesit shëndetësor, rritjen e pranisë në nismat rajonale dhe përsheptimin e progresit në dialogun me Serbinë të cilat janë disa nga prioritetet më imediate për periudhën e ardhshme.

Progresi i Kosovës për vitin 2021 matet përmes një qasje 8-dimensionale duke u fokusuar në sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, demokratizimin, ekonominë, zhvillimin e qëndrueshëm, arsimin, shëndetësinë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Duke përdorur 14 indikatorë, 65 nën-indikatorë dhe 234 mjete vlerësimi, ofrohet një pasqyrë e plotë e zhvillimit të Kosovës në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak (2020). Pavarësisht sfidave nga mungesa e koordinimit ndërinstitucional për menaxhimin dhe ofrimin e të dhënave, publikimin e vonuar apo mungesën e këtyre të dhënave të grumbulluara për sektorë të veçantë, ky raport ofron një bazë të mirë për identifikimin e pengesave dhe fushave prioritare.

**SUNDIMI I LIGJIT** - Në vitin 2021, progresi i përgjithshëm në sundimin e ligjit vlerësohet si 'i kufizuar'. Megjithatë secili prej indikatorëve kryesorë siç janë: Gjyqësori, Lufta Kundër Korrupsionit dhe Lufta kundër Krimit të Organizuar kanë shënuar nivele të ndryshme progresi.

**Gjyqësori** - Pas miratimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit dhe Planit të Veprimit, institucionet e Kosovës kanë arritur progres shumë të mirë sa i përket kornizës ligjore. Progresi është evident edhe në llogaridhënie dhe transparencë si rezultat i funksionimit më të mirë të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve. Tutje, janë identifikuar disa përmirësime në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit, pasi raporti i rasteve gjyqësore të zgjidhura arriti në 50%. Pavarësia dhe paanshmëria janë përmirësuar gjithashtu. Kënaqshmëria e publikut me punën e gjykatave është rritur për 44%, ndërsa për 36% me punën e prokurorisë.

Qasja në drejtësi ka qenë e kufizuar, veçanërisht në rastet e grupeve të marginalizuara (LGBTIQ+ dhe komunitetet pakicë), ndërsa progres minimal është shënuar edhe në administrimin e drejtësisë. Në vitin 2021, numri i gjyqtarëve ka pësuar rënie për 5% ndërsa numri i prokurorëve për 4%. Progresi mungon në zgjidhjen e lëndëve të grumbulluara për shkak të rritjes së numrit të lëndëve të trashëguara nga vitet e mëparshme.

**Lufta kundër korrupsionit** – Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit në Kosovë (IPK), perceptimi publik mbi korrupsionin është përmirësuar paksa duke lëvizur nga 36% në vitin 2020, në 39% në vitin 2021. Gjithashtu, konfiskimi i pasurisë ka shënuar një rritje prej 53%. Sa i përket parandalimit të korrupsionit, rastet e trajtuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) janë rritur për 19%. Ndërsa, nuk është shënuar progres në masat kundër korrupsionit në nivele të larta ku në vitin 2021 janë hetuar vetëm 7 raste. Kjo për shkak të kornizës ligjore, konkretisht si pasojë e mos finalizimit të Kodit të Procedurës Penale. Përveç kësaj, Ligji për Agjencinë Korrupsionit (Ligji nr. 03/L-159) nuk është rishikuar ende zyrtarisht dhe zhvillimet lidhur me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë mungojnë. (Ligji nr. 04/L228).

**Lufta kundër krimit të organizuar** - Një lloj progresi është shënuar edhe sa i përket kornizës ligjore për luftën kundër krimit të organizuar me miratimin e Draft Kodit të Procedurës Penale. Gjatë vitit 2021, përderisa Strategjia e re dhe Plani i veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjia dhe Plani i veprimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ishin ende në proces hartimi, masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore kanë vazhduar të zbatohen me rritjen e aktakuzave të ngritura për 93%. E njëjta gjë nuk vlen për masat kundër krimit të organizuar, pasi që numri i aktakuzave është ngritur vetëm për 11%. Lufta kundër përdorimit të drogës/narkotikëve është një tjetër fushë e cila ka shënuar rënie, konkretisht aktakuzat në terren nga prokuroria në vitin 2021 janë ulur për 10%. Poashtu progres nuk është shënuar sa i përket Ligjit për Sigurinë Kibernetike dhe Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

**TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË THEMELORE** - Progresi i përgjithshëm mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në vitin 2021 vlerësohet të jetë pa 'asnjë progres'. Megjithatë, sipas nën-indikatorëve, janë shënuar nivele të ndryshme të progresit në: të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, sociale e kulturore si dhe kornizën ligjore.

**Të drejtat civile dhe politike** - Kosova ka përmirësuar pozitën e saj sa i përket barazisë gjinore. Gratë kryesojnë 8 nga 14 komisionet funksionale në Kuvend, ndërsa 6 nga 18 anëtarët e qeverisë janë gra, duke përfshirë dy zëvendëskryeministra. Institucionet e Kosovës kanë ndër marrë disa veprime në lidhje me të drejtat e fëmijëve duke krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për garantimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit, neglizhencës, dhunës fizike dhe mendore, apo veprimeve të tjera që mund të rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin, arsimimin apo zhvillimin e fëmijëve. Platforma e parë online “Edukimi në distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç” (ZHFH) është lançuar, megjithatë zbatimi dhe decentralizimi i shërbimeve për të ofruar të drejta të plota dhe të barabarta për fëmijët në nivel lokal mbetet ende një sfidë në vete. Një lloj progresi është shënuar sa i përket të drejtave të pakicave. Ndonëse ekziston një kornizë e mirë legislative, pakicat në baza etnike vazhdojnë të përballen me diskriminim. Progres minimal vërehet edhe tek grupet e marginalizuara (LGBTIQ+). Personat LGBTIQ+ vazhdojnë të jenë të marginalizuar politikisht dhe Kodi Civil i Kosovës ende nuk garanton partneritetet e së njëjtës gjini. Bazuar në Indeksin e Freedom House të vitit 2021, Kosova u klasifikua si ‘pjesërisht e lirë’, pa asnjë progres të shënuar në lirinë e shprehjes, lirinë ndaj religjionit dhe lirinë e asociimit.

**Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore** - Progresi i pamjaftueshëm është shënuar sa i përket të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Institucionet e Kosovës kanë avancuar kornizën ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtën për punë. Qasja e barabartë në tregun e punës për gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta dhe pjesëtarët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian vazhdon të jetë një sfidë në vete. Një sërë problemesh pengojnë realizimin e këtyre të drejtave siç janë mungesa e kontratave për një pjesë të madhe të punëtorëve, kushtet e këqija të punës, mungesa e sigurimit dhe mbrojtjes në punë si dhe rreziku i vazhdueshëm i ndërprerjes së kontratës. Për më tepër, përparimi i lehtë është vërejtur në të drejtën për qasje në arsim. Arsimi është ndikuar shumë nga përhapja e COVID-19, me ç’ rast Qeveria ka marrë masa të shpejta. Megjithatë cilësia e organizimit të mësimin në distancë mbetet e diskutueshme. Së fundi, rezultati i Kosovës në Indeksin e Freedom House për të drejtat pronësore ishte 1/4, gjë që tregon se nuk ka progres nga viti 2020.

**Korniza ligjore** - Ligji (Nr.08/L-013) për të drejtat pronësore për shtetasit e huaj nuk është miratuar në vitin 2021. Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore mungon, por ka progres në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024) i cili është miratuar në vitin 2020 (Plani i Veprimit është në proces të hartimit). Një version i ri i Ligjit (Nr. 02/L-31) për lirinë fetare duhet të miratohet, ndërsa Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës është miratuar por sipas të dhënave nuk po zbatohet në praktikë.

**DEMOKRATIZIMI** - Progresi i përgjithshëm mbi demokratizimin vlerësohet gjithashtu si 'i kufizuar'. Megjithatë, nivele të ndryshme progresi raportohen tek indikatorët kryesorë veç e veç: media dhe shoqëria civile, stabiliteti politik, zgjedhjet dhe administrata publike.

**Media dhe shoqëria civile** – Një lloj progresi është vërejtur sa i përket konsultimit të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve). Në vitin 2021, konsultimet publike për aktet/veprimet e qeverisë vazhduan të zhvillohen në mbi 98% e të gjitha dokumenteve të politikave dhe projektligjeve të publikuar. Progres është shënuar edhe në financimin publik të OSHC-ve. Raportimi bëhet çdo vit, ndërkaq informacioni është gjatë gjithë kohës në dispozicion të publikut. Krahasuar me një vit më parë, në vitin 2021, nuk është raportuar asnjë progres lidhur me lirinë dhe pavarësinë e medias. Sa i përket transmetuesit publik, në korrik të viti 2021, Kuvendi votoi për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së, pas refuzimit të auditimit dhe mosrespektimit të procedurave të prokurimit. Duke qenë se procesi i shkarkimit dhe i emërimit u klasifikua si transparent, të dhënat tregojnë se është shënuar një progres shumë i mirë në këtë drejtim. Nga ana tjetër, vërehet progres i pamjaftueshëm sa i përket cënimit të gazetarëve, pasi rastet e regjistruara të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave në vitin 2021 u rritën për 21%. Sa i përket sinjalizuesve, disa përmirësime janë të dukshme. Megjithatë, nuk raportohet asnjë progres në lidhje me kornizën ligjore në këtë fushë. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit (Nr. 04/L-44) për Komisionin e Pavarur për Media ishte planifikuar që të kalojë në Kuvend në vitin 2022. Me ndryshimin e këtij ligji, qeveria do të ndryshonte edhe Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës me qëllim të harmonizimit të tyre. Përveç kësaj, në vitin 2021, qasja në informacione publike dhe performanca e institucioneve mbikëqyrëse janë përkeqësuar.

**Stabiliteti politik** – Progres shumë i mirë është raportuar lidhur me funksionimin e qeverisë. Edhe pse periudha nga viti 2019 deri në vitin 2020 u karakterizua me paqëndrueshmëri politike dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare, qeveria Kurti II fitoi 50.3% të votave, duke fituar 58 vende në Kuvend (dhe më vonë duke marrë edhe një deputet tjetër nga grupi parlamentar i PDK-së). Për më tepër, kënaqshmëria e publikut me punën e qeverisë u rrit nga 21.3% në vitin 2020, në 59.1% në vitin 2021. Prosesi i formimit të qeverisë dhe transferimit të pushtetit ishte paqësor, gjë që vendosi Kosovën në renditjen e 44.340 përqindëshit të indikatorit të Bankës Botërore mbi Stabilitetin politik dhe mungesën e dhunës/terrorizmit dhe në këtë fushë tregon progres. Sa u përket marrëdhënieve në mes të qeverisë dhe opozitës, ato u karakterizuan nga mosmarrëveshje që rezultuan në mungesë të shpeshtë të partive opozitare në Kuvend. Kjo ishte veçanërisht sfiduese kur votimi kërkonte një shumicë prej 2/3, siç ishte rasti me marrëveshjet ndërkombëtare. Partitë politike megjithatë kanë mbështetur qeverinë në zgjedhjen e presidentit, duke shënuar një lloj progresi në marrëdhëniet mes tyre. Progres nuk është shënuar në funksionimin e institucioneve të pavarura, mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve. Përveç kësaj, në vitin 2021, pati një ndikim të padrejtë politik mbi emërimet dhe shkarkimet e zyrtarëve të lartë publikë dhe shërbyesve civilë. Sipas vlerësimit, nuk janë zbatuar ligjet në vijim: Ligji për Zyrtarët Publikë, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligji për Ndërmjetësim, Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji për Prokurimin Publik, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji i Punës, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, etj.

**Zgjedhjet** - Progres shumë i mirë është raportuar në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të vitit 2021. Ky progres përshkoi zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës të vitit 2021, të cilat në përgjithësi ishin të qeta dhe pa incidente serioze. Progres i mirë është shënuar më tej në fushatat e vitit 2021 për zgjedhjet lokale dhe atyre të përgjithshme, me përjashtim të zonave të banuara me shumicë serbe. Një lloj progresi është vërejtur po ashtu në saktësinë e regjistrimit të votuesve, i cili konsiderohet si një çështje sfiduese në të gjitha zgjedhjet; një numër i konsiderueshëm i personave të vdekur janë ende pjesë e listave. Për sa i përket zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, u raportuan parregullsi, veçanërisht në lidhje me numërimin e votave. Me këtë rast u kërkua një numër i madh ri-numërimesh, gjë që vonoi publikimin dhe certifikimin e rezultateve. Disa përmirësime u raportuan në zgjedhjet nacionale, edhe pse fushata nuk u zhvillua në përputhje me masat e vendosura për COVID-19. Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e grave, në vitin 2021 është bërë progres i kufizuar me vetëm 14 gra, ose 8% të kandidatëve për kryetar komune ishin gra. Në fakt, shumica e partive, përveç Lëvizjes Vetëvendosje, mezi e kaluan kuotën prej 30% të përfaqësimit të grave. Sipas të dhënave, nuk është shënuar asnjë progres në rishikimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në janar të vitit 2021, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere aprovoi në parim projektligjin për financimin e subjekteve politike, por ai nuk u miratua. Nuk raportohet për asnjë avancim në lidhje me ndryshimet në rregulloret e KQZ-së -ndryshimi/plotësimi i akteve



nënligjore (Rregullorja mbi zgjedhjet)- të cilat janë planifikuar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022.

**Reforma në administratën publike** – Progres në vitin 2021 është shënuar edhe në transparencën e prokurimit publik si rezultat i dy moduleve të reja të prokurimit elektronik. Arritje janë shënuar më tutje në digjitalizim pasi që e-Kosova ka rritur numrin e shërbimeve elektronike të ofruara për qytetarët; ndonëse të kufizuara. Gjithashtu, informacioni në portalin e transparencës fiskale të qeverisë ofrohet dhe është lehtësisht i qasshëm. Vlerësimi i Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiwe Financiare (SHPPF) i vitit 2021, ka treguar menaxhim të mirë të financave publike në Kosovë - si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në atë rajonal – me një numër parregullsish. Në përgjithësi, ka transparencë sa i përket buxhetit dhe zbatimit të tij. Cilësia e shërbimeve komunale ka rënë për 0,46% krahasuar me vitin paraprak (2020). Sa i përket shkarkimeve, nuk vërehet përparim për shkak të ndikimit politik në emërimet dhe shkarkimet e zyrtarëve të lartë publikë dhe shërbyesve civilë. Në qershor të viti 2021, pas shqetësimeve për ndikimin politik dhe emërimet jo të bazuara në merita, Kuvendi shkarkoi pesë anëtarët e bordit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Në përgjithësi, në vitin 2021, kënaqshmëria e qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike ka pësuar një rënie prej 6.9%. Hartimi i ligjit të ri për pagat është në fazën fillestare, i cili u pengua nga mungesa e të dhënave të besueshme për pagat brenda dhe jashtë shërbimit civil. Zbatimi i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka filluar në korrik të vitit 2020 dhe është ende në fazë fillestare. Ligji i ri për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore rregullon llogaridhënien në institucione, por zbatimi i tij në praktikë mungon. Kosova ende posedon numrin më të madh të agjencive ekzekutive krahasuar me rajonin, të cilat janë në varësi të parlamentit dhe gjatë këtij viti nuk është treguar asnjë progres në këtë fushë. Mos harmonizimi i ligjeve të veçanta (sektoriale) me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka shkaktuar paqartësi juridike si për qytetarët ashtu edhe për bizneset duke rezultuar në zero progres.

**EKONOMIA** - Në përgjithësi, nuk është raportuar progres në ekonomi në vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, një lloj progresi është shënuar në secilin prej nën-indikatorëve veç e veç: stabiliteti makroekonomik, mjedisi i biznesit, investimet, punësimi dhe siguria në punë, kapitali njerëzor dhe korniza ligjore.

**Stabiliteti makroekonomik** - Në vitin 2021, Bruto Produkti i Brendshëm (BPB) për kokë banori shënoi rritje me 8%. Sa i përket rritjes së GDP-së, të dhënat tregojnë për një përmirësim të vogël duke pasur parasysh rritjen prej 3%. Progresi është evident edhe sa i përket të ardhurave të qeverisë, të cilat në vitin 2021 arritën në 2.6 milionë euro. Nga ana tjetër, shkëmbimet tregtare kanë vazhduar të përformojnë me një bilanc negativ të importit ndaj eksportit.

**Mjedisi i biznesit** - Progresi i kufizuar është shënuar edhe sa i përket statistikave në lidhje me strukturën e biznesit, ndërsa disa statistika afatshkurtra janë pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së. Megjithatë, disponueshmëria e e këtyre të dhënave është e kufizuar. Nuk vërehet ndonjë përparim në hendekun midis bizneseve të reja të regjistruara dhe atyre të mbyllura/shuara. Në vitin 2021, numri i firmave të reja të regjistruara ishte 10,649 ndërsa ai i bizneseve të mbyllura ishte 1608. Një shqetësim i madh mbetet ekonomia joformale, e cila arrin deri në 30%.

**Investimet** - Te hyrat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD-ve) në vitin 2021 kanë arritur në 421 milionë euro dhe kjo shifër paraqet një rritje prej 22%. Niveli i papunësisë nga ana tjetër ka rënë në mënyrë marginale me 0.38%. Sa i përket riorganizimit të Agjencisë Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA), nuk është raportuar ndonjë progres.

**Punësimi dhe siguria në punë** - Progresi i pamjaftueshëm është shënuar në lidhje me incidentet fatale në punë pasi që në vitin 2021, ato janë ulur për 18%. Nga ana tjetër, nuk ka pasur avancim të dukshëm sa i përket punësimit dhe sigurisë në punë. Konkretisht, shumica e punëtorëve në Kosovë nuk ishin të mbuluar me sigurime shëndetësore dhe kishte mungesë të sigurimit edhe sa i përket lëndimeve të pësuar apo sëmundjeve të ndërlydhura me vendin e punës.

**Kapitali njerëzor** - Nuk është raportuar asnjë progres mbi fluksin e migrimit. Emigracioni u rrit nga 8724 në vitin 2020 në 42728 në vitin 2021. Sa i përket Indeksit të Kapitalit Njerëzor (IKNj), nuk ka të dhëna për vitin 2021 për të krahasuar shifrat.

**Korniza ligjore** - Sipas të dhënave, progresi i pamjaftueshëm është shënuar në zbatimin e Strategjisë Sektoriale 2018-2022. Ligji i Punës (Nr. 03/L-212), i miratuar në vitin 2010, është ende në fuqi dhe nuk ka asnjë përmirësim në këtë drejtim. Gjithashtu, Ligji i ri i Punës dhe Ligji për Këshillin Socio-Ekonomik nuk janë miratuar ende.

**ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM** - Në mes të viteve 2020 dhe 2021, përgjithësisht “asnjë progres” nuk është raportuar sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, progresi minimal është i dukshëm në indikatorët e kësaj fushe veç e veç siç janë energjia dhe mjedisi.

**Energjia** – Kosova u bë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që themeloi një Fond për Eficiencën e Energjisë në vitin 2019, edhe pse asnjë informacion nuk ofrohet në faqen zyrtare që nga viti 2020. Qeveria u përpoq të aplikonte masa mjedisore për të përmirësuar termocentralin me thëngjill Kosova B dhe për të dekompozuar asetet jofunksionale të termocentralit Kosova A. Disa përmirësime janë të dukshme edhe në energjinë e ripërtëritshme të prodhuar në vitin 2021, e cila u rrit për 16%. Në vitin 2021, termocentralet me thëngjill prodhuan 1,833.2 GWh; 2% më shumë se në vitin 2020. Progres minimal është shënuar në adresimin e humbjeve komerciale. Humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes ishin 12.46% ndërsa humbjet komerciale ishin 12.11%. Në anën tjetër, ka munguar progresi në sigurinë e furnizimit pasi që importi i energjisë është rritur për 18,6% krahasuar me vitin 2020. Sistemi energjetik i Kosovës konsiderohet jo-fleksibil me 98% të energjisë elektrike të prodhuar nga dy termocentrale të thëngjillit tashmë të vjetruara. Nuk ka të dhëna për të treguar ndonjë projekt mbi eficiencën e energjisë në komuna për vitin 2020 apo 2021. Trajnimet për përdorimin e Platformës së Monitorimit dhe Verifikimit janë ofruar për zyrtarët komunal në vitin 2020, por nuk është treguar ndonjë progres në këtë drejtim. Kosova vazhdon të prodhojë emetime të larta të CO<sub>2</sub>. Në vitin 2020, gazi serrë vjetor vlerësohet të ketë arrirë deri në 10,266 Gg (Giga gram) CO<sub>2</sub> ek (ekuivalent), ose rreth 10.2 milion ton ekuivalent. Megjithatë, nuk ka të dhëna për vitin 2021 për të matur progresin, apo mungesën e tij. Sa i përket kornizës ligjore, u prezantua një draft i ri strategjisë për Energjinë për periudhën kohore 2022-2031, i cili nuk është miratuar nga qeveria. Gjithashtu, nuk ka pasur progres në miratimin e një plani për rregullimin gradual të tarifave të energjisë. Në tetor të vitit 2021, Zyra e Rregullatorit për Energji ka miratuar tarifën me pakicë të energjisë elektrike, të cilat ndër të tjera parashikojnë tarifa më të ulëta të energjisë nëse energjia përdoret në periudha të caktuara kohore gjatë ditës. Plani i integruar Kombëtar për Klimën dhe Energjinë (PKEK) nuk është miratuar. Në mungesë të Ligjit për ndryshimet klimatike, nuk ka bazë ligjore për zbatimin e PKEK-së.

**Mjedisi** - Monitorimi në kohë reale i cilësisë së ajrit është efektiv dhe i qasshëm, duke shënuar një avancim shumë të mirë në këtë drejtim. Megjithatë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për cilësinë e ajrit. Shumë qytete në Kosovë kanë ajër të cilësisë së dobët. Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit, i cili synon të sigurojë disa masa për zëvendësimin e qymyrit për djegie, është në fazën e rishikimit. Një lloj progresi është raportuar në miratimin e planeve moderne të menaxhimit të integruar të mbeturinave komunale në disa komuna (26 komuna i kanë hartuar këto plane ndërsa 11 nuk e kanë bërë këtë). Progres i pamjaftueshëm është shënuar në numrin e deponive ilegale të mbeturinave, i cili është ulur për 20%. Kosova vazhdon ta mbështes prodhimin e energjisë/ngrohjes në thëngjill dhe nuk qëndron në përputhje me kufijtë e përcaktuar të emetimeve. Kosova ka masa të kufizuara dhe joefektive për të zbatuar ndalimin e thëngjillit për ngrohje.

Në vitin 2021, trendi i nivelit mesatar vjetor të ujit ishte 1926 (cm), që krahasuar me vitin 2020 (2143 cm) ka shënuar trend negativ. Në vitin 2020, rreth 96,84% e popullsisë kishte qasje në ujë të pijshëm, ndërsa në vitin 2021, qasje në ujë të pijshëm kishte 96,88% e popullsisë. Sa i përket ndotjes së ujit, problemi i ndotjes në Kosovë vjen nga përmbytja e lumenjve dhe kontaminimi i ujit të pijshëm dhe se qeveritë e njëpasnjëshme kanë bërë pak në këtë drejtim. Kosova nuk ka asnjë program apo monitorim të rregullt të cilësisë së ujit, dhe kjo gjë nuk shënon asnjë progres për periudhën raportuese. Për sa i përket kornizës ligjore, sipas të dhënave nuk është shënuar asnjë progres. Strategjia e ndryshimeve klimatike për periudhën 2019-2028 është ende në një fazë të hershme. Ligji për Mbeturina duhet të harmonizohet më tej me Direktivën Kornizë për Mbeturina, Strategjinë e Pyjeve dhe Ligjin për Pyjet, të cilat nuk janë miratuar.

**ARSIMI** - Në përgjithësi, ‘asnjë përparim’ nuk është raportuar në arsim. Megjithatë, nivele të ndryshme progresi raportohen sipas nën-indikatorëve kryesorë veç e veç siç janë: Shpenzimet në arsim, Qasja në arsim, Qeverisja dhe cilësia e arsimit dhe Harmonizimin me tregun e punës.

**Shpenzimet në arsim** - Në vitin 2021, shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara u rritën për 12%. Progres minimal është raportuar edhe sa i përket shpenzimeve në infrastrukturë dhe investimeve pasi që shpenzimet për salla të gjimnastikës, pajisje laboratorike dhe materiale të ndryshme dhe renovime janë ngritur për 10.2%. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për shpenzimet për kërkime shkencore dhe shpenzimet për arsimin pasi që në këto fusha nuk është shënuar asnjë progres. Shpenzimet për studentët mbeten të pamjaftueshme.

**Qasja në arsim** - Regjistrimi i studentëve në arsimin e lartë është rritur për 26.4% në vitin 2021. Më tej vërehet vetëm një lloj progresi në shkallën e braktisjes së shkollës nga komuniteti RAE, me një rënie prej 38%. Shkalla e braktisjes së shkollës tek vajzat gjithashtu pati nivel të ngjashëm me një rënie prej 0.04% në arsimin fillor, 0.05% në arsimin e mesëm dhe 0.5% në arsimin e lartë. Sa i përket shkollës së diplomimit, raportohet progres i pamjaftueshëm me 6193 nxënës të diplomuar në vitin 2021. Numri i institucioneve parashkollore gjithashtu ka shënuar rritje me 5 institucione të tjera.

**Qeverisja dhe cilësia e arsimit** - Anëtarësimi në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) është revokuar në vitin 2019 dhe Kosova nuk e ka rifituar anëtarësimin gjatë periudhës raportuese. Sa i përket emërimit të drejtorëve të shkollave, vërehet një progres i pamjaftueshëm në procesin e rekrutimit të bazuar në meritokraci.

**Përafrimi me tregun e punës** - Sipas vlerësimit, është arritur përparim i pamjaftueshëm sa i përket trajnimeve profesionale të ofruara nëpërmjet projektit: Mbështetja për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, megjithatë, ekzistojnë sfida të vazhdueshme që pengojnë shkollat e AAP-së të përafrojnë kurrikulat e tyre me nevojat e tregut. Nga ana tjetër, nuk është raportuar asnjë progres në përafrimin e kurrikulës për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe aftësimin (trajnimin) profesional.

**SHËNDETËSIA** - Në përgjithësi, nuk raportohet asnjë progres lidhur me shëndetësinë midis viteve 2020 dhe 2021. Megjithatë, janë evidente shkallë të ndryshme të progresit të arritur sipas nën-indikatorëve si vijon: Qasja në kujdesin shëndetësor, Cilësia e kujdesit shëndetësor, Menaxhimi i COVID-19, Infrastruktura dhe Korniza ligjore.

**Qasja në kujdesin shëndetësor** - Nuk vërehet asnjë progres në mbrojtjen e shëndetit me aktivizimin e pjesëm të sistemit bazë të informacionit shëndetësor. Qeveria ende nuk e ka prezantuar skemën universale të kujdesit shëndetësor dhe Ligji për Sigurime Shëndetësore (2013/04-L-249) është ende në fuqi. Në vitin 2021, Kosova ka ndarë 8.2% të buxhetit të saj për shëndetësinë. Buxheti i përgjithshëm për shëndetësinë është rritur me 10% krahasuar me vitin 2020. Megjithatë pjesa e përgjithshme e shpenzimeve për shëndetësinë është rreth 3% e GDP-së, me ç'rast nuk është shënuar asnjë progres. E njëjta gjë vlen edhe për numrin e mjekëve specialistë, në spitalet publike dhe private. Në vitin 2021 kishte 6,4% më pak mjekë specialistë krahasuar me vitin 2020.

**Cilësia e Kujdesit Shëndetësor** - Për sa i përket kënaqshmërisë së pacientëve me sistemin e kujdesit shëndetësor, Kosova qëndron në shkallën 2.7 gjë që është mbi mesatare. Në vitin 2021, 71.7% e të anketuarve besonin se kujdesi shëndetësor ka qenë i afektuar nga korrupsioni, gjë që shënon progres minimal në krahasim me vitin 2020 kur 73% e të anketuarve e besonin një gjë të tillë. Korrupsioni në shëndetësi mbetet i lartë edhe pse në vitin 2021 kishte shënuar një rënie të lehtë prej 1.78%.

**Covid-19 -Menaxhimi** - Sipas të dhënave, 50% e popullsisë është pjesërisht e vaksinuar ndërsa 45% e tyre janë plotësisht të vaksinuar. Kjo shënon një progres të mirë krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, kapacitetet spitalore për t'u ballafaquar me COVID-19 ishin të pamjaftueshme.

**Infrastruktura** - Numri i shtretërve në spitalet e përgjithshme u rrit nga 1986 në vitin 2021 në 1975 në vitin 2020, duke treguar kështu një rritje të lehtë në infrastrukturën e kujdesit shëndetësor. Për më tepër, numri i personelit në të gjitha nivelet e shëndetësisë në vitin 2021 ishte 13.448, ndërsa në vitin 2020 ky numër ishte 13.518. Sa i përket buxhetit të shpenzuar për trajtim jashtë vendit, ai është rritur për 17.5%.

**Korniza ligjore** - Progres shumë i mirë është shënuar me miratimin e Strategjisë për Promovimin dhe Edukimin Shëndetësor për vitin 2021. Megjithatë, miratimi i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor është vonuar dhe si rrjedhojë, ligji i vitit 2013 është ende në fuqi. Disa nga sfidat që lidhen me zbatimin e pamjaftueshëm të Strategjisë së Sektorit të Shëndetësisë përfshijnë: mungesën e qasjes në kujdesin shëndetësor për 1/5 e popullsisë, shpenzimet për shërbimet diagnostikuese, mos-rimbursimin e mjeteve të shpenzuara për barëra dhe mungesën e alokimit të fondeve bazuar në nevojat e paraqitura.

**MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË** - Progresi i përgjithshëm në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë vlerësohet gjithashtu si 'i kufizuar'. Megjithatë, janë evidente nivele të ndryshme të progresit sa i përket nën-indikatorëve të kësaj fushe veçmas në: marrëdhëniet bilaterale, bashkëpunimin rajonal dhe dialogun me Serbinë.

**Marrëdhëniet bilaterale** - Përparim i konsiderueshëm është shënuar në marrëdhëniet me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Takimet e njëpasnjëshme ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë rezultuan me 13 marrëveshje. Janë zhvilluar edhe disa takime mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe është duke u punuar për një marrëveshje për hapjen e Pikës së Kalimit Kufitar hekurudhor (PKK). Puna për zgjerimin e gazsjellësit Trans-Adriatik dhe një studim fizibiliteti janë duke u zhvilluar aktualisht. Gjithashtu, vihet re një arritje e rëndësishme në marrëdhëniet me Malin e Zi, pasi të dy vendet nënshkruan një marrëveshje për eliminimin e taksës së sigurimit të automjeteve për hyrjen në territoret e njëri-tjetrit. Sa i përket marrëdhënieve me Bosnjën dhe Hercegovinën, në marrëdhëniet dypalëshe është raportuar zero progres.

**Bashkëpunimi rajonal** – Një lloj progresi u raportua në vitin 2021 me zbatimin e Marrëveshjes Rajonale për Tarifat e Roaming-ut (MRTR) -”roam (bredh) si në shtëpi”. Për më tepër, Sherpa ose Koordinatori Kombëtar i Procesit të Berlinit u caktua për të lehtësuar krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR). Sherpa koordinon dhe drejton katër grupe punuese për TPR. Për sa i përket Strategjisë për Anëtarësim dhe Pjesëmarrje në organizata të reja, në vitin 2021 nuk është raportuar ndonjë progresi dukshëm në këtë drejtim. Qeveria nuk ka pasur ndonjë qasje strategjike për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e vendit në organizata dhe iniciativa të reja. Gjithashtu, nuk është shënuar progres sa i përket anëtarësimeve, pasi që Kosova nuk ka arritur të anëtarësohet në asnjë organizatë apo iniciativë rajonale.

**Dialogu me Serbinë** - Dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë ka rifilluar në vitin 2020, me heqjen e tarifës prej 100% nga Kosova për mallrat e importuara nga Serbia. Ka pasur pak progres sa i përket zbatimit të marrëveshjeve të arritura, ndërsa përgjithësisht është shënuar një progres minimal. Për më tepër, të dyja vendet kanë arritur një marrëveshje për targa pasi që Kosova filloi të aplikonte masat e reciprocitetit. Marrëveshja është duke u zbatuar dhe grupet punuese për këtë çështje vazhdojnë të takohen në Bruksel. Nga ana tjetër, progresi ka munguar në rastin e personave të zhdukur

## PROGRESI NË TË TETË DIMENSIONET



## HYRJE

Progresi i vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) në përmbushjen e kritereve të BE-së- si pjesë e rrugëtimit të tyre përkatëse drejt integritimit në BE - vlerësohet çdo vit nga Komisioni Evropian (KE) përmes raporteve për këto vende. Këto raporte kryesisht fokusohen në vlerësimin e zbatimit të reformave të rëndësishme nga ana e këtyre vendeve si ato në fushën e sundimit të ligjit (SL), liritë themelore, funksionimin e institucioneve demokratike duke përfshirë reformën në administratën publike dhe zhvillimin socio-ekonomik, të cilat përbëjnë ‘themelet bazike’ në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Për Kosovën në veçanti, ekziston një numër i dokumenteve tjera që përcaktojnë marrëdhëniet

e saj me Bashkimin Evropian (BE). Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në në tetor të vitit 2015, duke hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet BE-Kosovë.<sup>1</sup> Qeveria prezantoi Programin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së (PKZMSA) nëpërmjet të një dokumenti kombëtar me prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme të vendosura në tre blloqe: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane.<sup>2</sup> Në nëntor të vitit 2016, BE-ja dhe Kosova prezantuan një iniciativë të përbashkët, Agjendën e Reformës Evropiane (ERA), me synimin që të konkretizonin veprimet e nevojshme për zbatimin e MSA-së.<sup>3</sup>

Si një vend kandidat që aspiron BE-në, pjesa më e madhe e progresit të Kosovës është e lidhur pashmangshmërisht me zbatimin e reformave që kanë të bëjnë me BE-në. Ndërsa raporti i Komisionit Evropian ofron një pasqyrë solide të progresit vjetor të Kosovës, ekziston nevoja për një rishikim më gjithëpërfshirës për të pasqyruar zhvillimin e vendit në të gjitha fushat kyçe. Prandaj, ky raport për vendin është shumë më i gjerë dhe më i detajuar, krahasuar me raportin e BE-së, i cili vlerëson progresin e institucioneve përmes tetë dimensioneve kryesore të politikave siç janë: sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, demokratizimi, ekonomia, zhvillimi i qëndrueshëm, arsimit, shëndetësia dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Kjo është realizuar me përfshirjen e 14 indikatorëve, 65 nën-indikatorëve dhe 234 mjeteve të vlerësimit.

Indikatorët ofrojnë një qasje empirike për matjen e avancimit të Kosovës në fushat kryesore të politikave. Në shumicën e instancave, progresi raportohet në mënyrë sasiore. Në rastet e tjera, kryesisht për shkak të natyrës së indikatorëve, progresi raportohet në mënyrë cilësore dhe kjo më së shumti i referohet legjislacionit dhe zbatimit të tij. Ndërsa indikatorët bazohen në normat dhe standardet ndërkombëtare dhe mund të përdoren në kontekste të tjera, indikatorët e këtij vlerësimi janë specifikë për vendin dhe nuk synojnë të udhëzojnë se si mund të kryhen vlerësimet në kontekste të tjera.

Raporti shoqërohet me aplikimin e një metodologjie të detajuar, të bazuar në indikatorë dhe nën-indikatorë, duke paraqitur kështu edhe mënyrën e matjes së tyre. Përveç kësaj, me qëllim të vlerësimit sa më të saktë të progresit të arritur, janë përdorur 234 mjete vlerësimi, nga një sërë burimesh lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Si i tillë, ky raport analizon në një sasi të madhe të dhënash për të matur progresin e Kosovës në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak.

## METODOLOGJIA DHE SFIDAT

Përmes këtij raporti, Grupi për Ballkan synon të prezantojë progresin vjetor të institucioneve të Kosovës në përmbushjen e kriterëve të BE-së në të gjithë sektorët kyç duke monitoruar, raportuar dhe promovuar MSA-në dhe ERA-në.

Ky raport ndryshon nga raporti i Komisionit Evropian për vendin si në metodologji ashtu edhe në përmbajtje. Me qëllim të vlerësimit sa më të mirë të progresit të arritur dhe nxjerrjes në sipërfaqe të sa më shumë informacioneve dhe të dhënave sa i përket Kosovës, Grupi për Ballkan ka zhvilluar një instrument monitorues që përbëhet nga 8 dimensione: Sundimi i Ligjit, Të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, Demokratizimi, Ekonomia, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Arsimit, Shëndetësia dhe Marrëdhëniet e Fqinjësisë së mirë. Kjo strukturë më tej ndahet në trembëdhjetë (13) indikatorë dhe gjashtëdhjetë e pesë (65) nën-indikatorë të cilët përdorin mjete të vlerësimit, dhe verifikimit nga një sërë burimesh lokale, rajonale dhe ndërkombëtare duke përdorur metodat e mbledhjes së të dhënave si sasiore (kuantitative) dhe cilësore (kualitative). Duke krahasuar të dhënat me vitin paraprak, raporti vlerëson progresin e arritur në vitin raportues duke e paraqitur atë në formë numrash dhe përqindjesh. (Shih Fig.1 për më shumë qartësi mbi dimensionet, indikatorët, nën-indikatorët dhe mjetet e vlerësimit.) Duke ofruar të dhëna të thjeshtuara dhe lehtësisht të kuptueshme, Grupi për Ballkan synon t'i shndërroj këta indikatorë në një platformë informative për qytetarët dhe politikë-bërësit në lidhje me progresin e arritur të Kosovës në sektorët kryesorë. Për më tepër, bazuar në këtë metodologji, Grupi për Ballkan më tej ka hartuar një seksion të quajtur "Progresi në numra", i cili vlerëson në shkallët nga 0-4 arritjen e progresit të përgjithshëm në një dimension të caktuar me indikatorë, nën-indikatorë dhe mjete vlerësimi.

<sup>1</sup> Raporti i Grupit për Ballkan, Kosova 2020: Një Agjendë Komplekse për Qeverinë e Re, 17 dhjetor. 2019; dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, 27 tetor. 2015;

<sup>2</sup> Raporti i Grupit për Ballkan, Kosova 2020: Agjenda Sfiduese për Qeverinë e Re, 17 dhjetor, 2019;

<sup>3</sup> Agjenda e Reformës Evropiane për Kosovën (ERA), shkurt, 2017.

Për të përcaktuar këta indikatorë, janë përdorur dokumente të ndryshme si raporti vjetor i KE-së për vendin, Agjenda e Reformës Evropiane dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ndonëse lista e indikatorëve apo treguesve është e gjatë, të njëjtit nuk mund të themi se janë gjithëpërfshirës dhe se këta indikatorë nuk kanë për qëllim që të përdoren për matjen e performancës në raste të tjera. Gjithashtu, nëse themi se disa fusha apo dimensione të politikave nuk janë përfshirë në këtë raport, kjo nuk do të thotë se ato nuk janë të rëndësishme dhe se kjo nuk nënkupton se progresi i Kosovës në ato fusha të caktuara nuk monitorohet nga BE-ja. Përkundrazi, lista e indikatorëve mund të zgjerohet në vitet e ardhshme dhe se të njëjtit gjithashtu mund të modifikohen për t'iu përshtatur rrethanave të reja që do të krijohen në të ardhmen.

### Metodologjia mund të përmblihet si më poshtë:



- Për secilin dimension, ofrohet një numër i indikatorëve dhe nën-indikatorëve që përcillet me mjetet e vlerësimit – pra si është arritur të bëhet vlerësimi i progresit për një indikator dhe nën-indikator të caktuar, burimi i verifikimit - si fokus i ekipit të hulumtimit gjatë mbledhjes së të dhënave.
- Për shumicën e nën-indikatorëve, progresi është vlerësuar duke aplikuar një masë me katër shkallë/nivele që varion nga 0- asnjë progres, 1- progres i pamjaftueshëm, 2- një lloj progresi, 3- progres i mirë dhe 4 – progres shumë i mirë.
- Një vlerësim mesatare për indikatorin kalkulohet duke marrë notën mesatare të progresit të bërë nga secili prej nën-indikatorëve të atij indikatorit të caktuar. Për shembull, nëse indikatorit X posedon tre nën-indikatorë me ç'rast secili prej tyre shënon 0, 2 dhe 2, rezultati përfundimtar për atë indikator do të jetë  $(0+2+2)/3 = 1.3$  (progres i pamjaftueshëm). E njëjta gjë zbatohet nëse është e nevojshme edhe kur kalukohet rezultati i përgjithshëm për një dimension të caktuar. Nëse dimensionit Y ka katër indikatorë ku secili prej tyre është 1, 0, 3 dhe 1, rezultati i përgjithshëm i progresit për atë dimension do të jetë  $(3+0+3+1)/4 = 1,75$  (një lloj progresi).
- Për nën-indikatorët e tjerë, progresi është i ndarë në këtë mënyrë, ose 0 – asnjë progres, ose 4 – progres shumë i mirë. Ky është veçanërisht rasti me kornizën ligjore ku pyetja kërkimore/hulumtuese ka të bëjë vetëm me miratimin ose jo të një ligji ose rregulloreje të veçantë.
- Në rastet kur ekziston pritshmëria e përmirësimit të indikatorit apo nën-indikatorit, progresi matet duke bërë krahasimin e progresit të arritur me vitin paraprak.
- Çdo dimension dhe indikator përfshin gjithashtu një raport të përgjithshëm cilësor ilustrues të progresit të shënuar për atë dimension apo tregues të caktuar. Të dyja, edhe rezultatet e bazuara në pikë dhe rezultatet e bazuara në deklarata mund të gjenerohen vetëm pasi të jenë mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme.

### Mbledhja e të dhënave për realizimin e qëllimit të këtij raporti ka qenë shumë sfiduese, kryesisht për arsyt e mëposhtme:

- Mungesa e të dhënave të grumbulluara nga institucionet e Kosovës për indikatorët specifikë, nën-indikatorët apo mjetet e vlerësimit. .
- Mospërgjegjësia e institucioneve edhe pas tentativave të shumta për të dhënat që do të duhej të ishin të disponueshme për publikun.
- Publikimi me vonesë i të dhënave, p.sh. për vitin X, të dhënat përpilohen ose publikohen në fund të vitit të srdhshëm.

### Me qëllim të lehtësimit të sfidave në këtë proces, Grupi për Ballkan rekomandon veprimet si më poshtë:

- Bashkëpunim më i mirë ndër-institucional në menaxhimin dhe shkëmbimin e të dhënave
- Ngritja e përgjegjshmërisë së institucioneve mbi ofrimin e informatave.
- Përmirësimi i menaxhimit të të dhënave, cilësisë dhe rutinës së publikimit

Grupi për Ballkan do të vazhdojë të publikojë raporte të ngjashme cilësore për çdo vit.

# VLERËSIMI I 8 DIMENSIONEVE TË PROGRESIT TË KOSOVËS

Dimensioni	Indikatori	Sub-Indikatori	Mjetet e vlerësimit
SUNDIMI I LIGJIT	GJYQËSORI	Efikasiteti dhe efektiviteti	- Rastet e zgjidhura - Rastet të pazgjidhura - Aplikimi i SMIL - Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar
		Pavarësia dhe paanshmëria	- Besimi i publikut në punën e gjyqësorit - Paanshmëria e gjyqtarëve/prokurorëve - Mandati i gjyqtarëve/prokurorëve
		Llogaridhënia	- Monitorimi i performancës për gjyqtarët - Disiplina - Monitorimi i performancës për prokurorët - Raportet e disponueshme për publikun mbi shpenzimet gjyqësore
		Transparenca	- Publikimi i raporteve vjetore - Natyra e ankesave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre - Hapja e proceseve gjyqësore për publikun
		Qasja në drejtësi	- Ofrimi i ndihmës juridike falas - Sigurimi i strehimit për gratë viktime të dhunës në familje - Grupet e marginalizuara (minoritetet dhe LGBTI)
		Administrimi i Drejtësisë	- Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve - Përfaqësimi i grave - Stafi profesional - Menaxhmenti i KGJK-së dhe KPK-së - Burimet buxhetore
		Korniza Ligjore	- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Sundimin e Ligjit - Planet Strategjike të KPK-së dhe KGJK-së
	LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT	Perceptimi publik i korrupsionit	- Niveli i korrupsionit në institucionet publike
		Parandalimi	- Agjencia Kundër Korrupsionit - Deklarimi i pasurisë - Konflikti i interesit
		Masat Kundër Korrupsionit të Nivelit të Lartë	- Hetimi - Prokuroria - Gjykimi - Aktgjykimet Dënuese - Mekanizmi i regjistrimit të gjurmëve
		Konfiskimi i Pasurisë	- Vlera e aseteve të konfiskuara - Vlera e aseteve të shitura - Fondi i konfiskimit
		Korniza Ligjore	- Rishikimi i Kodit të Procedurës Penale - Paketa ligjore kundër korrupsionit - Rishikimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike
	LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR	Niveli i Krimit të Organizuar	- Niveli i përgjithshëm i krimit të organizuar
		Masat kundër Krimit të Organizuar	- Hetimi - Prokuroria - Gjykimi - Aktgjykimet dënuese
		Droga/ Narkotiket	- Hetimi - Prokuroria - Gjykimi - Aktgjykimet dënuese - Konfiskimi i drogës
		Pastrimi i Parave	- Hetimi - Prokuroria - Gjykimi - Aktgjykimet dënuese
		Lufta Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm	- Hetimi - Prokuroria - Gjykimi - Aktgjykimet dënuese - Qendra e Përbashkët e Vlerësimit të Kërcënimeve
		Trafikimi i Qenieve Njerëzve	- Hetimi - Prokuroria - Gjykimi - Aktgjykimet dënuese
		Korniza Ligjore	- Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar - Kodi i Procedurës Penale - Ligji për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit - Ligji për Sigurinë Kibernetike - Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore - Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm

<b>TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË THEMELORE</b>	<b>TË DREJTAT THEMELORE</b>	<b>Të Drejtat Civile dhe Politike</b>	- Niveli i përgjithshëm i të drejtave civile dhe politike - Liria e shprehjes - Liria e religjionit - Liria e asociimit - Barazia gjinore - Të drejtat e pakicave - Të drejtat e fëmijëve - Grupet e marginalizuara
		<b>Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore</b>	- E drejta për të punuar - E drejta në pronë - E drejta për qasje në Arsim
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Ligji për Lirinë Fetare - Ligji për të Drejtat Pronësore - Ligji për Barazinë Gjinore - Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
<b>DEMOKRATIZIMI</b>	<b>MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE</b>	<b>Liria e Medias</b>	- Media e lirë dhe e pavarur - Ngacmimi i gazetarëve - Transmetuesi Publik - Mbrojtja e sinjalizuesve
		<b>Shoqëria Civile</b>	- Konsultimet e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) - Promovimi i platformave të konsultimit - Financimi publik i OSHC-ve
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave - Ligji për RTK-në - Ligji për Qasje në Dokumente Publike
	<b>STABILITETI POLITIK</b>	<b>Funksionimi i Institucioneve</b>	- Funksionimi i Qeverisë - Funksionimi i parlamentit - Funksionimi i institucioneve të pavarura - Kënaqshmëria e publikut me punën e qeverisë - Mbikëqyrja - Zbatimi i legjislationit
		<b>Siguria dhe Rendi Publik</b>	- Mungesa e dhunës dhe terrorizmit - Dhuna ndëretnike - Aktet e terrorizmit - Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave për arsye politike
		<b>Marrëdhëniet mes Qeverisë dhe Opozitës</b>	- Transferimi demokratik i pushtetit - Prania e opozitës në parlament - Mbështetja e opozitës për qeverinë
		<b>Rendi Kushtetues dhe Juridik</b>	- Zbatimi - Shkelja e rendit kushtetues - Shkelje të tjera nga partitë politike
	<b>ZGJEDHJET</b>	<b>Administrata Zgjedhore</b>	- Transparenca e KQZ-së - Lista votuese - Dita e zgjedhjeve - Numërimi i votave - Rezultatet
		<b>Mjedisi i fushatës</b>	- Fushata zgjedhore - Qasja në media - Masat për Covid-19 - Mjedisi politik
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme - Ligji për Zgjedhjet Lokale - Ligji për Financimin e Subjekteve Politike - Ndryshimi i rregullores së KQZ-së
		<b>Pjesëmarrja e Grave</b>	- Përfaqësimi i grave - Vizibiliteti i grave kandidate në fushata
	<b>REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE</b>	<b>Funksionimi i Administratës Publike</b>	- Emërimet, shkarkimet dhe rekrutimi i bazuar në merita - Shkarkimet - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil - Avokati i popullit
		<b>Ofrimi i Shërbimeve</b>	- Cilësia e shërbimeve publike (niveli qendror) - Digitalizimi - Shërbimet komunale
		<b>Financat Publike</b>	- Procedurat e prokurimit publik - Transparenca buxhetore - Reforma e menaxhimit të financave publike
		<b>Përfaqësimi</b>	- Përfaqësimi i grave - Përfaqësimi i komuniteteve pakicë
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Ligji për Pagat - Ligji për Zyrtarët Publikë - Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore - Harmonizimi i ligjeve me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme
<b>EKONOMIA</b>	<b>ZHVILLIMI EKONOMIK</b>	<b>Stabiliteti Makroekonomik</b>	- Rritja e BPB-së - BPB-së për kokë banori - Bilanci tregtar - Të ardhurat
		<b>Mjedisi Biznesor</b>	- Hendeku midis firmave të sapo regjistruara dhe të mbyllura - Ekonomia informale - Statistikat
		<b>Investimet</b>	- Rrjedha e IHD-ve - Riorganizimi i KIESA



		<b>Punësimi dhe Siguria në Punë</b>	- Sigurimi shëndetësor - Incidente fatale në punë - Niveli i papunësisë
		<b>Kapitali njerëzor</b>	- Shkalla e Migrimit - Kapitali njerëzor
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Strategjia për Punësim dhe Politika Sociale - Ligji i Punës - Ligji për Këshillin Socio-Ekonomik
<b>ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM</b>	<b>ENERGJIA</b>	<b>Furnizimi me Energji</b>	- Mbështetja në tëngjill - Humbjet Komerciale - Siguria e furnizimit - Planifikimi dhe investimet
		<b>Efikasiteti i energjisë</b>	- Fondi i Eficiencës së Energjisë - Termocentralet - Efikasiteti i energjisë në ndërtesat e banimit - Projektet e Eficiencës në Komuna - Monitorimi i kursimeve të energjisë - Statistikat mbi emetimet e Co2
		<b>Energjia e Rinovueshme</b>	- Investimet - Energjia nga burimet e rinovueshme - Energjia nga burimet alternative të energjisë
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Strategjia e Energjisë - Rregullimi i tarifave të energjisë - PKEK e integruar
	<b>MJEDISI</b>	<b>Cilësia e Ajrit</b>	- Planet për cilësinë e ajrit - Pajtueshmëria me tavanet e emetimeve - Ndalimi i tëngjillit për ngrohje - Monitorimi në kohë reale
		<b>Menaxhimi i Ujit dhe i Tokës</b>	- Furnizim me ujë - Menaxhimi i burimeve ujore - Ujë i pijshëm - Ndotja e ujit - Cilësia e tokës
		<b>Menaxhimi i Mbeturinave</b>	- Planet e integruara të menaxhimit të mbetjeve komunale - Deponitë ilegale - Vendosja e lokacioneve të reja për deponitë
		<b>Menaxhimi i Pyjeve</b>	- Shpyllëzimi - Masat kundër shpyllëzimit - Ripyllëzimi
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Strategjia e Ndryshimeve Klimatike - Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike - Ligji për Mbeturinat - Ligji për Pyjet
<b>ARSIMI</b>	<b>OFRIMI I QASJES NË ARSIM</b>	<b>Shpenzimet në Arsim</b>	- Shpenzimet publike dhe private në arsimin - Shpenzimet për nxënës - Shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara - Shpenzimet për kërkime/hulumtime - Shpenzimet në infrastrukturë
		<b>Qasja në Arsim</b>	- Regjistrimi i nxënësve - Shkalla të diplomuarve - Fëmijët me nevoja të veçanta - Shkalla e braktisjes së shkollimit nga komuniteti RAE - Shkalla e braktisjes së shkollës nga vajzat
		<b>Qeverisja dhe Cilësia e Arsimit</b>	- Vlerësimet e PISA-së - Tekstet dhe programet mësimore - Anëtarësimi i AKA-së në ENQA - Emërimi i drejtorëve të shkollave
		<b>Përafrimi me Tregun e Punës</b>	- Përshtatja e kurrikulave - Programet e trajnimeve profesionale
<b>SHËNDETI</b>	<b>SHËNDETI PUBLIK</b>	<b>Qasja në Kujdesin Shëndetësor</b>	- Skema e kujdesit shëndetësor universal - Sistemi informativ i shëndetit publik - Shpenzimet në shëndetësi - Numri i mjekëve specialist
		<b>Cilësia e Kujdesit Shëndetësor</b>	- Kënaqshmëria e pacientëve - Korrupsioni në shëndetësi
		<b>Korniza Ligjore</b>	- Ligji për Sigurimet Shëndetësore - Strategjia e Sektorit të Shëndetësisë - Strategjia e Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor
		<b>Masat për COVID-19</b>	- Vaksinimi - Kapacitetet e kujdesit shëndetësor
		<b>Infrastruktura</b>	- Shtretërit spitalor - Personeli - Shpenzimet për mjekim jashtë vendit
<b>MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE</b>	<b>BASHKËPUNIMI</b>	<b>Marrëdhëniet Bilaterale</b>	- Marrëdhëniet me Shqipërinë - Marrëdhëniet me Malin e Zi - Marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut - Marrëdhëniet me Bosnjën dhe Hercegovinën
		<b>Bashkëpunimi Rajonal</b>	- Marrëveshjet e nënshkuara - CRM - Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor - Strategjia për anëtarësim në organizata rajonale - Anëtarësimi në organizata të reja - Bashkëpunimi në iniciativat rajonale
		<b>Dialogu me Serbinë</b>	- Dialogu i lehtësuar nga BE-ja - Zbatimi i marrëveshjeve - Personat e zhdukur



**Dimensioni I**

---

# **SUNDIMI I LIGJIT**

## Përmbledhje dhe analizë

Sundimi i ligjit është një nga kriteret kryesore për përafrim dhe anëtarësim me BE-në dhe një nga parimet kryesore të qeverisjes në nivel global.<sup>4</sup> Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të BE-së dhe njëkohësisht një parakusht për mbrojtjen e të gjitha vlerave të tjera, duke përfshirë këtu edhe të drejtat themelore dhe demokracinë.<sup>5</sup> Sundimi i ligjit është gjithashtu vendimtar për vetë funksionimin e BE-së si, zbatim i efektiv i ligjeve të BE-së, funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, ruajtja e një mjedisi miqësor ndaj investimeve dhe besimi reciprok tek palët.<sup>6</sup>

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), neni 83, në kuadër të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet palëve me fokus në:


- *forcimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit në Kosovë dhe përmirësimi i efikasitetit të tij;*
- *zhvillimin e strukturave adekuate për policinë, prokurorët, gjyqtarët, organet e tjera gjyqësore dhe atyre të zbatimit të ligjit, me qëllim të përfshirjes dhe bashkëpunimit në trajtimin e çështjeve civile, tregtare e penale si dhe për të parandaluar, betuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar në mënyrë efektive rastet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.<sup>7</sup>*

Për më tepër, Agjenda e Reformës Evropiane (ERA) I dhe, pas saj, ERA II, kanë vendosur një fokus të veçantë në Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit (Shtylla I), duke përfshirë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.<sup>8</sup>

**Në kuadër të dimensionit të sundimit të ligjit, përdoren tre indikatorë:**

1. Gjyqësori;
2. Lufta kundër korrupsionit; dhe
3. Lufta kundër krimit të organizuar.

Duke përdorur këta indikatorë, synohet të matet progresi në punën e institucioneve të drejtësisë penale, si policia, gjykatat dhe prokuroria si dhe nëse legjislacioni kryesor që ka të bëjë me Sundimin e Ligjit është miratuar, ndryshuar dhe zbatuar.



### 1. Gjyqësori

Një gjyqësor që funksionon mirë, vendimet e të cilit zbatohen në mënyrë efektive, ka rëndësinë më të madhe për ruajtjen dhe forcimin e shtetit të së drejtës.<sup>9</sup> Gjyqësori është një nga fushat kryesore të shtetit të së drejtës, që shpesh përdoret në mënyrë të ndërsjellë për t'iu referuar këtij të fundit.

**Për matjen e progresit në kuadër të gjyqësorit, përdoren nën-indikatorët e mëposhtëm:**

- *efikasiteti dhe efektiviteti* - nëse gjykatat dhe prokuroria janë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre në mënyrë efikase dhe në kohë;

<sup>4</sup> Kombet e Bashkuara, Çfarë është Sundimi i Ligjit, në: <https://www.un.org/ruleoflaw/what-is-the-rule-of-law/> dhe Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.

<sup>5</sup> Komisioni Evropian, Mbështetja e Sundimit të Ligjit, në: [https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-law\\_en#:~:text=The%20rule%20of%20law%20is,for%20fundamental%20rights%20and%20democracy.](https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-law_en#:~:text=The%20rule%20of%20law%20is,for%20fundamental%20rights%20and%20democracy.)

<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës\*, nga ana tjetër, 2 tetor, 2015, në:

<sup>8</sup> Kosova – Agjenda e Reformës Evropiane (ERA) II, 2020.

<sup>9</sup> Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës, Lista kontrolluese për sundimin e ligjit, mars, 2016, në: [https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule\\_of\\_Law\\_Check\\_List.pdf](https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Law_Check_List.pdf)

- *pavarësia dhe paanshmëria* - nëse gjykatat janë të lira nga ndikimet, gjyqtarët janë të paanshëm dhe qytetarët kanë besim në institucionet ligjore;
- *llogaridhënia*- nëse ka masa për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve e prokurorëve dhe marrjen e veprimeve/masave në rastet kur ata nuk tregojnë performancë;
- *transparenca*- nëse ka informacione në dispozicion të publikut në lidhje me punën e institucioneve juridike;
- *qasja në drejtësi* - shkalla në të cilën grupet e cënueshme kanë qasje në ndihmën juridike falas dhe në marrjen e mbrojtjes;
- *administrimi i drejtësisë; dhe*
- *korniza ligjore.*

Gjyqësori	Efikasiteti dhe fektiviteti	Rastet e zgjidhura	Rastet e pazgjidhura	SMIL	Marrëveshjet e bashkëpunimit juridik ndërkomb.	
	Pavarësia dhe paanshmëria	Besimi i publikut	Paanshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve	Mandati i gjyqtarëve dhe prokurorëve		
	Llogaridhënia	Monitorimi i performancës për gjyqtarët	Disciplina	Monitorimi i performancës për prokurorët	Raportet e disponueshme për publikun mbi shpenzimet gjyqësore	
	Transparenca	Publikimi i raporteve vjetore	Raporti që tregon natyrën e ankesave dhe mënyrën se si janë zgjidhur ato	Hapja e procedurave gjyqësore për publikun		
	Qasja në drejtësi	Ofrimi i ndihmës juridike falas	Sigurimi i strehimit për gratë viktime të dhunës në familje	Qasja në drejtësi për grupet e marginali-zuara (minoritetet, L LGBTI)		
	Administrimi i drejtësisë	Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve	Përfaqësimi i grave	Stafi profesional	Menaxhmenti i KGJK-së dhe KPK-së	Resurset buxhetore
	Korniza ligjore	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Sundimin e ligjit	Planet strategjike të KPK-së dhe KGJK-së			

Gjyqësori dhe nën-indikatorët e tij

## a) Efikasiteti dhe efektiviteti

Mjetet e vlerësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të gjykatave përfshijnë:

- *rastet e zgjidhura;*
- *rastet e pazgjidhura;*
- *aplikimi i Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL);*
- *bashkëpunimi juridik ndërkombëtar.*

### Rastet e zgjidhura

Gjyqësori i Kosovës ballafaqohet me një numër të madh të lëndëve të grumbulluara, të transferuara nga viti në vit dhe në pritje të zgjidhjes. Kjo gjë ka vështirësuar dhe penguar punën dhe efikasitetin

gjykatave, ka shkaktuar vonesa dhe ka kontribuar në rënien e besimit të publikut ndaj të njëjtave.<sup>10</sup>

Në vitin 2021, gjykatat kanë zgjidhur 112.168 raste, ndërsa 224.801 raste kanë mbetur të pazgjidhura.<sup>11</sup> Në vitin 2020, gjykatat kanë zgjidhur 72.250 raste ndërsa 176.052 raste kanë mbetur të pazgjidhura.<sup>12</sup> Në vitin 2020, raporti i rasteve të zgjidhura ndaj atyre të pazgjidhurave ishte 41%, ndërsa në vitin 2021 një raport i tillë ishte 50%. **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2020	2021
Të zgjidhura	72,250	112,168
Të pazgjidhura	176,052 <sup>13</sup>	224,801 <sup>14</sup>
Raporti (%)	41%	50%

Tabela 1. Numri i rasteve gjyqësore të zgjidhura dhe të pazgjidhura  
\* Shënim: kjo shifër paraqet numrin e rasteve të pazgjidhura në fund të vitit 2020 dhe 2021

## Lëndët e grumbulluara

Në vitin 2020, gjykatat kanë trashëguar 143,728 lëndë të grumbulluara (të pazgjidhura) nga vitet e mëparshme. Në vitin 2021, ky numër u rrit në 174,275.<sup>15</sup> Në vitin 2021 pati një rritje prej 21% të numrit të lëndëve të grumbulluara.<sup>16</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Lëndët e grumbulluara	143,728	174,275
Raporti (%)		21%

Tabela 2. Numri i lëndëve të grumbulluara

Duket qartë se, gjykatat kishin një shkallë më të lartë të rasteve të zgjidhura në vitin 2021, por ato performuan më keq në zgjidhjen e çështjeve të lëndëve të grumbulluara në krahasim me vitin 2020.

## Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) është në një fazë të avancuar. SIML synon të rrisë transparencën dhe efikasitetin në sistemin gjyqësor duke vënë në dispozicion të publikut të dhënat mbi çështjet gjyqësore dhe duke thjeshtëzuar menaxhimin e fluksit të rasteve.<sup>17</sup> Përderisa shumica e gjykatave tashmë janë duke përdorur një sistem të tillë, duke përfshirë Gjykatën e Apelit, Gjykatën Supreme, Prokurorinë e Apelit dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, edhe më tej është duke u punuar në aplikimin e plotë të SIML.<sup>18</sup>

SIML aplikohet për të gjitha llojet e çështjeve gjyqësore përfshirë çështjet penale, civile, ekonomike, administrative dhe kundërvajtëse si dhe në të gjitha nivelet e gjykatave: në Gjykatën Supreme, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore. Sistemi është në fazën përfundimtare të zhvillimit dhe testimin në Dhomën e Posaçme të Gjykatës së Lartë dhe zbatimi i tij do të nisë në gjysmën e dytë të vitit 2022.<sup>19</sup> Përveç kësaj, trajnerët e Projektit TIK/SIML kanë trajnuar stafin e gjykatave për përdorimin e sistemit SIML. Deri më tani, në sistem janë regjistruar 372,449 raste; nga të cilat 172.113 janë të zgjidhura dhe 200.336 të pazgjidhura. COVID-19 ka shkaktuar vonesa në zbatimin e plotë të sistemit.<sup>20</sup> **Progres i mirë**

## Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar

Në vitin 2020, Ministria e Drejtësisë (MD) nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje të bashkëpunimit

<sup>10</sup> Shihni raportet vjetore në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/kosovo\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/kosovo_en).

<sup>11</sup> KGJK, Raport Statistikor mbi Gjykatat, 2020.

<sup>12</sup> KGJK, Raport Statistikor mbi Gjykatat, 2021

<sup>13</sup> Shënim: kjo shifër paraqet numrin e rasteve të pazgjidhura në fund të vitit 2020.

<sup>14</sup> Shënim: kjo shifër paraqet numrin e rasteve të pazgjidhura në fund të vitit 2021.

<sup>15</sup> Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave, 2020

<sup>16</sup> Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave, 2021

<sup>17</sup> Për më shumë mbi SMIR, shih: <https://www.img-int.org/project/case-management-information-system-NOR107>.

<sup>18</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor, 2021.

<sup>19</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022;

<sup>20</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, janar, 2022;

ndërkombëtar juridik me vendet e tjera, gjë e cila sipas zyrtarëve të kësaj ministrie, ishte për shkak të COVID-19. Megjithatë, në vitin 2021 u nënshkruan tre marrëveshje.<sup>21</sup> **Progres shumë i mirë**

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit**




Fig 1. Numri i marrëveshjeve juridike ndërkombëtare të nënshkuara<sup>22</sup>

## b) Pavarësia dhe paanshmëria

Mjetet e vlerësimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit përfshijnë:

- *besimin e publikut në punën e gjyqësorit (gjykatat dhe Zyra e Prokurorit);*
- *paanshmërinë e gjyqtarëve/prokurorëve - raporti ndërmjet numrit të rasteve të zgjidhura nga Gjykata e Apelit me numrin e ankesave;*
- *mandatin e gjyqtarëve/prokurorëve - numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të emëruar me afat të caktuar.*

### Besimi i publikut në punën e Gjyqësorit

Në vitin 2021, gjykatat rezultuan të kenë kënaqshmëri në publike të nivelit më të lartë të regjistruar ndonjëherë nga 'Public Pulse' në Kosovë, ku 34.6% të të anketuarve janë shprehur si të kënaqur me punën e tyre.<sup>23</sup> Kjo përqindje përdoret si dëshmi për besimin në punën e gjyqësorit.

Nivelet e kënaqshmërisë së publikut në vitin 2021 me punën e Prokurorisë ishin (30.8%) gjithashtu krahasuar me vitin 2020 (22.7%) ishin më të larta.<sup>24</sup> Kënaqshmëria e publikut me punën e gjykatave është rritur për 44,8% ndërsa kënaqshmëria e publikut me punën e Prokurorisë është rritur për 35,7%. **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	Gjykatat		Prokuroria	
	2020	2021	2020	2021
Nivelet e kënaqshmërisë	23.9%	34.6%	22.7%	30.8%
Raporti (%)		44.8%		35.7%

Tabela 3. Kënaqshmëria e publikut me gjykatat dhe prokurorinë

Progresi, ndër faktorët e tjerë, mund t'i atribuohet krijimit të Panelit të Performancës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vitin 2020, i cili i ofron publikut qasje në të dhënat dhe performancën e gjykatës (gjyqtarëve individualisht).

Rritja e ndërgjegjësimit për punën e gjykatave dhe performancën e gjyqtarëve, mund të ketë ngritur besimin në punën e gjyqësorit.<sup>25</sup> Përgjithësisht, transparenca e sistemit të drejtësisë dhe qasja e publikut në informacion kanë ndikim mjaft të madh në ngritjen e besimit të qytetarëve në institucionet gjyqësore.<sup>26</sup>

### Paanshmëria e gjyqtarëve/prokurorëve

Në vitin 2021 në Gjykatën e Apelit janë pranuar 20.340 çështje/ankesa, nga të cilat 16.087 janë

<sup>21</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, janar, 2022;

<sup>22</sup> Shënim: Tre marrëveshjet e nënshkuara të vitit 2021 përfshijnë një marrëveshje me Italinë për transferimin e personave të dënuar, një marrëveshje me Maqedoninë e Veriut për ndihmën juridike ndërkombëtare për çështjet civile si dhe një marrëveshje me Shqipërinë.

<sup>23</sup> UNNP, Raport i Pulsit Publik XXI në: <https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxi>.

<sup>24</sup> UNDP, Raport i Pulsit Publik, 28 korrik, 2021, në: <https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xx>.

<sup>25</sup> USAID, Paneli i ri online avancoi transparençën gjyqësore, 5 qershor 2020, në: <https://www.usaid.gov/kosovo/news-information/news/new-online-dashboard-advances-judicial-transparency>.

<sup>26</sup> Raporti i Balkans Group, dëshimi i gjyqësorit të Kosovës në komunikim me publikun, korrik, 2019

zgjidhur.<sup>27</sup> Në vitin 2020 në gjykatë janë pranuar 14,219 lëndë, prej të cilave 15,048 janë zgjidhur.

Në vitin 2020, gjykata ka zgjidhur raste/lëndë të vjetra të bartura nga viti 2019.<sup>28</sup> Gjykata e Apelit pati një shkallë më të lartë suksesi (105%) në vitin 2020 me ç'rast kishte arritur të zgjidhte 79% të lëndëve që kishte pranuar. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Apelimet e bëra	14,219	20,340
Rastet e zgjidhura	15,048	16,087
Raporti (%)	105%	79%

Tabela 4. Numri i ankimeve të bëra dhe çështjet/rastet e zgjidhura nga Gjykata e Apelit

## Mandati i gjyqtarëve/prokuratorëve

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, neni 105, “Mandati fillestar për gjyqtarët është tre vjet. Mandati i ri-emërimit është i përhershëm deri në moshën e daljes në pension siç përcaktohet me ligj ose nëse emërimi në përputhje me ligjin nuk tërhiqet. Megjithatë, nuk ka të dhëna të disponueshme për mandatin e gjyqtarëve/prokuratorëve (për periudhën raportuese) për të treguar zbatimin e kësaj dispozite në praktikë. **Nuk është shënuar progres**

**Nuk është arritur progres sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit në vitin 2021.**

## c) Llogaridhënja

Mjetet e vlerësimit të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokuratorëve përfshijnë:

- monitorimin e performancës për gjyqtarët;
- disiplinën;
- monitorimin e performancës për prokuratorët; dhe
- raportet e disponueshme për publikun mbi shpenzimet gjyqësore.

## Monitorimi i performancës për gjyqtarët

Kosova posedon udhëzues të vlerësimit të performancës dhe mekanizma monitorues për t'i mbajtur gjyqtarët përgjegjës për vonesat e mundshme të trajtimit të lëndëve të pazgjidhura dhe/ose abstenimet. Ekziston një komision për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, i cili përbëhet nga 12 anëtarë që përfaqësojnë gjykata të ndryshme, dhe një kryetar i zgjedhur nga radhët e anëtarëve të KGJK-së.<sup>29</sup>

Komisioni vlerëson performancën e gjyqtarëve me mandat të përhershëm, gjyqtarëve me mandat fillestar dhe atyre që janë kandidatë për avancim/promovim. Gjyqtarët e zgjedhur për një mandat të ri vlerësohen në fund të trajnimit fillestar 12-mujor dhe vlerësimi i tyre bazohet në njohuritë e fituara gjatë trajnimit. Gjyqtarët e përhershëm vlerësohen sipas mënyrës rastësore.<sup>30</sup> **Progres shumë i mirë**

## Disiplina

Bazuar në standardet ndërkombëtare, gjyqtarët gëzojnë sigurinë e mandatit dhe nuk janë subjekt i largimit arbitrar nga detyra, si parakusht për një gjyqësor të pavarur.<sup>31</sup> Dispozitat ligjore në Kosovë i përmbushin këto standarde. Më konkretisht, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, në bazë të një propozimi të Këshillit përkatës vendos për shkarkimin e një gjyqtari apo prokuratorit dhe se propozimi për shkarkim nga Këshilli përkatës mund të bëhet vetëm në rastet e veprës së rëndë penale, ndonjë shkelle të

<sup>27</sup> KGJK, Raport Statistikor i Gjykatave, 2021.

<sup>28</sup> KGJK, Raport Statistikor i Gjykatave, 2020.

<sup>29</sup> Ibid.

<sup>30</sup> Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, në: <https://www.gjyqesori-rks.org/komisioni-per-vleresimin-e-performances-se-gjyqtareve/?r=M&tabId=0>.

<sup>31</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Forcimi i besimit në gjyqësor, 2019, në: [https://www.echr.coe.int/Documents/Seminar\\_background\\_paper\\_2019\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Seminar_background_paper_2019_ENG.pdf).

ligjit ndërkombëtar ose për shkak të ndonjë neglizhence të madhe të një gjyqtari apo prokurori në marrjen e përgjegjësiave apo kryerjen e detyrave'.<sup>32</sup> **Progres shumë i mirë**

### Monitorimi i performancës për prokurorët

Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve vlerëson punën e prokurorëve.<sup>33</sup> Në vitin 2021, Ministria e Drejtësisë (MD) hartoi një koncept dokument si bazë për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve.<sup>34</sup> **Progres shumë i mirë**

### Raportet e disponueshme për publikun mbi shpenzimet gjyqësore

Bërja publike e raporteve të shpenzimeve gjyqësore mund të jetë një mekanizëm i mirë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) publikojnë të dhëna të përgjithshme buxhetore në raportet e tyre vjetore (duke përfshirë pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shërbimet komunale dhe shpenzimet kapitale), por ato nuk janë mjaftueshëm të detajuara. **Një lloj progresi**

**Në vitin 2021 është bërë progres i mirë në llogaridhënie.**

### d) Transparenca

#### Mjetet e vlerësimit të transparencës së gjyqësorit përfshijnë:

- publikimin e raporteve vjetore (për punën e gjykatave, prokurorive, KPK-së dhe KGJK-së);
- natyrën e ankesave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre; dhe
- hapjen e proceseve gjyqësore ndaj publikut.

#### Publikimi i raporteve vjetore (për punën e gjykatave, prokurorive, KPK dhe KGJK)

Raportet vjetore për vitin 2020 dhe vitin 2021 janë publikuar.<sup>35</sup> Gjithashtu, KGJK ka publikuar edhe Raportin Vjetor Statistikor të Gjykatave për vitet 2020 dhe 2021.<sup>36</sup> **Progres shumë i mirë**

#### Natyra e ankesave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre

Në vitin 2020, KGJK-ja ka trajtuar 135 ankesa kundër gjyqtarëve, prej të cilave 126 janë cilësuar si të pabazuara dhe si të tilla janë hedhur poshtë.<sup>37</sup> Në vitin 2020, KGJK-ja ka trajtuar 20 ankesa të reja kundër gjyqtarëve, nga të cilat dy janë hedhur poshtë, 13 janë përfunduar dhe 5 janë ende në procedurë. Si rezultat i procedurave hetimore, KGJK-ja ka suspenduar një gjyqtar për shkak të një veprë penale, ka shqiptuar dy vërejtje jopublike me shkrim dhe një vërejtje publike me shkrim. Për tre gjyqtarë, KGJK ka shqiptuar dënime me ulje të pagave për një periudhë të pacaktuar.<sup>38</sup>

Viti	2020	Raporti(%)	2021	Raporti (%)	Rritja e ankesave të trajtuara
Ankesa të reja	20		11		
Ankesa të trajtuara	13	65%	8	72,7%	11,8%
Ankesa të patrajtuara	5	38,4%	3	37,5%	

Tabela 5. Numri i ankesave ndaj gjyqtarëve

Në vitin 2021, KGJK-ja ka trajtuar 121 ankesa kundër gjyqtarëve, prej të cilave 106 janë cilësuar si të pabazuara dhe janë hedhur poshtë.<sup>39</sup> Në vitin 2021, KGJK-ja ka trajtuar 11 ankesa të reja, prej

<sup>32</sup> Shih nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/9C0BBF11-FCEE-407B-B070-C1105A070746.pdf>.

<sup>33</sup> Shih Rregulloren nr. 05/2020 për vlerësimin e performancës së prokurorëve, në: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Legjislacioni/rregullore/Rregullore%20Nr.05.2020%20për%20Vlerësimin%20e%20Performancës%20së%20Prokurorëve.pdf>.

<sup>34</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën; 19 tetor, 2021.

<sup>35</sup> KGJK, Raport i Punës, 2021 në dhe KGJK, Raport i Punës, 2020

<sup>36</sup> KGJK, Raport Statistikor i Gjykatave, dhe KGJK, Raport Statistikor për Gjykatat, 2020.

<sup>37</sup> Shënim: këtu përfshihen edhe ankesat nga viti 2019 të cilat janë bartur në vitin 2020.

<sup>38</sup> KGJK, Raporti Vjetor i Punës, 2020.

<sup>39</sup> KGJK, Raporti Vjetor i Punës, 2021



të cilave 8 janë trajtuar/zgjidhur dhe pjesa tjetër janë transferuar në vitin 2022. Nga procedurat hetimore, KGJK-ja ka lëshuar tre vërejtje jo publike me shkrim, katër vërejtje publike me shkrim dhe një shkelje disiplinore. Gjithashtu, KGJK ka shqiptuar një dënim me pagë të reduktuar dhe transferim të përhershëm për një gjyqtar. Në vitin 2021, asnjë gjyqtar nuk është suspenduar apo pushuar nga puna si rezultat i këtyre ankesave.

Jo të gjitha gjykatat publikojnë informacione për natyrën e ankesave kundër gjyqtarëve dhe mënyrën se si janë zgjidhur ato. Për shembull, përderisa Gjykata Themelore në Prishtinë e bën këtë, Gjykata Themelore në Mitrovicë jo.<sup>40</sup> Ka pasur një rritje prej 11.9% në trajtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve. **Progres i pamjaftueshëm**

## Hapja e proceseve gjyqësore për publikun

Procedurat gjyqësore duhet të jenë të hapura për publikun, gjë që në praktikë nuk ndodh gjithmonë.<sup>41</sup> Qasja e publikut në seancat gjyqësore, informacionet për raste specifike dhe vendimet e gjykatës dhe prokurorisë, veçanërisht aktakuzat, janë shpesh sfiduese.

Shumica e seancave janë mbajtur në zyrat e gjyqtarëve. Ueb-faqet e institucioneve nuk ofrojnë përmbajtje të plotë në të gjitha gjuhët zyrtare.<sup>42</sup> Për më tepër, disa gjyqtarë mbyllin seancat penale për publikun në mënyrë arbitrare (në kundërshtim me ligjin) prandaj aktivizimi i mekanizmave të llogaridhënies është i domosdoshëm.<sup>43</sup> COVID-19 pati një efekt të dëmshëm si në mbajtjen e seancave gjyqësore ashtu edhe në qasjen e publikut në ato seanca.<sup>44</sup> Një gjë e tillë ka shpërthim në mospjesëmarrje të palëve në seanca dhe shtyrje të tyre, duke rezultuar në procedime gjyqësore të zgjatura.<sup>45</sup>

Në mes të marsit dhe gushtit të vitit 2020, u zhvilluan vetëm seancat urgjente, siç janë rastet e dhunës në familje dhe çështjet e paraburgimit.<sup>46</sup> Qasja e publikut në seanca është sanksionuar edhe me vendimet e KGJK-së 52/2020 dhe 85/2020.<sup>47</sup> Në disa raste, u zhvilluan seanca virtuale; sikurse ato në Gjykatat Themelore të Ferizajt dhe Gjakovës në vitin 2020.<sup>48</sup>

Situata ndryshoi paksa në vitin 2021, atëherë kur Qeveria kishte lehtësuar kufizimet ndaj COVID-19. Nga qershori i vitit 2019 deri në korrik të vitit 2021, për 26 raste - të gjitha të lidhura me korrupsionin nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.<sup>49</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi sa i përket transparencës.**

## e) Qasja në drejtësi

Mjetet e vlerësimit të qasjes në drejtësi përfshijnë:

- *ofrimin e ndihmës juridike falas;*
- *sigurimin e strehimit për gratë viktime të dhunës në familje; dhe*
- *grupet e marginalizuara (LGBTIQ+ dhe minoritetet).*

<sup>40</sup> Për më shumë, shihni : <https://pristine.gjyqesori-rks.org/vendimet-disiplinore/?r=M&cYear=2021> dhe <https://mitrovica.gjyqesori-rks.org/vendimet-disiplinore/?r=M&cYear=2022>.

<sup>41</sup> Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302> dhe Ligji Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2583>.

<sup>42</sup> Ministria e Drejtësisë, Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, Korrik 2021

<sup>43</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi, Mbyllja e paligjshme dhe arbitrare e seancave gjyqësore për publikun lidhur me lëndët penale, gusht 2019, në: <https://kli-ks.org/en/unlawful-and-arbitrary-closure-of-court-hearings-to-the-public-regarding-criminal-cases/>.

<sup>44</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor 2021.

<sup>45</sup> ÇOHU, Drejtësia Pandemike: Raporti i monitorimit të Gjykatës Shtator 2019 – Gusht 2020, në: [http://cohu.org/repository/docs/14\\_-\\_Pandemi\\_ne\\_drejtessi\\_-\\_ENG\\_-\\_02\\_449668.pdf](http://cohu.org/repository/docs/14_-_Pandemi_ne_drejtessi_-_ENG_-_02_449668.pdf).

<sup>46</sup> Ekonomia Online, Mosmbajtja e seancave iu ka shkaktuar humbje avokatëve, ata kanë punuar me leje speciale, 3 mars 2021, në: <https://ekonomiaonline.com/uncategorized/mosmbajtja-e-seancave-u-shkaktoi-humbje-avokateve-punuan-me-leje-te-vecanta/>.

<sup>47</sup> EULEX, Raport special mbi ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë: vlerësimi dhe rekomandimet për mars 2020 - mars 2021, maj, 2021, në: [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Covid%20Report%20\\_AL.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Covid%20Report%20_AL.pdf).

<sup>48</sup> USAID, Kosova mban me sukses seancën e parë gjyqësore online, më 10 gusht 2020, në: <https://www.usaid.gov/sh/kosovo/news-information/news/kosovo-successfully-holds-its-first-online-court-hearing>.

<sup>49</sup> ROLPIK, Gjyqtarët dhe prokurorët në pushim vjetor, 26 raste korrupsioni dështojnë, 16 korrik 2021, në: <https://www.rolpik.org/gjyqtaret-dhe-prokuroret-ne-pushime-vjetore-deshtojne-26-seanca-gjyqesore-te-korrupsionit/>.

## Ofrimi i ndihmës juridike falas

Në vitin 2020, Agjencia për Ndhmë Juridike Falas ka trajtuar 5246 lëndë, nga të cilat 1856 janë mbyllur, 3390 janë në vazhdim e sipër dhe 3 prej tyre janë ri-hapur.<sup>50</sup> Në vitin 2021, Agjencia ka trajtuar 4597 lëndë, nga të cilat 1256 janë mbyllur dhe 3341 janë në proces e sipër.<sup>51</sup> Në vitin 2021, Agjencia trajtoi 22.9% ankesa më pak. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	Raporti (%)	2021	Raporti (%)	Rritja e numrit të rasteve të mbyllura
Të mbyllura	1,856	35,4%	1256	27,3%	- 22,9%
Në proces e sipër	3,390	64,6%	3341	72,7%	
Të tjera (ri-hapura)	3	0,06%	0	0	
Numri total i rasteve (kërkesave)	5246	100%	4597	100%	

Tabela 6. Numri i rasteve (kërkesave) për ndihmë juridike falas

## Sigurimi i strehimit për gratë viktime të dhunës në familje

Në vitin 2020 janë raportuar 2069 raste të dhunës në familje ndaj grave, ndërsa në vitin 2021 janë raportuar 2432 raste.<sup>52</sup>

Gjithashtu, në vitin 2020 kanë kërkuar dhe iu është siguruar strehim 751 individëve, nga të cilët 630 gra dhe 121 fëmijë. Në vitin 2021, 595 individë kërkuan strehim, nga të cilët 311 gra dhe 284 fëmijë. Strehim iu është ofrua të gjithë individëve sipas kërkesës së tyre.<sup>53</sup> **Progres shumë i mirë**

Viti	2020	Raporti (%)	2021	Raporti (%)	Ngritja e numrit të strehimeve të siguruar
Gra	630	83,9%	311	52,3%	
Fëmijë	121	16,1%	284	47,7%	
Totali i strehimeve të kërkuara	751	100%	595	100%	
Totali i strehimeve të ofruara	751	100%	595	100%	100%

Tabela 7. Numri i individëve që kërkuan dhe iu ofrua strehim

## Grupet e marginalizuara (minoritetet dhe LGBTIQ+)

Në vitin 2020 janë raportuar 3 krime ndaj anëtarëve të grupeve të ndieshme (LGBTIQ+). Në vitin 2021 janë denoncuar 8 krime, nga të cilat 7 janë dërguar në prokurori dhe 1 rast është ende nën hetim.<sup>54</sup> Gjatë vitit 2021, 12.5% më pak raste u sollën para drejtësisë.

Viti	2020	2021
Rastet e raportuara	3	8
Rastet e sjellura para drejtësisë	3	7
Rritje e rasteve të sjellura para drejtësisë	100%	87,5%
Raporti (%)		-12,5%

Tabela 8. Numri i rasteve kundër anëtarëve të komunitetit LGBTIQ+ të sjellura para drejtësisë

Sa i përket komuniteteve pakicë, në vitin 2020 janë raportuar 11 krime ndaj tyre. Në vitin 2021 janë raportuar 14 raste, 8 prej të cilave janë dërguar në prokurori dhe 6 janë ende nën hetim.<sup>55</sup> Si rezultat, 43% më pak raste u sollën para drejtësisë në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak (2020). **Nuk është shënuar progres**

<sup>50</sup> Shih Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, Ndarja e lëndëve sipas organit të cilit i është drejtuar kërkesa ligjore, në: <https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,18>.

<sup>51</sup> Shiko Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas në: <https://anjf.rks-gov.net/desk/inc/media/9F35-4A83-B842-20B2B03B2195.pdf>.

<sup>52</sup> Raporti Vjetor i Punës së Policisë së Kosovës, janar-dhjetor 2021

<sup>53</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Policia e Kosovës, Prishtinë, shkurt. 2022.

<sup>54</sup> Ibid.

<sup>55</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Policia e Kosovës; Prishtinë, shkurt, 2022.

Viti	2020	2021
Rastet e raportuara	11	14
Rastet e sjellura para drejtësisë	11	8
Rritja e rasteve të sjellura para drejtësisë	100%	57
Raporti (%)		-43%

Tabela 9. Numri i rasteve kundër komuniteteve pakicë të sjellura para drejtësisë

**Në vitin 2021 është arritur progres i pamjaftueshëm sa i përket qasjes në drejtësi**

## f) Administrimi i Drejtësisë

Mjetet e vlerësimit të administrimit të drejtësisë përfshijnë:

- numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- përfaqësimin e grave (% e grave gjyqtare dhe prokurore);
- stafin profesional (në gjykata dhe prokurori);
- Menaxhimin e KGJK-së dhe KPK-së; dhe
- Resurset buxhetore.

### Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve në vitin 2021 ishte më i vogël krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2021 ishin 396 gjyqtarë, përderisa në vitin 2020 ishin 417.<sup>56</sup> Kjo paraqet një rënie prej 5% të numrit të gjyqtarëve në vitin 2021.

Në vitin 2021 Kosova kishte 182 prokurorë, ndërsa në vitin 2020 numri i tyre ishte 190.<sup>57</sup> Këto shifra paraqesin një rënie prej 4% të numrit të prokurorëve në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021	Raporti (%)
Numri i gjyqtarëve	417	396	-5%
Numri i prokurorëve	190	182	-4%

Tabela 10. Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Mesatarisht, numri i lëndëve të reja që i caktohen një gjyqtari në muaj varion nga 9 në Gjykatën Supreme deri në 60 në Gjykatat Themelore.<sup>58</sup>

### Përfaqësimi i grave

Në vitin 2020, nga 417 gjyqtarë, 142 prej tyre ishin gra. Në vitin 2021, nga 396 gjyqtarë, 132 prej tyre ishin gra. Krahasuar me vitin 2020, përqindja e gjyqtareve femra në vitin 2021 është ulur për 2.9%. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020		Totali	2021		Totali
	Burra	Gra		Burra	Gra	
Numri i gjyqtarëve	275	142	417	264	132	396
Raporti (%)	66%	34%	100%	67%	33%	100%
Rritja e numrit të gjyqtareve femra					2,9%	

Tabela 11. Numri i gjyqtareve femra

<sup>56</sup> KGJK, Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave 2021 dhe KGJK, Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave 2020

<sup>57</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>58</sup> KGJK, Raporti Vjetor Statistikor i Gjykatave, 2021.

Në vitin 2020, nga 190 prokurorë, 79 ishin gra (42% gra). Nga 182 prokurorë në vitin 2021, 78 prej tyre ishin gra (43%).<sup>59</sup> Krahasuar me vitin 2020, përqindja e grave prokurore është rritur lehtësisht (2.4%). **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2020		Totali	2021		Totali
	Burra	Gra		Burra	Gra	
Numri i prokurorëve	111	79	190	104	78	182
Raporti (%)	58%	42%	100%	57%	43%	100%
Rritja e numrit të grave prokurore					2,4%	

Tabela 12. Numri i prokuroreve femra

### Stafi profesional (në gjykata dhe prokurori)

Në vitin 2020, numri i stafit profesional në gjykata ishte 1091, prej të cilëve 156 bashkëpunëtorë profesionalë dhe 390 zyrtarë ligjorë. Në vitin 2021 numri i stafit profesional ishte 1111, prej të cilëve 171 bashkëpunëtorë profesionalë dhe 388 zyrtarë ligjorë.<sup>60</sup> **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 2. Numri i stafit profesional në gjykata

Në vitin 2021, numri i stafit profesional në sistemin prokurorial ishte 621.<sup>61</sup> Në vitin 2020, numri i të njëjtëve ishte 613.<sup>62</sup> Në vitin 2021, numri i stafit profesional shënoi rritje të lehtë për 1,3%. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 3. Numri i stafit profesional në prokurori

### Menaxhmenti i KGJK-së dhe KPK-së

Sipas raportimeve, 2 anëtarët e mbetur të KPK-së, një përfaqësues nga shoqëria civile dhe një nga Oda e Avokatëve, nuk u zgjodhën. Për përfaqësuesin e OSHC-ve, thirrja është bërë disa herë gjatë viteve 2020 dhe 2021, por nuk raportohet të kenë aplikuar numër i mjaftueshëm i kandidatëve. Asnjë kandidat nuk u emërua po ashtu nga Oda e avokatëve.<sup>63</sup> Një gjyqtar nga komunitetet pakicë është përzgjedhur për KPK-në më 21 janar.<sup>64</sup> **Një lloj progresi**

### Resurset buxhetore

KGJK-ja posedon planifikimet e linjave buxhetore ku paraqiten shpenzimet kryesore dhe burimet e financimit. Planifikimi i fundit buxhetor për periudhën kohore 2019-2021 ishte 29,980,000

<sup>59</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022

<sup>60</sup> Ibid.

<sup>61</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>62</sup> KPK, Raport i punës për vitin 2020

<sup>63</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, janar 2022.

<sup>64</sup> KGJK, Kuvendi zgjedh anëtarin e KGJK-së nga komuniteti joshumicë, më 21 janar 2022, në: <https://www.gjyqesori-rks.org/2022/01/21/kuvendi-zgjedh-anetarin-e-kgjk-se-nga-radhet-e-komunitetit-jo-shumice/>.

euro; të njëjtat shuma janë planifikuar edhe për vitet 2020 dhe 2021.<sup>65</sup> **Progres shumë i mirë**

Komisioni për buxhet, financa dhe personel i KPK-së gjatë vitit 2020 ka mbajtur tetë takime pune, gjatë të cilave ka shqyrtuar dhe miratuar: Raportin financiar për vitin 2019, Kërkesën buxhetore të KPK-së për vitin 2020, Vlerësimet e paraprake për buxhetin për periudhën kohore 2021-2022, Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën kohore 2021-2023, kërkesën buxhetore për vitin 2021, vlerësimet e paraprake për periudhën kohore 2020-2023 dhe Rishikimin e buxhetit për vitin 2020.<sup>66</sup> **Progres shumë i mirë**

**Në vitin 2021 është shënuar progres i pamjaftueshëm në administrimin e drejtësisë.**

## g) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me gjyqësorin përfshijnë:

- *Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Sundimin e Ligjit; dhe*
- *Planet Strategjike të KPK-së dhe KGJK-së.*

### Strategjia dhe Plani i Veprimit për Sundimin e Ligjit

Rishikimi i funksionimit të sektorit të sundimit të ligjit rezultoi në hartimin e Strategjisë mbi Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit, dokumente këto që u miratuan në gusht të vitit 2021.<sup>67</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit përfshijnë masa specifike që synojnë të përmirësojnë kuadrin institucional kundër korrupsionit, sistemin e deklarimit të pasurisë dhe rregulloret mbi pranimin e dhuratave.

Zbatimi i Strategjisë ka filluar në janar të vitit 2022. Komiteti drejtues mbajti mbledhjen e parë, në të cilën MD-ja ofroi informacion për finalizimin e Kodit të Procedurës Penale, finalizimin e Ligjit për Gjykatën Ekonomike, përgatitjen e ligjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e sanksioneve penale, rregullimin dhe caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizimin në kuadër të MD-së, finalizimin e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë e Pasurisë dhe Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, aktivitetet për parandalimin e dhunës në familje, aktet nënligjore për ndërmjetësimin dhe mbledhjen e të dhënave për efikasitetin e sistemit sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (KEEDJ).<sup>68</sup> **Progres shumë i mirë**

### Planet Strategjike të KPK-së dhe KGJK-së

KGJK-ja ka hartuar një Plan Strategjik për periudhën kohore 2020-2022 përderisa ky këshill veç posedon një plan për periudhën kohore 2019-2021.<sup>69</sup> Një grup punues ka filluar punën për hartimin e Planit të ri Strategjik të Këshillit Prokurorial të Kosovës për periudhën kohore 2022-2024.<sup>70</sup>

Për periudhën raportuese nuk është ndërmarrë asnjë veprim për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik. KGJK-ja në planin vjetor të punës ka përfshirë në formën e aktiviteteve edhe kërkesat që dalin nga Plani Strategjik për periudhën kohore 2020-2021. Për të vlerësuar zbatimin e aktiviteteve të parapara me planin e punës, KGJK-ja do të përgatisë një raport gjithëpërfshirës në vitin 2022<sup>71</sup> - Nuk ka të dhëna për të matur progresin e arrirë.

<sup>65</sup> KGJK, Korniza e Shpenzimeve Afatmesme 2019-2021, në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/KGJK\\_KORNIZA\\_AFATMESME\\_SHPENZIMEVE\\_2019-2021\\_26\\_02\\_2019.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/KGJK_KORNIZA_AFATMESME_SHPENZIMEVE_2019-2021_26_02_2019.pdf).

<sup>66</sup> KPK, Raport i punës për vitin 2020

<sup>67</sup> Ministria e Drejtësisë, Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026

<sup>68</sup> KGJK, Mbahet mbledhja e parë e Komisionit pas miratimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit, më 31 janar, 2022, në: <https://www.gjyqesori-rks.org/2022/01/31/mbahet-takimi-i-pare-i-komitetit-drejtues-pas-miratimit-te-strategjise-per-sundimin-e-ligjit/>; dhe Ekonomia Online, mbahet Mbledhja e parë e Komisionit në: <https://ekonomiaonline.com/politike/mbahet-takimi-i-pare-i-komitetit-drejtues-te-strategjise-per-sundimin-e-ligjit/>.

<sup>69</sup> KGJK, Plani Strategjik 2020-2022, 26 shkurt, 2022 and KPC, Strategic Plan 2019-2021, 26 February 2020

<sup>70</sup> ROLPIK, themelohet grupi punues për hartimin e Planit Strategjik për Sistemin Prokurorial të Kosovës 2022-2024, më 29 qershor, 2021, në: <https://www.rolpik.org/themelohet-grupi-punues-per-hartimin-e-planit-strategjik-te-sistemit-prokurorial-te-kosoves-per-periudhen-2022-2024/>.

<sup>71</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, tetor 2022.

Gjyqësori	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Efikasiteti dhe efektiviteti			✓		
Pavarësia dhe paanshmëria	✓				
Qasja në drejtësi		✓			
Administrimi i Drejtësisë		✓			
Korniza ligjore					✓
<b>Progresi i përgjithshëm</b>			✓		

Progresi i përgjithshëm për Gjyqësorin

## Niveli i progresit në kornizën ligjore - Progres shumë i mirë.

Në vitin 2021, një lloj progresi është shënuar sa i përket Gjyqësorit.

## 2. Lufta kundër korrupsionit

Së bashku me një gjyqësor efektiv dhe të pavarur, lufta kundër korrupsionit është një nga komponentet kryesore për matjen e progresit të një vendi në fushën e sundimit të ligjit. Meqenëse korrupsioni minon sundimin e ligjit dhe stabilitetin e institucioneve demokratike, kërkohet një kornizë solide legjislative dhe institucione të besueshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin dhe përhapjen e korrupsionit.<sup>72</sup>

Lufta kundër korrupsionit është vendosur në kuadër të Shtyllës I: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, të ERA II. Ndër të tjera, fokusi kryesor qëndron në lehtësimin e procesit të trajtimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, reduktimin e efektit të pandemisë globale në seancat gjyqësore që trajtojnë gjykimet penale, miratimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit për korrupsionin e nivelit të lartë në përputhje me opinionet e Komisionit të Venecias.<sup>73</sup> Përveç kësaj, lufta kundër korrupsionit është vendosur në Bllokun I: Kriteret Politike të Qeverisë në PKZMSA.<sup>74</sup>


### Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve të luftës kundër korrupsionit, janë përdorur këta nën-indikatorë:

- *perceptimi publik mbi korrupsionin*- informacion mbi perceptimin lidhur me nivelin e korrupsionit në institucionet publike;
- *parandalimi* - të dhëna për rastet e konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë nga politikanët dhe aktivitetet e agjencive kundër korrupsionit;
- *masat kundër korrupsionit të nivelit të lartë* - informacion mbi hetimin, ndjekjen penale, gjykimin, aktgjykimet dënuese dhe mekanizmat e regjistrimit të të dhënave;
- *konfiskimi i pasurisë* - të dhënat për fondet e konfiskimit, vlerën e pasurisë së konfiskuar dhe vlerën e pasurisë së shitur; dhe
- *korniza ligjore*- nëse ligjet dhe strategjitë janë miratuar dhe/ose janë duke u zbatuar.

<sup>72</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.

<sup>73</sup> Agjenda e Kosovës për Reformën Europiane (ERA) II, 2020.

<sup>74</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016



Lufta kundër korrupsionit dhe nën-indikatorët

### a) Perceptimi publik mbi korrupsionin

Mjeti i vlerësimit të perceptimit të publikut mbi korrupsionin përfshin:

- *nivelin i korrupsionit në institucionet publike.*

#### Niveli i korrupsionit në institucionet publike

Rezultati i Indeksit të Perceptimit mbi Korrupsionin (IPK) për Kosovën në vitin 2020 ishte 36, ndërsa në vitin 2021 ishte 39. Kjo paraqet një rritje prej 8% të këtij indeksi në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak.<sup>75</sup> **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 4. Rezultatet e Indeksit të Perceptimit mbi Korrupsionin (IPK)

Krahasuar me vendet e tjera në rajon, Kosova dhe Mali i Zi kanë bërë përparim në nivelet e perceptimit mbi korrupsionin; Kosova renditet në vendin e 87-të, Mali i Zi në vendin e 64-të dhe vendet e tjera të rajonit janë prapa. Megjithatë, rezultati mesatar i IPK-së për BP është ende më i ulët (38.6) krahasuar me mesataren e BE-së (64) ose mesataren globale (43).<sup>76</sup>

**Në vitin 2021, është shënuar progres i pamjaftueshëm në perceptimin e publikut mbi korrupsionin.**

### b) Parandalimi

Mjetet e vlerësimit të parandalimit të korrupsionit përfshijnë:

- *Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK)- ose numrin e rasteve të trajtuara nga AKK;*
- *deklarimin e pasurisë (nga zyrtarët); dhe*

<sup>75</sup> Transparency International, Perceptimi i Indeksit të Korrupsionit: Kosova, 2021, at <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/ksv>.

<sup>76</sup> Ballkani Perëndimor Evropian, Transparency International 2021, CPI Progresi dhe stagnimi në vendet e Ballkanit Perëndimor në: <https://europeanwesternbalkans.com/2022/01/27/transparency-international-2021-cpi-progress-stagnation-and-backsliding-in-the-western-balkan-countries/>.

- *konfliktin e interesit*- ose numrin e rasteve të lidhura me korrupsionin të dërguara për hetime të mëtejshme penale

### Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)

Në vitin 2021, numri i rasteve të trajtuara nga Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit ishte 374.<sup>77</sup> Në vitin 2020, ky numër ishte 313, që shënon një rritje prej 19%.<sup>78</sup> **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 5. Numri i rasteve të trajtuara nga AKK

Që nga viti 2018, Kosova nuk posedon ndonjë Strategji Kundër Korrupsionit në fuqi. Strategjia Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2018-2022 janë finalizuar dhe aprovuar nga qeveria, por ende nuk janë miratuar nga Kuvendi. Për më tepër, Strategjia Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit për periudhën kohore 2021-2023 nuk janë dërguar në Kuvend për miratim.<sup>79</sup>

### Deklarimi i pasurisë

Të gjithë zyrtarët e lartë publikë duhet të deklarojnë pasurinë e tyre në AKK.<sup>80</sup> Në vitin 2021, nga 4892 zyrtarë, 4783 ose 98% prej tyre kanë deklaruar pasurinë.<sup>81</sup> Në vitin 2020, nga 4721 zyrtarë të lartë publikë, 4625 ose 98% prej tyre kanë deklaruar pasurinë.<sup>82</sup> Edhe pse numri i zyrtarëve që deklarojnë pasurinë është i lartë në të dy vitet, për vitin 2021 nuk raportohet asnjë progres. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Numri i zyrtarëve publik që janë të detyruar të deklarojnë pasurinë	4721	4892
Numri i zyrtarëve që deklarojnë pasurinë	4625	4783
Raporti (%)	98%	98%

Tabela 13. Deklarimi i e pasurisë

Në sistemin e deklarimit dhe vlerësimit të origjinës së pasurisë që iu përket zyrtarëve të lartë publikë janë të pranishme mangësitë e mëposhtme, të cilat përfshijnë: personelin e pamjaftueshëm, nevojën për shtimin e burimeve të TI-së dhe trajnimeve, aplikimin e një sistemi elektronik për deklarimin e pasurisë dhe nevojën për të ngritur transparencën dhe saktësinë në procesin e monitorimit dhe verifikimit.<sup>83</sup>

### Konflikti i interesit

Në vitin 2020, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka trajtuar 313 raste, prej të cilave 179 ishin raste të reja dhe 124 të tjera të bartura nga viti paraprak. Prej tyre, 124 raste i janë referuar Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë për hetime të mëtutjeshme, 16 janë dorëzuar në organet kompetente administrative për fillimin e procedurës disiplinore, 112 janë mbyllur dhe 61 raste kanë mbetur të trajtohen në vazhdim.<sup>84</sup>

<sup>77</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Prishtinë, shkurt 2022.

<sup>78</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit, Raporti Vjetor i Punës 2020, Mars 2021

<sup>79</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor 2021

<sup>80</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe një Deklarim mbi origjinën dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publikë, në: <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20declaration%20of%20property%20of%20senior%20public%20officials.pdf>.

<sup>81</sup> Nga 4892 zyrtarë, 4783 kanë deklaruar pasurinë e tyre në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, 27 prill, 2021, në: [https://www.akk-ks.org/lajmi\\_i\\_plote/49337](https://www.akk-ks.org/lajmi_i_plote/49337).

<sup>82</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit, Raporti Vjetor i Punës 2020.

<sup>83</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, 19 tetor 2021.

<sup>84</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit. Raporti Vjetor i Punës 2020.



Në vitin 2021, AKK ka hetuar 375 raste, nga të cilat 61 ishin bartur nga vitet e mëparshme dhe 314 prej tyre ishin raste të reja. Prej tyre, 150 janë referuar në Prokurori dhe Polici për hetime të mëtejshme, 2 në organet kompetente administrative për fillimin e procedurës disiplinore, 71 raste janë mbyllur dhe 152 raste kanë mbetur të trajtohen tutje.<sup>85</sup> Në vitin 2021, përqindja e rasteve të mbyllura është ulur për 47.1%. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	Raporti (%)	2021	Raporti (%)	Rritja në rastet e mbyllura
Kallëzime penale	124	39,6	150	40	
Shkeljet administrative	16	5,1	2	0,53	
Rastet e mbyllura	112	35,8	71	18,93	-47,1%
Çështjet/rastet në procedurë	61	19,5	152	40,53	
<b>Totali</b>	<b>313</b>	<b>100%</b>	<b>375</b>	<b>100%</b>	

Tabela 14. Veprimet e AKK-së në rastet e konfliktit të interesit

**Në vitin 2021, nuk ka pasur progres në parandalimin e korrupsionit.**

### c) Masat kundër korrupsionit të nivelit të lartë

Mjetet e vlerësimit të masave kundër korrupsionit të nivelit të lartë përfshijnë:

- hetimet;
- ndjekjen penale
- gjykimin;
- aktgjykimet dënuese (në lidhje me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë); dhe
- mekanizmin e regjistrimit të të dhënave - rishikimi nëse mekanizmi ka përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.

### Hetimi

Prokurori i Shtetit posedon bazën e të dhënave që përmban informacione për rastet e regjistruara të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Kjo bazë e të dhënave përfshin të dhëna për 79 raste të profilit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në vitin 2021 janë regjistruar 10 raste të reja të korrupsionit në nivelit të lartë dhe janë ngritur 7 aktakuza.<sup>86</sup> Në vitin 2020 janë regjistruar 8 raste dhe janë ngritur 10 aktakuza.<sup>87</sup> Kjo paraqet një rritje prej 25% të rasteve të regjistruara të korrupsionit të nivelit të lartë. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 6. Numri i rasteve të regjistruara të korrupsionit të nivelit të lartë

### Prokuroria

Në vitin 2020 janë ndjekur penalisht 10 raste të korrupsionit të nivelit të lartë, ndërsa në vitin 2021 janë ndjekur penalisht 7 raste.<sup>88</sup> Rastet e ndjekjeve penale në vitin 2021 kanë shënuar rënie për 30% krahasuar me vitin paraprak. **Nuk është shënuar progres**

<sup>85</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit. Raporti Vjetor i Punës 2021.

<sup>86</sup> Prokurori i Shtetit, Raport për punën e Prokurorit të Shtetit për gjashtëmuajorin e parë -2021, gusht, 2021

<sup>87</sup> Prokurori i Shtetit. Raporti i punës 2020, Shkurt 2021.

<sup>88</sup> Raporti për punën e Prokurorit të Shtetit




Fig 7. Numri i rasteve të proceduara penalisht të korrupsionit të nivelit të lartë

## Gjykimi

Nuk janë dhënë informata nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

## Aktgjykimet dënuese

Nuk janë dhënë informata nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

## Mekanizmi i regjistrimit të dhënave

Krijimi i një mekanizmi ndërinstitucional për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave me qëllim të monitorimit dhe koordinimit të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar të nivelit të lartë ka qenë kërkesë kryesore për monitorimin e progresit të Kosovës në fushën e sundimit të ligjit.<sup>89</sup>

Fillimisht një mekanizëm i tillë ka përfshi vetëm rastet e nivelit të lartë të korrupsionit, por më pas ai u zgjerua dhe si i tillë përfshin të gjitha rastet. Në vitin 2021, Kosova nuk ka bërë përparim në përfshirjen e të gjitha rasteve të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar në mekanizmin ndërinstitucional të regjistrimit të të dhënave. Megjithatë, progres i pamjaftueshëm është shënuar me regjistrimin e një rasti të krimin të organizuar të nivelit të lartë, duke e shpjer numrin e përgjithshëm në 79.<sup>90</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres sa i përket masave kundër korrupsionit të nivelit të lartë.**

## d) Konfiskimi i pasurisë

### Mjetet e vlerësimit të konfiskimit të pasurisë përfshijnë:

- vlerën përfundimtare të pasurisë së konfiskuar;
- vlerën e aseteve të shitura; dhe
- fondin e konfiskimit.

### Vlera përfundimtare e aseteve të konfiskuara

Në vitin 2020, vlera e pasurisë së konfiskuar ishte 476,490 euro.<sup>91</sup> Ndërsa, në vitin 2021, kjo vlerë arriti në 731,236 euro, dhe paraqet një rritje prej 53% nga viti paraprak.<sup>92</sup> **Progres i mirë**

Viti	2020	2021
Vlera e pasurisë së konfiskuar	476,490 EUR	731,236 EUR
Raporti (%)		53%

Tabela 15. Vlera e pasurisë së konfiskuar

### Vlera e aseteve të shitura

Në vitin 2020, vlera e aseteve të shitura ishte 53,354 euro.<sup>93</sup> Në vitin 2021, vlera e aseteve të shitura

<sup>89</sup> GLPS, Mekanizmi i ndarjes në etapa nga BE: "Themelet e para'bazike": Rezultatet dhe Sfodat, shkurt. 2018

<sup>90</sup> Prokurori i Shtetit, Raporti i Punës 2020, shkurt, 2021.

<sup>91</sup> Ibid.

<sup>92</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>93</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor 2021.

ishte 105,397.26 euro.<sup>94</sup> Kjo paraqet një rritje prej 97% krahasuar me vitin paraprak. **Progres shumë i mirë**

Viti	2020	2021
Vlera e asetëve të shitura	53,354.00 EUR	105,397.26 EUR
Raporti (%)		97%

Tabela 16. Vlera e asetëve të shitura

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar has në sfidat në menaxhimin e [1.6 milionë në vitin 2020] asetëve të portofolit të saj, pjesërisht për shkak se gjykatat të cilat nuk lejojnë shitjen e asetëve.<sup>95</sup>

### Fondi i konfiskimit

Një fond konfiskimi - siç kërkohet nga BE-ja - nuk është krijuar. Fondi do të ndajë mjete nga asetet e konfiskuara pjesërisht për zbatimin e ligjit, prokurorinë dhe gjykatat dhe pjesërisht për projektet sociale. Grupi punues është formuar, i cili ka hartuar një koncept dokument për krijimin e Fondit të Konfiskimit. Koncept dokumenti ka kaluar fazën preliminare dhe atë të diskutimit publik dhe së shpejti do t'i dërgohet qeverisë për një vendim.<sup>96</sup> **Një lloj progresi**

**Në vitin 2021 është arritur një lloj progresi në konfiskimin e pasurisë.**

### e) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me luftën kundër korrupsionit përfshijnë:

- *rishikimin e Kodit të Procedurës Penale;*
- *pakon ligjore kundër korrupsionit - Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligji për deklarimin e pasurisë; dhe*
- *rishikimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike.*

### Rishikimi i Kodit të Procedurës Penale (KPP)

Kodi i Procedurës Penale (KPP) duhet të rishikohet për të plotësuar/ndryshuar rregulloren mbi seancën dëgjimore 3-mujore, i cila parashikon që nëse një seancë nuk zhvillohet brenda tre muajsh, gjykimi duhet të ri-fillojë. Draft ligji mbi KPP-në (Nr. 08/L-032) pas aprovimit në komisionin përkatës, është miratuar në parim në tetor të vitit 2021.

Kodi, megjithatë, nuk është rishikuar zyrtarisht dhe është ende tek grupi punues.<sup>97</sup> **Një lloj progresi**

### Pakoja Ligjore Kundër Korrupsionit

Pakoja ligjore kundër korrupsionit i referohet miratimit të Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit (Ligji nr. 03/L-159) dhe Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë. (Ligji nr. 04/L-228). Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit pas aprovimit nga komisioni përkatës është miratuar në parim nga Kuvendi më 20 shtator të vitit 2021.

Ligji, megjithatë, nuk është rishikuar zyrtarisht dhe qëndron edhe më tutje në grupin punues.<sup>98</sup> Sa i përket Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, në vitin 2021, nuk është raportuar asnjë progres.<sup>99</sup> **Një lloj progresi**

<sup>94</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, shkurt 2022.

<sup>95</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor, 2021.

<sup>96</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, shkurt, 2022

<sup>97</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt 2022; dhe Kuvendi i Kosovës, Projekti i Kodit të Procedurës Penale, në: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=271>.

<sup>98</sup> Ibid dhe Kuvendi i Kosovës, Projektligji nr.08/L-017 për Agjencinë Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit, në: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=255>.

<sup>99</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

## Rishikimi i Ligjit për financimin e partive politike

Ndryshimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike është i nevojshëm për reformimin e procesit zgjedhor dhe është një kërkesë e Komisionit të Venecias.<sup>100</sup> Në dhjetor të vitit 2021 u zhvilluan një sërë seancash publike, por ligji nuk u miratua.<sup>101</sup> **Një lloj progresi**

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi në kornizën ligjore.**

Lufta kundër korrupsionit	Asnjë progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Perceptimi publik mbi korrupsionin		✓			
Parandalimi	✓				
Masat kundër korrupsionit të nivelit të lartë	✓				
Konfiskimi i pasurisë				✓	
Korniza ligjore			✓		
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓			

Progresi i përgjithshëm në luftën kundër korrupsionit

### 3. Lufta kundër krimit të organizuar

Së bashku me luftën kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar është një nga fushat kryesore përmes së cilës matet progresi i Kosovës duke pasur parasysh se të dyja mund të pengojnë sundimin e ligjit. Në raportin e vitit 2020, Kosova konsiderohej se ishte në një fazë të hershme të luftës kundër krimit të organizuar.<sup>102</sup>

Në kuadër të ERA II, lufta kundër krimit të organizuar është vendosur në Shtyllën I: Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit. Ndër çështje të tjera, fokusi qëndron në lehtësimin e procesit të trajtimit të rasteve të krimit të organizuar të nivelit të lartë, zvogëlimin e efektit të pandemisë globale në seancat gjyqësore që trajtojnë gjykimet penale si dhe miratimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit për rastet e krimit të organizuar të nivelit të lartë në përputhje me opinionet e Komisionit të Venecias.<sup>103</sup> Përveç kësaj, lufta kundër krimit të organizuar është vendosur në Bllokun I: Kriteret Politike në PKZMSA.<sup>104</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka shënuar progres në përmbushjen e kriterëve të luftës kundër krimit të organizuar, janë përdorur këta nën-indikatorë:**

- niveli i krimit të organizuar*- informacion mbi nivelin e përgjithshëm të krimit të organizuar;
- masat kundër krimit të organizuar* - informacion në lidhje me hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe aktgjykimet dënuese në lidhje me krimin e organizuar;
- droga/ narkotikët*- të dhëna mbi hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe aktgjykimet dënuese në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me drogën/narkotikët
- pastrimi i parave* - të dhëna mbi hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe aktgjykimet dënuese në lidhje me pastrimin e parave;
- lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm* - informacion mbi hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe aktgjykimet dënuese në lidhje me luftën kundër terrorizmit dhe rastet e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe themelimi i Qendrës së Përbashkët të Vlerësimit të Kërcënimeve;

<sup>100</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor, 2021

<sup>101</sup> Telegrafi, Debatë mbi Ligjin për Financimin e Partive Politike në Kosovë, 19 dhjetor, 2021, në: <https://telegrafi.com/debate-per-ligjin-mbi-financimin-e-partive-politike-ne-kosove/>.


<sup>102</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor, 2021.

<sup>103</sup> Agjenda e Reformës Evropiane për Kosovën (ERA) II, 2020

<sup>104</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (PKZMSA), 2016.

f) trafikimi i personave- të dhëna për hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe aktgjykimet dënuese në lidhje me trafikimin; dhe

g) korniza ligjore - nëse ligjet dhe strategjitë janë duke u hartuar dhe zbatuar.



Lufta kundër krimit të organizuar dhe nën-indikatorëve të tij

### a) Niveli i krimit të organizuar

Mjeti i vlerësimit të nivelit të krimit të organizuar bazohet në:

- nivelin e përgjithshëm i krimit të organizuar.

#### Niveli i përgjithshëm i krimit të organizuar

Kosova kishte një rezultat prej 5.19 të kriminalitetit së bashku me vendet si Guinea, Benini dhe Angola.<sup>105</sup> Për vitin 2020, nuk ka të dhëna mbi Indeks Global të Krimit të Organizuar për të krahasuar progresin.

### b) Masat kundër krimit të organizuar

Mjetet e vlerësimit të masave kundër krimit të organizuar përfshijnë:

- hetimin;
- ndjekja penale;
- gjykimin; dhe
- vendimet e fajësisë.

#### Hetimi

Në vitin 2020 janë regjistruar 8 raste të reja të krimit të organizuar. Ndërsa, në vitin 2021, numri arriti në 19. Këto shifra shënojnë një rritje prej 137% të numrit të rasteve të reja të regjistruara të krimit të organizuar.<sup>106</sup> **Progres shumë i mirë**




Fig 8. Numri i rasteve të reja të regjistruara të krimit të organizuar

<sup>105</sup> Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Indeksi Global i Krimit të Organizuar 2021, në: <https://ocindex.net/assets/downloads/global-ocindex-report.pdf>.

<sup>106</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Kryeprokurori i Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022

## Ndjekja penale

Në vitin 2020, ka pasur 42 raste të krimit të organizuar (përfshirë 8 raste të reja) nga të cilat numri i aktakuzave të ngritura nga Prokuroria ishte 20 (duke përfshirë 34 persona).<sup>107</sup>

Në vitin 2021, numri i rasteve të krimit të organizuar arriti në 54 (përfshirë 19 raste të reja), nga të cilat numri i aktakuzave të ngritura nga prokuroria ishte 29 (duke përfshirë 54 persona). Kjo paraqet një rritje prej 11% e numrit të aktakuzave të ngritura në vitin 2021. **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2020	2021
Numri i rasteve	42	54
Numri i aktakuzave të ngritura	20	29
Aktakuzat e ngritura (%)	47,6%	53%
Raporti (%)		11%

Tabela 17. Numri i aktakuzave të ngritura

## Gjykimi

Në vitin 2020, nga të gjitha rastet e krimit të organizuar (gjithsej 42) gjykatat vendosën për rastet që përfshijnë 16 persona. Në vitin 2021, nga të gjitha rastet e krimit të organizuar (gjithsej 54), gjykatat vendosën për rastet që përfshijnë 4 persona.<sup>108</sup> Në vitin 2021, shifrat tregojnë për një rënie prej 75% të numrit të personave me aktgjykime dënuese. **Nuk është shënuar progres**




Fig 9. Numri i personave me vendime gjyqësore të formës së prerë

## Aktgjykimet dënuese

Në vitin 2020, nga 42 raste të krimit të organizuar, gjykatat vendosën për rastet me 16 persona, nga të cilët 15 ishin aktgjykime të fajësisë. Në vitin 2021, nga 54 raste të krimit të organizuar, gjykatat vendosën për rastet me 4 persona, nga të cilët 3 ishin me aktgjykime të fajësisë. Në vitin 2021 ka pasur një rënie prej 19% të numrit të personave me vendime të fajësisë. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Numri i personave me vendime të gjykatës	16	4
Numri i personave me aktgjykime dënuese	15	3
Personat me vendime të fajësisë (%)	93%	75%
Raporti (%)		-19%

Tabela 18. Numri i personave me aktgjykime të fajësisë

**Në vitin 2021, është arritur progres i pamjaftueshëm në masat kundër krimit të organizuar.**

<sup>107</sup> Ibid.

<sup>108</sup> Ibid.

## c) Droga/Narkotiket

Mjetet e vlerësimit të rasteve të lidhura me drogën/narkotikët përfshijnë:

- *hetimin;*
- *ndjekjen penale;*
- *gjykimin;*
- *aktgjykimet e dënuese; dhe*
- *konfiskimin e drogës*

### Hetimi

Në vitin 2020 janë regjistruar 906 raste të reja të lidhura me drogën. Ndërsa, në vitin 2021, ky numër arriti në 1105.<sup>109</sup> Kjo shënon një rritje prej 22% të numrit të rasteve të reja të regjistruara që i përkasin drogës. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 10. Numri i rasteve të regjistruara me drogë/narkotikë

### Ndjekjet penale

Në vitin 2020, numri i rasteve të lidhura me drogën ishte 1850 (përfshirë 906 raste të reja), nga të cilat janë ngritur 933 aktakuza.

Në vitin 2021, numri i rasteve të lidhura me drogën ishte 2133 (përfshirë 1105 raste të reja), nga të cilat Prokuroria ka ngritur 1177 aktakuza.<sup>110</sup> Kjo paraqet një rënie prej 10% të numrit të aktakuzave të ngritura në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres asnjë progres**

Viti	2020	2021
Numri i rasteve	1850	2133
Numri i aktakuzave të ngritura	933	1177
Aktakuza të ngritura (%)	50%	55%
Raporti (%)		10%

Tabela 19. Numri i rasteve të proceduara me drogë

### Gjykimi

Në vitin 2020, nga 1850 raste të krimit të organizuar, gjykatat vendosën për çështje që përfshinin 378 persona. Në vitin 2021, nga 2133 raste të lidhura me drogën, gjykatat vendosën për çështje që përfshinin 415 persona.<sup>111</sup> Në vitin 2021, shifrat tregojnë një rritje prej 9.8% të numrit të personave me vendime të formës së prerë. **Progres i pamjaftueshëm**

### Aktgjykimet dënuese

Në vitin 2020, nga 1850 raste të lidhura me drogën, gjykatat kanë vendosur për çështje që kanë të bëjnë me 378 persona, nga të cilët 367 ishin vendime të fajësisë.

Në vitin 2021, nga 2133 raste të lidhura me drogën, gjykatat vendosën për çështje që përfshinin

<sup>109</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>110</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>111</sup> Ibid.

415 persona, me ç' rast për 390 raste kishte aktgjykime të fajësisë.<sup>112</sup> Në vitin 2021 ka pasur një rënie prej 6% të numrit të personave me vendime të fajësisë. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Numri i personave me vendime gjyqësore	378	415
Numri i personave me aktgjykime të fajësisë	367	390
Personat me vendime të fajësisë (%)	97%	94%
Raporti (%)		-6%

Tabela 20. Numri i personave me aktgjykime të fajësisë

## Konfiskimi i drogës

Në vitin 2020, u konfiskuan 9803,65 g heroinë, 2676,85 g kokainë, 225,42 g ekstazi, 256717,9 g marihuanë dhe 5,622 bimë kanabis. Në vitin 2021, u konfiskuan 3642,31 g heroinë, 414958,18 g kokainë, 0 g ekstazi, 499549 g marihuanë dhe 2,380 bimë kanabis..<sup>113</sup> **Porgres i kufizuar**

Viti	2020	2021	Raporti (%)	Progresi
Heroinë	9803.65g	3642.31g	-62%	Nuk është shënuar progres
Kokainë	2676.85g	414958.18g	15401.7%	Progres shumë i mirë
Ekstazi	225.42g	0	-100%	Nuk është shënuar progres
Marihuanë	256717.9g	499549g	94.6%	Progres shumë i mirë
Bimë kanabis	5,622	2,380	-57.7%	Nuk është shënuar progres
Progres mesatar				Progres i pamjaftueshëm

Tabela 21. Sasia (e paraqitur në gram) e drogës së konfiskuar

## Nuk është bërë përparim në luftën kundër drogës/narkotikëve

### d) Pastrimi i parave

Mjetet e vlerësimit të rasteve të pastrimit të parave përfshijnë:

- *betimin;*
- *ndjekjen penale;*
- *gjykimin; dhe*
- *aktgjykimet dënuese.*

### Hetimi

Në vitin 2020 janë regjistruar 15 raste të reja të pastrimit të parave. Ndërsa, në vitin 2021 janë regjistruar 9 raste të reja të pastrimit të parave, duke shënuar një rënie prej 40% nga viti 2020.<sup>114</sup>

**Nuk është shënuar progres**




Fig 11. Numri i rasteve të regjistruara të pastrimit të parave

<sup>112</sup> Ibid.

<sup>113</sup> Ibid.

<sup>114</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokuroorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022.



## Ndjekja penale

Në vitin 2020, numri i rasteve të pastrimit të parave ishte 43 (përfshirë 15 raste të reja), prej të cilave nga Prokuroria janë ngritur 33 aktakuza.

Në vitin 2021, numri i rasteve të pastrimit të parave ishte 43 (përfshirë 9 raste të reja), nga të cilat 9 aktakuza janë ngritur nga Prokuroria.<sup>115</sup> Kjo paraqet një rënie prej 72% të numrit të aktakuzave të ngritura në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Numri i rasteve	43	43
Numri i aktakuzave të ngritura	33	9
Aktakuza %	77%	21%
Raporti (%)		-72%

Tabela 22. Numri i aktakuzave të ngritura

## Gjykimi

Në vitin 2020, nga 43 raste të pastrimit të parave, gjykatat vendosën për rastet që përfshinin 3 persona. Në vitin 2021, nga 43 raste të pastrimit të parave, gjykatat vendosën për çështje që përfshinin vetëm 1 person.<sup>116</sup> Kjo tregon për një rënie prej 66% të numrit të personave me vendime të formës së prerë në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**




Fig 12. Numri i personave me vendime gjyqësore të formës së prerë

## Aktgjykimet dënuese

Në vitin 2020, nga 43 raste të pastrimit të parave, gjykatat vendosën për rastet që përfshinin 35 persona, nga të cilët 32 ishin aktgjykime dënuese. Në vitin 2021, nga 43 raste të pastrimit të parave, gjykatat morën vendim për rastet që përfshinin 4 persona, nga të cilët 3 ishin aktgjykime dënuese.<sup>117</sup>

Duke krahasuar shifrat, në vitin 2021 është evidente një rënie prej 18% e numrit të personave me vendime të fajësisë. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Numri i personave me vendime të gjykatës	35	4
Numri i personave me aktgjykime dënuese	32	3
Personat me vendime të fajësisë (%)	91%	75%
Raporti (%)		-18%

Tabela 23. Numri i personave me aktgjykime të fajësisë

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres në luftën kundër pastrimit të parave.**

## e) Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Mjetet e vlerësimit të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përfshijnë:

- *betimin;*
- *ndjekjen penale;*
- *gjykimin;*
- *aktgjykimet dënuese; dhe*

<sup>115</sup> Ibid.

<sup>116</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>117</sup> Ibid.

- Qendra e Përbashkët e Vlerësimit të Kërcënimeve.

## Hetimi

Në vitin 2020 janë regjistruar 9 raste të reja të lidhura me terrorizmin, ndërsa në vitin 2021 numri i të njëjtave ka qenë 7.<sup>118</sup> Këto shifra paraqesin një rënie prej 22% të numrit të rasteve të lidhura me terrorizmin në vitin 2021. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 13. Numri i rasteve të regjistruara të terrorizmit

## Ndjekja penale

Në vitin 2020 ka pasur 72 raste të lidhura me terrorizmin, përfshirë 9 raste të reja, nga të cilat Prokuroria ka ngritur 17 aktakuza.

Në vitin 2021, ka pasur 64 raste të lidhura me terrorizmin, përfshirë 7 raste të reja, nga të cilat Prokuroria ka ngritur 10 aktakuza.<sup>119</sup> Kjo shënon një rënie prej 30% e numrit të aktakuzave të ngritura në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Numri i rasteve	72	64
Numri i aktakuzave të ngritura	17	10
Aktakuzat e ngritura (%)	23%	16%
Raporti (%)		-30%

Tabela 24. Numri i aktakuzave të ngritura

## Gjykimi

Në vitin 2020, nga 72 raste të pastrimit të parave, gjykatat vendosën për çështje që përfshinin 35 persona. Në vitin 2021, nga 64 raste të lidhura me terrorizmin, gjykatat vendosën për rastet që përfshinin 4 persona.<sup>120</sup> Në vitin 2021, shifrat tregojnë për një rënie prej 89% të numrit të personave me vendime gjyqësore të formës së prerë. **Nuk është shënuar progres**




Fig 14. Numri i personave me vendime gjyqësore të formës së prerë

## Aktgjykimet dënuese

Në vitin 2020, nga 72 raste të pastrimit të parave, gjykatat vendosën për rastet që përfshijnë 3 persona, të cilat përfunduan me aktgjykime dënuese. Në vitin 2021, nga 64 raste të pastrimit të parave, gjykata vendosi për një rast i cili përfshinte 1 person e që rezultoi me një aktgjykim dënues.<sup>121</sup>

<sup>118</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt 2022.

<sup>119</sup> Ibid.

<sup>120</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt 2022.

<sup>121</sup> Ibid.

Vlerat janë 100% në të dyja rastet (të gjithë individët e akuzuar me vendim të gjykatës u shpallën fajtorë). **Progres shumë i mirë**

Viti	2020	2021
Numri i personave me vendime të gjykatës	3	1
Numri i personave me aktgjykime të fajësisë	3	1

Tabela 25. Numri i personave me aktgjykim dënues

## Qendra e Përbashkët e Vlerësimit të Kërcënimeve

Kosova duhet të krijojë një Qendër të Përbashkët të Vlerësimit të Kërcënimeve, duke përfshirë këtu edhe një sistem të vlerësimit të niveleve të kërcënimit, i cili do të lehtësonte një kuptueshmëri më të madhe ndërmjet të gjitha agjencive të natyrës së ngjashme operative, do ta mbante publikun të informuar dhe do të përmirësonte përgjigjet, duke përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës dhe të dhënave të rëndësishme.<sup>122</sup> Sipas të dhënave, qendra nuk është krijuar. **Nuk është shënuar progres**

**Progres i pamjaftueshem është shënuar në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.**

## f) Trafikimi i Personave (TP)

Mjetet e vlerësimit të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore përfshijnë:

- *betimin;*
- *ndjekjen penale;*
- *gjykimin; dhe*
- *aktgjykimet dënuese.*

### Hetimi

Në vitin 2021 u regjistruan 46 raste të reja të trafikimit të personave (TP). Në vitin 2020, ky numër ishte 15.<sup>123</sup> Kjo shënon një rritje prej 206% të numrit të rasteve të reja të TP në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. **Progres shumë i mirë**




Fig 15. Numri i rasteve të regjistruara të TP

### Ndjekja penale

Në vitin 2021 ka pasur 86 raste të trafikimit të qenieve njerëzore (TP), përfshirë 46 raste të reja, nga të cilat Prokuroria ka ngritur 45 aktakuza. Në vitin 2020 ka pasur 104 raste të TP, përfshirë 15 raste të reja, nga të cilat Prokuroria ka ngritur 28 aktakuza.<sup>124</sup> Këto shifra paraqesin një rritje prej 93% të numrit të aktakuzave në raport me të gjitha rastet e ngritura në vitin 2021. **Progres shumë i mirë**

<sup>122</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor, 2021.

<sup>123</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022

<sup>124</sup> Ibid.

Viti	2020	2021
Numri i rasteve	104	86
Numri i aktakuzave të ngritura	28	45
Aktakuzat e ngritura (%)	27%	52%
Raporti (%)		93%

Tabela 26. Numri i aktakuzave të ngritura

## Gjykimi

Në vitin 2021, nga 86 raste të TP, gjykatat vendosën për 7 të tilla që përfshinin 415 persona. Në vitin 2020, nga 104 raste të krimit të organizuar, gjykatat vendosën për raste që përfshinin 378 persona. Numri i lëndëve me aktgjykim të formës së prerë deri më tani nuk është raportuar.<sup>125</sup>

### Progres shumë i mirë




Fig 16. Numri i personave me vendime gjyqësore të formës së prerë

## Aktgjykimet dënuese

Në vitin 2021, nga 86 çështje të TP, gjykatat vendosën për çështje që përfshinin 7 persona, nga të cilët 4 ishin aktgjykime dënuese. Në vitin 2020, nga 104 raste të TP, gjykatat nuk kanë marrë ende vendim për asnjë prej këtyre rasteve.<sup>126</sup> **Progres i mirë**

Viti	2020	2021
Numri i personave me vendim të gjykatës	0	7
Numri i personave me aktgjykime të fajësisë	0	4
Raporti (%)	0%	57%

Tabela 27. Numri i personave me aktgjykime të fajësisë

**Në vitin 2021 është shënuar progres i mirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.**

## g) Korniza ligjore

Mjetet/metodat e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar përfshijnë:

- *Strategjinë dhe Planin i Veprimit Kundër Krimit të Organizuar;*
- *Kodin e Procedurës Penale;*
- *Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;*
- *Ligjin për Sigurinë Kibernetike;*
- *Strategjinë dhe Planin i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ; dhe*
- *Strategjinë dhe Planin i Veprimit për Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.*

## Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër krimit të organizuar

Shumë aktivitete mbetën të realizuara gjatë viteve 2020 dhe 2021 për shkak të COVID-19. Si rrjedhojë, pati vonesa në realizimin e aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë.<sup>127</sup> **Nuk është shënuar progres**

<sup>125</sup> Ibid.

<sup>126</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>127</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme, nëntor, 2022.

## Kodi i Procedurës Penale (KPP)

Draft Ligji i KPP-së nr. 08/L-032 është miratuar në parim në Kuvend më 19 tetor, 2021, pasi është aprovuar nga komisioni përkatës. Megjithatë, Kodi nuk është rishikuar zyrtarisht dhe gjendet ende në shqyrtim në grupit punues.<sup>128</sup> **Një lloj progresi**

## Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit duhet të ndryshohet për të qenë plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Brenda periudhës raportuese, nuk është bërë ndonjë përparim në plotësim/ndryshimin e ligjit.<sup>129</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Ligji për Sigurinë Kibernetike

Ligji për Sigurinë Kibernetike ende nuk është miratuar.<sup>130</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Trafikimit të Personave- TP)

Sipas raportimeve, është formuar një grup punues (GP) lidhur me këtë çështje. Ky GP ka hartuar Strategjinë e re Kundër Trafikimit të Personave, e cila ende nuk është finalizuar dhe miratuar. Kjo strategji është planifikuar të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2022.<sup>131</sup> **Një lloj progresi**

## Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Në vitin 2015 u miratua Ligji për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit. Kosova ishte një ndër shtetet e para në rajon që miratoi Strategjinë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për periudhën kohore 2015-2020. Strategjia mbulon katër shtylla të rëndësishme si identifikimin, parandalimin, ndërhyrjen dhe riintegrimin e luftëtarëve terroristë të huaj të kthyer .

Nga mbi 400 individë që janë larguar nga Kosova, është evidentuar se janë kthyer 259 prej tyre, duke përfshirë 131 burra, 39 gra dhe 89 fëmijë. Po ashtu janë bërë përpjekje të vazhdueshme për rehabilitimin dhe riintegrimin e Luftëtarëve Terrorist të Huaj të kthyer dhe familjeve të tyre, por ekziston nevoja për rritjen e kapaciteteve të Divizionit të Riintegrimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe përfshirjen e komunave në planifikimin dhe zbatimin e procesit të rehabilitimit dhe riintegrimit.<sup>132</sup>

Strategjia e re, e cila do të kontribuoj në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është në hartim e sipër. GP është takuar dhe është në proces të hartimit të strategjisë, megjithatë miratimi është planifikuar të bëhet në tremujorin e fundit të vitit 2022.<sup>133</sup> **Një lloj progresi**

**Në vitin 2021 është bërë një progres ipamjaftueshëm sa i përket kornizës ligjore.**

<sup>128</sup> Intervistë e Grupit për Ballkanik me një zyrtar nga Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, 2 shkurt 2022; dhe Kuvendi i Kosovës, Projekt Kodi i Procedurës Penale, në: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=271>.

<sup>129</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>130</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022;

<sup>131</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme, shkurt, 2022;

<sup>132</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën , 19 tetor, 2021

<sup>133</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme, shkurt, 2022;

Lufta kundër krimit të organizuar	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Niveli i krimit të organizuar					
Masat kundër krimit të organizuar		✓			
Druga/narkotikët	✓				
Pastrimi i parave	✓				
Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm		✓			
Trafikimi i qenieve njerëzore				✓	
Korniza ligjore		✓			
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓			

Progresi i përgjithshëm në luftën kundër krimit të organizuar



Dimensioni II

---

**TË DREJTAT  
E NJERIUT  
DHE LIRITË  
THEMELORE**

## Përmbledhje dhe analizë

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë vlerat kryesore të BE-së të paraqitura gjerësisht në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian.<sup>134</sup> Këto kritere fokusohen në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përmes zbatimit të legjislacionit, zbatimit të të drejtave pronësore, përmirësimit të barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.<sup>135</sup> Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë vendosur nën Shtyllën I: Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit në kuadër të ERA II. Përveç kësaj, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë në kuadër të Bllokut I: Kriteret Politike në PKZMSA, duke e bërë atë një komponent kryesor me të cilin matet progresi i Kosovës çdo vit.<sup>136</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kritereve për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, është përdorur vetëm një indikator:**

### 1. Të drejtat themelore

**Me qëllim të matjes së progresit në këtë fushë, ky indikator përdor nën-indikatorët e mëposhtëm:**

- *Të drejtat civile dhe politike* - më konkretisht liria e shprehjes, liria e fesë, liria e organizimit, barazia gjinore dhe të drejtat e grupeve të marginalizuara;
- *Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore* - e drejta për punë, e drejta e pronës dhe e drejta për arsimim; dhe
- *Kornizën ligjore*- që ka të bëjë me atë nëse ligjet dhe strategjitë janë duke u zhvilluar dhe zbatuar.



Të drejtat themelore dhe indikatorët

#### a) Të drejtat civile dhe politike

**Mjetet e vlerësimit të të drejtave civile dhe politike përfshijnë:**

- *Nivelin e përgjithshëm të të drejtave civile dhe politike;*
- *lirinë e shprehjes;*
- *lirinë ndaj religjionit;*
- *lirinë e asociimit ;*
- *barazinë gjinore;*
- *të drejtat e pakicave;*
- *të drejtat e fëmijëve; dhe*
- *grupet e marginalizuara*

<sup>134</sup> Parlamenti Evropian, Mbrojtja e të drejtave themelore brenda Bashkimit Evropian, në: <https://www.europarl.europa.eu/about-parliament/en/democracy-and-human-rights/fundamental-rights-in-the-eu>.

<sup>135</sup> Kosova- Agjenda e Reformave Evropiane (ERA) II, 2020.

<sup>136</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.



## Niveli i përgjithshëm i të drejtave civile dhe politike

Sipas Indeksit të Freedom House, Kosova është klasifikuar si ‘pjesërisht e lirë’. Në vitin 2020, rezultati i përgjithshëm i progresit të Kosovës ishte 56/100, rezultati për liritë civile ishte 31/60, dhe rezultati për të drejtat politike ishte 25/40.<sup>137</sup> Në vitin 2021, rezultati i përgjithshëm ishte 54/100, rezultati për liritë civile ishte 31/60, ndërsa rezultati për të drejtat politike ishte 23/40<sup>138</sup>

Pra, derisa rezultati i Kosovës për liritë civile dhe politike mbeti i njëjtë, rezultati i përgjithshëm dh i të drejtave politike kishin një rënie të lehtë. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021	Raporti (%)
Të drejtat politike	25/40	23/40	- 8%
Liritë civile	31/60	31/60	0 %
Rezultati i përgjithshëm	56/100	54/100	- 3.6%

Tabela 28. Liritë civile dhe të drejtat politike në Kosovë

## Liria e shprehjes

Rezultati i Kosovës në Indeksin e Freedom House për lirinë e shprehjes në vitet 2020 dhe 2021 ishte 3/4 (75%), duke treguar se ‘të gjithë individët janë të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre personale për tema politike dhe tema të tjera të ndjeshme pa frikë nga vëzhgimi dhe ndëshkimi’.

Gjithashtu, është krijuar një hapësirë e kufizuar për diskutime për tema të ndjeshme si marrëdhëniet etnike dhe çështjet LGBTIQ+, duke shënuar një përmirësim në krahasim me vitet e mëparshme.<sup>139</sup> Vlerësimi i Kosovës në fushën e lirisë së shprehjes është më i mirë krahasuar me atë mbi lirinë e mediave. Megjithatë, në vitin 2021 nuk u raportua asnjë progres. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Liria e shprehjes	3/4	3/4
Raporti (%)	75%	75%

Tabela 29. Liria e shprehjes

## Liria ndaj religjionit

Rezultati i Kosovës në Indeksin e Freedom House për lirinë e fesë në vitet 2020 dhe 2021 ishte 2/4 (50%), që i referohet pyetjes ‘nëse individët janë të lirë të praktikojnë dhe të shprehin besimin ose mosbesimin e tyre fetar në publik dhe në privatësi’.<sup>140</sup> Përderisa Kosova i ka dispozitat ligjore në fuqi, nevojiten përmirësime të mëtejshme veçanërisht në dhënien e statusit ligjor për grupet fetare.<sup>141</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Liria ndaj religjionit	2/4	2/4
Raporti (%)	50%	50%

Tabela 30. Liria ndaj religjionit

## Liria e asociimit

Rezultati i Kosovës për lirinë e asociimit në Indeksin e Freedom House për vitet 2020 dhe 2021 ishte 3/4, që do të thotë se “përgjithësisht liria e asociimit ruhet, por që demonstratat kufizohen herë pas here për arsye të lidhura me sigurinë”.<sup>142</sup>

OJQ-të funksionojnë lirshëm, megjithëse janë vendosur masa që gjykatat të ndalojnë grupet që cenojnë rendin kushtetues ose ato që nxisin urrejtje. OJQ-të luajnë një rol aktiv si mbikëqyrës

<sup>137</sup> Freedom House, Liria në Botë 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>138</sup> Ibid.

<sup>139</sup> Freedom House, Liria në Botë 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021> dhe Freedom House, Liria në Botë 2020, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>.

<sup>140</sup> Ibid

<sup>141</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i vitit 2021 mbi Lirinë Ndërkombëtare Fetare: Kosova

<sup>142</sup> Liria në Botë; Freedom House, 2020, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020> dhe Liria në Botë, Freedom House; 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

mbi punën e qeverisë, ndonëse ato me raste i nënshtrohen presionit për ndalimin e kritikave. Në veçanti, financimi mbetet një shqetësim pasi që në vitin 2020, financimi nga donatorët kishte shënuar rënie. Megjithatë, OSHC-të kanë vazhduar tutje me aktivitetet e tyre edhe në kohë të vështira.<sup>143</sup>

Sa i përket lirisë së sindikatave, punëdhënësit jo gjithmonë i respektojnë të drejtat kolektive të negociimit. Gjithashtu vërehen vështirësi në formimin e sindikatave në sektorin privat për shkak të intimidimit të punëtorëve nga punëdhënësit. Prandaj, në Kosovë ekzistojnë shumë pak sindikata të sektorit privat<sup>144</sup> Nga ana tjetër, sindikatat e sektorit publik vazhdojnë të jenë aktive. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Liria e asociimit	3/4	3/4
Raporti (%)	75%	75%
Liria për OJQ-të	3/4	3/4
Raporti (%)	75%	75%
Liria për sindikatat	2/4	2/4
Raporti (%)	50%	50%

Tabela 31. Liria e asociimit

## Barazia gjinore

Sa i përket përfaqësimit të grave përmirësime pozitive janë shënuar në vitin 2021. Legjislatura aktuale ka 40 gra deputete; shifra më e lartë që nga viti 2008, dhe vetëm 1/3 e tyre e kanë pasur të nevojshme për kuotën ligjore. Gratë kryesojnë 8 nga 14 komisionet funksionale në Kuvend. Gjashtë nga të gjithë 18 anëtarët e qeverisë janë gra, duke përfshirë dy zëvendëskryeministre.<sup>145</sup> Këto përmirësime u pasuan me rritjen e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje, pasi që më shumë gra u vendosën në krye të listave të partive të tyre politike dhe fituan pozita të rëndësishme brenda këtyre partive. Megjithatë, ato morën mbështetje joproporcionale financiare dhe logjistike gjatë fushatave partiake.<sup>146</sup> **Progres i mirë**

## Të drejtat e pakicave

Në vitin 2020, përfaqësimi i pakicave etnike në parlament ishte «proporcional». Megjithatë, përfaqësuesit e komuniteteve pakicë u ankuan për mungesën e konsultimeve për çështje të rëndësishme politike me partitë e shumicës.<sup>147</sup> Bazuar në raportin e Freedom House të vitit 2021, që mbulon periudhën e vitit 2020, komuniteti Rom, Ashkali dhe Goran i Kosovës vazhdoi të përballet me diskriminim në arsim, punësim dhe qasje në shërbimet sociale dhe se e njëjtit u afektuan veçanërisht nga pandemia COVID-19.<sup>148</sup>

Në vitin 2021, përfaqësimi i pakicave etnike në parlament ishte «më se proporcional» dhe se përfaqësuesit e komuniteteve pakicë raportuan bashkëpunim më të mirë me qeverinë. Megjithatë ekziston një kornizë e mirë legjislative, pakicat etnike vazhdojnë të përballen me diskriminim në punësim, arsim, shërbime sociale, përdorimin e gjuhës, lirinë e lëvizjes dhe qasjen në arsim.<sup>149</sup> Raporti i Freedom House i vitit 2022, që mbulon vitin 2021, ka përmendur të njëjtat probleme sikurse në vitin paraprak, duke përfshirë edhe pandeminë COVID-19.<sup>150</sup> **Një lloj progresi**

## Të drejtat e fëmijëve

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili hyri në fuqi në vitin 2020, shënoi një arritje historike në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ai krijoi një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për garantimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit, neglizhencës, dhunës

<sup>143</sup> Liria në Botë; Freedom House, 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>144</sup> Liria në Botë; Freedom House, 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>145</sup> Ibid.

<sup>146</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 19 tetor, 2021 dhe EODS, raporti i zgjedhjeve komunale në Kosovë 2021

<sup>147</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i të Drejtave të Njeriut për Kosovën 2021

<sup>148</sup> Freedom House, Liria në botë, 2021: Kosova, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>149</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i të Drejtave të Njeriut në Kosovë, 2021

<sup>150</sup> Freedom House, Liria në botë 2022: Kosova; në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2022>.

fizike dhe mendore, ose kërcënimeve të tjera që mund të rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin, arsimin ose zhvillimin e fëmijëve.<sup>151</sup> Për më shumë, në vitin 2020, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), e mbështetur nga UNICEF dhe Save the Children, lansoi platformën e parë online “Edukimi në distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç” për të ndihmuar në mbështetjen dhe promovimin e përfshirjes së prindërve në mësimin e hershëm dhe aktivitetet zhvillimore për fëmijët deri në gjashtë vjeç.<sup>152</sup>

Në vitin 2021, qeveria, me ndihmën e donatorëve të huaj, mbështeti 8123 fëmijë me paketa didaktike. Pakoja e qeverisë për Rimëkëmbjen Ekonomike ofroi shtesa për fëmijët dhe nënat e reja - për gjithsej 95,000 përfitues. Gjithashtu, qeveria ndau fonde për punësimin e 100 asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ofroi mbështetje financiare në vlerë prej 900,000 euro për 39 OJQ që ofrojnë shërbime familjare dhe sociale.<sup>153</sup>

Megjithatë, nevojiten përmirësime në planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe decentralizimin e shërbimeve në nivel lokal për të ofruar të drejta të plota dhe të barabarta për fëmijët. **Një lloj progresi**

### Grupet e marginalizuara (LGBTIQ+)

Individët janë kryesisht të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre politike pa frikën e ndëshkimit. Kohët e fundit është krijuar një hapësirë e kufizuar për diskutime mbi tema të ndjeshme si marrëdhëniet ndëretnike dhe çështjet LGBTIQ+, duke shënuar një përmirësim pozitiv në krahasim me vitin 2020.<sup>154</sup>

Megjithatë, personat LGBTIQ+ janë të marginalizuar politikisht dhe interesat e tyre nuk përfaqësohen në politikën e Kosovës. Për më tepër, anëtarët e komunitetit përballen me presion social për të fshehur orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor, si dhe përballen me pengesa me ndryshimet ligjore për këtë çështje; gjithashtu edhe Kodi Civil i Kosovës ende nuk i garanton partneritetet e së njëjtës gjini.<sup>155</sup>

Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për vitin 2021 vë në dukje diskriminime të ndryshme me të cilat përballen komuniteti LGBTQ si në punësim, strehim, qasje në kujdesin shëndetësor dhe arsim.<sup>156</sup> **Një lloj progresi**

**Në vitin 2021, është shënuar progres i pamjaftueshëm sa i përket të drejtave civile dhe politike.**

## b) Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Mjetet e vlerësimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore përfshijnë:

- *të drejtat për punë;*
- *të drejtat e pronës; dhe*
- *qasjen në arsim.*

### E drejta për punë

Pjesa më e madhe e progresit në lidhje me të drejtat për punë ndër vite vlerësohet bazuar në zbatimin e kornizës legjislativë. Institucionet e Kosovës kanë avancuar kornizën ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi lidhur me të drejtën për punë, por në këtë rast propozohen gjithashtu

<sup>151</sup> UNICEF në Kosovë, Raport mbi Gjendjes e të Drejtave të Fëmijëve, 2021, në: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/2646/file/English-2021.pdf>

<sup>152</sup> Ibid.

<sup>153</sup> Zyra e Kryeministrit, Mbledhja e Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve mbahet më 19 nëntor, 2021, në: <https://kryeministri.rks.gov.net/en/the-meeting-of-inter-ministerial-committee-for-the-rights-of-the-child-is-held/>.

<sup>154</sup> Freedom House, Liria në Botë; 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021> dhe Freedom House, Liria në Botë; 2020, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>.

<sup>155</sup> Freedom House, Liria në Botë; 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>156</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i të Drejtave të Njeriut në Kosovë, 2021

reforma të mëtejshme që mund të korrigojnë pjesërisht dallimet në tregun e punës.<sup>157</sup>

Qasja e barabartë [në tregun e punës] për grupet sikurse që janë gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta dhe pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nuk është arritur. Edhe pse e drejta për punë në përgjithësi respektohet, një sërë sfidash janë evidente, si: mungesa e kontratave për një pjesë të madhe të punëtorëve në Kosovë, kushtet e këqija të punës, mungesa e sigurisë dhe e mbrojtjes në punë si dhe rreziku i vazhdueshëm i ndërprerjes së kontratës së punës për punëtorët.

Gjithashtu, paga minimale, e prezantuar në vitin 2011, nuk është rishikuar, edhe pse rishikimi do të duhej të bëhej në fund të çdo viti.<sup>158</sup> **Një lloj progresi**

## Të drejtat pronësore

Rezultati i Kosovës në Indeksin e Freedom House për vitin 2021 për të drejtat pronësore ishte 1/4, duke mos shënuar asnjë ndryshim nga viti 2020. Ai i referohet aftësisë së një individi për të ushtruar të drejtën për të pasur pronë dhe për të krijuar një biznes privat pa ndërhyrje të panevojshme nga akterët shtetërorë ose jo-shtetërorë.<sup>159</sup> Korniza legjislative kryesisht ekziston, por zbatimi dhe fuqizimi i të drejtave të tilla janë të pamjaftueshme. Ekzistojnë çështje që lidhen me të drejtat e trashëgimisë, të tilla si qëndrimet patriarkale që i detyrojnë gratë të heqin dorë nga të drejtat e tyre ndaj anëtarëve burra të familjes.

Qeveria ka iniciuar një numër të politikave që ofrojnë incentiva për gratë dhe burrat për pronësi të përbashkët duke reduktuar ose edhe hequr taksat dhe tarifatat komunale. Megjithatë, kjo gjë nuk ka rritur numrin e grave si pronare të pronave.<sup>160</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Të drejtat e pronës	1/4	1/4
Raporti (%)	25%	25%

Tabela 32. Të drejtat e pronësisë

## Qasja në arsim

Në vitin 2020, përhapja e COVID-19 afektoi të drejtat në arsimim dhe vet cilësinë e arsimit, pasi që shkollat u mbyllën dhe kryesisht ishte ofruar mësimi online. Një numër nxënësish, veçanërisht ata që i përkasin grupeve të cënueshme, nuk kishin qasje në arsim për shkak të mungesës së laptopëve dhe pajisjeve të tjera esenciale të TI-së.<sup>161</sup> Qeveria mori masa për ofrimin e mësimdhënies online përmes transmetuesit publik RTK dhe prezantoi një platformë mësimore online për klasat 1 deri në 9.<sup>162</sup> Megjithëse masat ishin të shpejta dhe në përputhje me situatën, cilësia e mësimit në distancë mbetet e diskutueshme, duke përfshirë këtu cilësinë e materialeve të prezantuara me video dhe qasjen e mësimdhënies.<sup>163</sup>

Përveç kësaj, një sërë çështjesh ndikojnë në shkallën e respektimit të së drejtës në edukim, duke përfshirë braktisjen e edukimit të detyrueshëm nga nxënësit dhe sfidat në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta.<sup>164</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

**Në vitin 2021 është bërë një progres i kufizuar në fushat si ato ekonomike, sociale dhe kulturore.**

<sup>157</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale, 2021- rishikimi për Kosovën\*, 2021; në: <https://www.esap.online/download/docs/ESAP-Social-Rights-Pillar-Report-Kosovo.pdf/f72dc00af90c0fbc60354508ce1c3931.pdf>

<sup>158</sup> Ibid.

<sup>159</sup> Freedom House, Liria në Botë, 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>; dhe Freedom House, Liria në Botë; 2020, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>.

<sup>160</sup> Ibid.

<sup>161</sup> KEC, Vlerësimi i Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë - 2017-2021; Arritje e pamjaftueshme, maj, 2021.

<sup>162</sup> Shikoni platformën në: <https://emesimi.rks-gov.net/shq/>.

<sup>163</sup> KEC, Vlerësimi i Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë - 2017-2021; Arritje e pamjaftueshme, maj, 2021

<sup>164</sup> Zyra e Komisionerit të Lartë, Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2020.

## 2.Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përfshijnë:

- *Ligjin për Lirinë Fetare;*
- *Ligjin për të Drejtat Pronësore;*
- *Ligjin për Barazi Gjinore; dhe*
- *Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve.*

### Ligji për lirinë fetare

Ligji për Lirinë Fetare i cili do të rregullonte statusin e grupeve fetare nuk është miratuar. Ligji (Nr. 02/L-31) për Lirinë Fetare në Kosovë është në fuqi që nga viti 2007. Në vitin 2018 është dërguar në parlament Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit (Nr. 02/L-31) për Lirinë Fetare në Kosovë. Komisioni për të Drejtat e Njeriut e ka shqyrtuar, ndryshuar dhe dërguar për miratim përfundimtar në seancë plenare. Megjithatë, ligji nuk është miratuar në lexim të dytë, pasi që nuk ka marr shumicën e votave në mesin e komuniteteve pakicë.<sup>165</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për të drejtat pronësore

Ligji (Nr. 08/L-013) për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj nuk është miratuar në vitin 2021.<sup>166</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për Barazinë Gjinore

Ligji për Barazinë Gjinore është në fuqi dhe mekanizmat institucional për barazinë gjinore janë në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Masat specifike të qeverisë të ndërmarrë për të mbështetur gratë si pjesë e paketës së rimëkëmbjes ekonomike kanë zbutur disa efekte të dëmshme.

Megjithatë, zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore është duke ndodhur në praktikë. Në veçanti, ligji duhet të zbatohet më tej për të rritur përfaqësimin e grave në politikë duke emëruar më shumë gra në pozita vendim-marrëse si në institucionet private po ashtu edhe në ato publike. Gjithashtu, ekziston nevoja për një koordinim të zgjeruar të aktiviteteve me zyrtarët për barazi gjinore të ministrive dhe komunave. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024) është miratuar në vitin 2020 dhe Plani i Veprimtimit është në proces të hartimit.<sup>167</sup> **Një lloj progres**

### Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës është një zhvillim pozitiv. Korniza ligjore që ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve dhe në masë të madhe përputhet me standardet ndërkombëtare, megjithatë, ekziston nevoja për zbatimin më të madh të këtij ligji.<sup>168</sup>

Në vitin 2021 ishin të pranishme disa sfida: mungesa e fondeve të mjaftueshme për zbatimin e ligjit, mungesa e njohurive në lidhje me ligjin (nga mësuesit dhe punonjësit socialë), veçanërisht në zonat rurale, mungesa e skemave të granteve për rritjen e kapaciteteve të Qendrave për Punë Sociale në nivel komunal (gjë që do të përmirësonte ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve) dhe mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive përgjegjëse për zbatimin e ligjit.<sup>169</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

**Asnjë progres nuk është shënuar sa i përket kornizës ligjore në vitin 2021.**

<sup>165</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, Personat e Pagjetur dhe Peticionet, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>166</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, janar, 2022.


<sup>167</sup> Ibid.

<sup>168</sup> Freedom House, Liria në Botë 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>169</sup> Save the Children Kosova, Tabela e Diskutimeve: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve - një vit pas hyrjes në fuqi në, korrik, 2021, në: [https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Raporti%20i%20tryezes\\_final\\_L.O\\_2.pdf](https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Raporti%20i%20tryezes_final_L.O_2.pdf).

Të drejtat themelore	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Të drejtat civile dhe politike		✓			
Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore		✓			
Korniza ligjore	✓				
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓				

Progresi i përgjithshëm për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore



**Dimensioni III**

---

# **DEMOKRATIZIMI**

## Përmbledhje dhe analizë


Demokracia është një vlerë tjetër shumë e rëndësishme e BE-së, e garantuar me nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Demokratizimi i referohet pjesëmarrjes në vendim-marrjen politike dhe pronësinë lokale të sektorëve që janë vendimtarë për zhvillimin e qëndrueshëm. Theks i veçantë i kushtohet lehtësimit të përfshirjes së grave dhe të rinjve në jetën qytetare dhe politike.<sup>170</sup>

Këto kritere përbëhen nga Media dhe Shoqëria Civile, Stabiliteti Politik, Zgjedhjet dhe Reforma e Administratës Publike dhe përfshihen në kuadër të Shtyllës I: Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit të ERA II.<sup>171</sup> Përveç kësaj, ato përfshihen në Bllokun I: Kriteret Politike në PKZMSA.<sup>172</sup>

Për sa i përket medias, rëndësi e veçantë i kushtohet funksionimit të pavarur financiar dhe editorial të transmetuesit publik dhe miratimit dhe zbatimit të legjislacionit për median në përputhje me standardet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias. Për stabilitetin politik, fokusi është vendosur në stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë. Ndërsa për zgjedhjet, pika kyçe është forcimi i procesit zgjedhor, zbatimi i rekomandimeve të BE-së që rrjedhin nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për financimin e subjekteve politike sipas opinionit të Komisionit të Venecias.<sup>173</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në demokratizim, janë përdorur katër indikatorë thelbësorë si më poshtë:**

1. Media dhe shoqëria civile;
2. Stabiliteti politik;
3. Zgjedhjet; dhe
4. Reforma në Administratën Publike.




Demokratizimi dhe indikatorët

### 1. Media dhe Shoqëria Civile

Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kritereve mbi mediat dhe shoqërinë civile, janë përdorur nën-indikatorët e mëposhtëm:

- *liria e medias*- apo informimi nëse media është e lirë dhe e pavarur, rastet e cënimit të gazetarëve, mbrojtja e sinjalizuesve dhe funksionimi i RTK-së;
- *shoqëria civile*- ose informimin mbi konsultimet e OSHC-ve, financimin publik të OSHC-ve dhe promovimin e platformave të konsultimit; dhe
- *korniza ligjore*- nëse ligjet dhe strategjitë janë duke u hartuar dhe zbatuar.



Media, Shoqëria Civile dhe nën-indikatorët

<sup>170</sup> Komisioni Evropian, Demokracia, në: [https://international-partnerships.ec.europa.eu/policies/peace-and-governance/democracy\\_en](https://international-partnerships.ec.europa.eu/policies/peace-and-governance/democracy_en).

<sup>171</sup> Agjenda e Reformës Europiane për Kosovën (ERA) II, 2020.

<sup>172</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016

<sup>173</sup> Agjenda e Reformës Europiane për Kosovën (ERA) II, 2020.



## a) Liria e medias

### Mjetet e vlerësimit të lirisë së medias përfshijnë:

- media të lira dhe e pavarura;
- cënimin e gazetarëve;
- transmetuesin publik; dhe
- mbrojtjen e sinjalizuesve.

### Media e lirë dhe e pavarur

Gjatë viti 2020, në media është evidentuar ndikimi politik, ngacmimi dhe frikësimi i gazetarëve. Në vitin 2021, ballafaqimi me shumicën e këtyre pengesave vazhdoi dhe se numri i gazetarëve të kërcënuar/ngacmuar në mediat sociale është rritur. Rezultati i Kosovës për mediat e lira dhe të pavarura ka mbetur i pandryshuar (2/4) nga viti 2020 në vitin 2021<sup>174</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Liria e medias	2/4	2/4
Raporti (%)		0%

Tabela 33. Liria e medias

Kosova posedon nivel të duhur i përgatitjes dhe përfiton nga një mjedis pluralist dhe aktiv mediatic. Megjithatë, në ndërkohë janë raportuar shqetësime mbi fushatat e shpifjeve publike, kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve, si dhe mungesën e vet-qëndrueshmërisë financiare. Një ndikim i tillë vërehet edhe tek transmetuesi publik RTK. Megjithatë, që nga periudha raportuese, Kuvendi ka votuar për bordin e ri të RTK-së.<sup>175</sup>

### Cënimi i gazetarëve

Në vitin 2020 janë regjistruar 24 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave. Në vitin 2021 numri u rrit në 29, gjë që përfaqëson një rritje prej 21% të numrit të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave në vitin 2021.<sup>176</sup> **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 17. Cënimi i gazetarëve

### Transmetuesi Publik

Në korrik të vitit 2021, Kuvendi votoi për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së. Shkarkimi erdhi pas rekomandimit të Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal dhe për shkak të refuzimit të RTK-së për t'u audituar si dhe për shkak të mos respektimit të procedurave të prokurimit. Gjithashtu, ka pasur akuza për nepotizëm siç ishin deklaratat rreth punësimit të familjarëve të ish-presidentit të vendit.<sup>177</sup> Para shkarkimit, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere kishte kritikuar dhe hedhur poshtë raportin financiar të RTK-së për vitin 2020 duke rekomanduar me atë rast shkarkimin e bordit.<sup>178</sup>

<sup>174</sup> Freedom House, Liria në Botë 2021, në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>.

<sup>175</sup> Gazeta Express: Këta janë emrat e rinj të Bordit të RTK-së, 6 dhjetor, 2021, në: <https://www.gazetaexpress.com/keta-jane-emrat-e-bordit-te-ri-te-rtk-se/>.

<sup>176</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>177</sup> Aleanca e Mediave Publike, Kosovë: Shkarkimi i bordit të transmetuesit publik RTK, 13 korrik 2021, në: <https://www.publicmediaalliance.org/kosovo-public-broadcaster-rtks-board-sacked/>.

<sup>178</sup> Kallxo.com, Raporti vjetor financiar i RTK-së nuk miratohet, 16 qershor, 2021, në: <https://kallxo.com/lajm/nuk-miratohet-raporti-vjetor-financiar-i-rtk-se/>.

Anëtarët e opozitës kritikuan votimin, duke pretenduar se vendimi ishte i ndikuar politikisht. Disa të tjerë e mbështetën vendimin duke nënvizuar dukuritë e keqpërdorimeve -për dekada- dhe duke i bërë thirrje qeverisë të jetë vigjilente në procesin e votimit për një bord të ri.<sup>179</sup>

Asambleja zgjodhi bordin e ri në nëntor. Me marrjen e detyrës, bordi e shkarkoi drejtorin duke përmendur neglizhencën ndaj parregullsive, abuzimet, mungesën e punës, nepotizmin dhe raportimin e njëanshëm në vazhdimësi.<sup>180</sup> Shkarkimi dhe emërimi ishin transparentë dhe për herë të parë në 20 vjet, RTK kishte një bord ekspertësh të medias pa ndonjë ndërlidhje me politikën.<sup>181</sup>

### Progres shumë i mirë

#### Mbrojtja e sinjalizuesve

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve është kryesisht në përputhje me legjislacionin e BE-së. Edhe legjislacioni sekondar ka hyrë në fuqi dhe i njëjti përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizuesve. Megjithatë, ekziston një domosdoshmëri e madhe për zbatimin e mekanizmave dhe kërkesave mbrojtëse.<sup>182</sup>

Gjetjet në vitin 2020 treguan se të anketuarit që punonin në institucionet e nivelit qendror dhe lokal kishin më shumë njohuri rreth mekanizmave për raportimin e kërcënimeve dhe dëmeve ndaj interesit publik në krahasim me të anketuarit e sektorit privat. Shumica e tyre kishin besim të plotë ose të konsiderueshëm tek mekanizmat në fjalë. Edhe pse shumica e të anketuarve nuk kishin marrë asnjëherë një rast të sinjalizimit, përgjigjet e zyrtarëve tregojnë përputhshmëri të lartë me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, me vendosjen e anonimitetit të sinjalizuesve dhe konfidencialitetit të informacionit si prioritete kryesore në institucionet e tyre.<sup>183</sup>

Në vitin 2021, Këshilli i Evropës (KE) dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ofruan një program të Trajnimit të Trajnerëve (TtT) me temën e sinjalizuesve për anëtarët e IKAP-it duke filluar nga institucionet e ndryshme publike të Kosovës. KE filloi gjithashtu me përgatitjen e një manuali të trajnimit për mbrojtjen e sinjalizuesve për institucionet e Kosovës.<sup>184</sup>

### Një lloj progresi

**Në vitin 2021, është shënuar progres pamjaftueshëm sa i përket lirisë së mediave.**

#### b) Shoqëria civile

Mjetet e vlerësimit të shoqërisë civile përfshijnë:

- *konsultimet e OSHC-ve;*
- *promovimin e platformave të konsultimit; dhe*
- *financimin publik të OSHC-ve.*

#### Konsultimet e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve).

Qeveria, përmes Zyrës së saj për Qeverisje të Mirë, ofron një platformë online për konsultime me publikun dhe OSHC-të. Shumica e ministrive dhe komunave publikojnë informacione mbi aktet e qeverisë, si projektligje dhe rregullore për shqyrtim publik.<sup>185</sup>

Në konsultimet e vitit 2020, morën pjesë mbi 1000 individë dhe ofruan gjithsej 1898 komente.<sup>186</sup>

Në vitin 2021, konsultimet publike [për aktet e qeverisë] vazhduan të mbahen dhe mbi 98% e

<sup>179</sup> Aleanca e Mediave Publike, Kosovë: Shkarkimi i bordit të transmetuesit publik RTK, 13 korrik, 2021, në: <https://www.publicmediaalliance.org/kosovo-public-broadcaster-rtks-board-sacked/>.

<sup>180</sup> Prishtina Insight, Bordi i Transmetuesit Publik të Kosovës shkarkon drejtorin për neglizhencë, 21 janar, 2022, në: <https://prishtinainsight.com/kosovo-public-broadcaster-board-sacks-director-for-negligence/>.

<sup>181</sup> Exit news, Transmetuesi Publik i Kosovës u vendos për Bordin e Ekspertëve të Palidhur Politikisht, 18 Nëntor 2021, në: <https://exit.al/en/2021/11/18/kosovos-public-broadcaster-set-for-first-ever-politically-unaffiliated-board-of-experts/>.

<sup>182</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 19 tetor 2021.

<sup>183</sup> Instituti Demokratik i Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesëve, dhjetor, 2020.

<sup>184</sup> Këshilli i Evropës, Newsroom PECK III Kosovë\*: Trajnimi i trajnerëve për mbrojtjen e sinjalizuesëve, 26-28 tetor, 2021

<sup>185</sup> Shihni platformën në: <https://konsultimet.rks-gov.net/>.

<sup>186</sup> Zyra për Qeverisje të Mirë, Qeveria e Kosovës, Raporti Vjetor i vitit 2020 për Konsultimet Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, mars, 2021.

të gjitha dokumenteve të politikave kryesore dhe projektligjeve janë publikuar në platformën e konsultimit.

Megjithatë, jo të gjitha ministritë organizojnë konsultime të tilla në përputhje me rregulloret ekzistuese.<sup>187</sup> Në veçanti, Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk ka publikuar asnjë dokument në platformë.<sup>188</sup> **Një lloj progresi**

### Promovimi i platformave të konsultimit

Qytetarëve iu mungon vetëdijesimi rreth ekzistimit të platformës së konsultimit. Prandaj, rekomandohet organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për të inkurajuar qytetarët që të përdorin platformat dhe të marrin pjesë në proceset e konsultimit si në nivelin qendror po ashtu edhe në atë lokal.<sup>189</sup>

Që nga shtatori i viti 2020, ka pasur një përpjekje të shtuar për të rritur ndërgjegjësimin rreth platformës, duke përfshirë edhe mediat sociale. Gjithashtu, ekziston një manual praktik që ofron udhëzime rreth asaj se si mund të përdoret platforma. **Një lloj progresi**

### Financimi publik i OSHC-ve

Raportimi mbi financimin publik për OSHC-të bëhet çdo vit, informacioni është i publik dhe disponueshëm. Megjithatë, ka pasur një rekomandim për plotësimin e të dhënave për autoritetet financuese, organet përfituese dhe shumën e disbursuar me të dhëna për sektorët e financuar dhe buxhetin.<sup>190</sup> Zyra për qeverisje të mirë publikon informacione për autoritetet financuese, organet përfituese dhe shumën e disbursuar dhe ka filluar të plotësojë të dhënat me informacione për disa, por jo të gjitha projektet dhe sektorët e financuar.<sup>191</sup> **Progres shumë i mirë**

**Në vitin 2021 është bërë një lloj progresi sa i përket shoqërisë civile.**

## c) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit për kornizën ligjore në lidhje me median dhe shoqërinë civile përfshijnë:

- *Ligjin* për Komisionin e Pavarur të Mediave;
- *Ligjin* për Radio Televizionin e Kosovës; dhe
- *Ligjin* për Qasje në Dokumente Publike.

### Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave

Në vitin 2021, puna për ndryshimin e Ligjit për Radion dhe Televizionin e Kosovës dhe Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave ka ngecur; që të dy këto tema janë çështje të kahershme.<sup>192</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për Radio Televizionin e Kosovës (RTK)

Me ndryshimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, qeveria do të ndryshojë edhe Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës në mënyrë që t'i harmonizojë ato, siç kërkohet edhe nga BE-ja.<sup>193</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për Qasje në Dokumente Publike

Në vitin 2020, pengesa kryesore për mbrojtjen e të dhënave dhe qasjen në informacionin

<sup>187</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ; 2021.

<sup>188</sup> Zyra për Qeverisje të Mirë, Qeveria e Kosovës, Raporti Vjetor i vitit 2020 për Konsultimet Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Mars 2021

<sup>189</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ; 2021.

<sup>190</sup> Ibid.

<sup>191</sup> Shih Zyrën për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>.

<sup>192</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>193</sup> Ibid.

publik ishte mos caktimi i një Komisioneri për informacionin dhe privatësinë.<sup>194</sup> Pas emërimit të Komisionerit, duhet të nisë zbatimin.<sup>195</sup>

Në vitin 2021, qasja në informacionin publik dhe performanca e institucioneve mbikëqyrëse janë përkeqësuar. Për më tepër, ka pasur thirrje për një vlerësim ex-post të Ligjit për Qasje në Dokumente publike.<sup>196</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Nuk është shënuar progres sa i përket kornizës ligjore në vitin 2021.**

Media dhe Shoqëria Civile	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Liria e medias		✓			
Shoqëria civile			✓		
Korniza ligjore	✓				
<b>Rezultati i përgjithshëm</b>		✓			

Progresi i përgjithshëm - Media dhe Shoqëria Civile

**2. Stabiliteti politik**

Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve mbi stabilitetin politik, janë përdorur nën-indikatorët e mëposhtëm:

- *funksionimi i institucioneve*- ose informacion mbi funksionimin e institucioneve kryesore, siç janë Qeveria dhe Kuvendi;
- *siguria dhe rendi publik*- ose informacione mbi dhunën ndëretnike, aktet e terrorizmit dhe protestat;
- *marrëdhëniet në mes të qeverisë dhe opozitës*- ose informacione nëse transferimi i pushtetit ishte demokratik, prania e opozitës në kuvend dhe mbështetja e opozitës ndaj qeverisë; dhe
- *rendi kushtetues dhe juridik* - ose informacion nëse kushtetuta po zbatohet plotësisht dhe saktë.

Stabiliteti Politik	Funksionimi i institucioneve	Funksionimi i Qeverisë	Funksionimi i Parlamentit	Funksionimi i institucioneve të pavarura	Kënaqshmëria e publikut me punën e Qeverisë	Mbikëqyrja	Zbatimi i ligjeve
	Siguria dhe rendi publik	Mungesa e dhunës dhe terrorizmit	Dhuna ndëretnike	Aktet e terrorizmit	Gatishmëri për t'iu bashkuar protestave për arsye politike		
	Marrëdhëniet mes qeverisë dhe opozitës	Transferimi demokratik i pushtetit	Prania e opozitës në Kuvend	Mbështetja e opozitës ndaj qeverisë			
	Rendi kushtetues dhe juridik	Zbatimi	Shkelja e rendit kushtetues	Shkelje të tjera nga partitë politike			

Stabiliteti politik dhe nën-indikatorët

**a) Funksionimi i institucioneve**

Mjetet e vlerësimit të funksionimit të institucioneve përfshijnë:

- *funksionimin e Qeverisë;*

<sup>194</sup> GLPS, Kosova në vitin 2020; Qasja në dokumentet publike, 26 dhjetor, 2020

<sup>195</sup> Raport i Komisioni Evropian për Kosovën 2021.

<sup>196</sup> OECD, Raport monitories i SIGMA, Kosovë\*, 18 janar, 2022

- funksionimin e Parlamentit ;
- funksionimin e institucioneve të pavarura;
- kënaqshmërinë e publikut me punën e qeverisë;
- mbikëqyrjen; dhe
- zbatimin e ligjeve

### Funksionimi i Qeverisë

Qeveria Kurti I u formua në shkurt të vitit 2020 dhe u shkarkua në mars të vitit 2020, pas një procedure mosbesimi dhe tërheqjes së LDK-së si partnere e koalicionit.<sup>197</sup> Qeveria e Hotit (qershor, 2020) u rrëzua në dhjetor të vitit 2020, me vendim të Gjykatës Kushtetuese.<sup>198</sup> Kjo periudhë u karakterizua nga paqëndrueshmëria politike dhe zgjedhjet parlamentare; zgjedhje këto të tretat me radhë të organizuara në më pak se katër vite. Në këtë kontekst, shumica e aktiviteteve legislative, duke përfshirë edhe përpjekjet për zbatimin e reformave të lidhura me BE-në, ishin të kufizuara.<sup>199</sup>

Qeveria Kurti II, e krijuar pas zgjedhjeve të shkurtit të vitit 2021, ka qenë e qëndrueshme.<sup>200</sup>  
**Progres shumë i mirë**

### Funksionimi i Parlamentit

Qeveria Kurti II fitoi 50.3% të votave, duke fituar 58 ulëse në parlament dhe më vonë duke marrë një tjetër deputet nga grupi parlamentar i PDK-së. Qeveria u votua me 67 vota, si rezultat i mbështetjes nga komuniteti pakicë joserbë, deputetë të përfaqësuar në Parlament.<sup>201</sup> Qeveria ka një shumicë të qëndrueshme në parlament dhe është në gjendje të miratojë ligje që kërkojnë një shumicë të thjeshtë. **Progres shumë i mirë**

### Funksionimi i Institucioneve të Pavarura

Një numër i konsiderueshëm i emërimeve/zgjedhjeve të anëtarëve të bordeve nëpër ndërmarrjet publike në gjysmën e dytë të vitit 2020, kanë qenë të ndikuara politikisht. Gjithashtu, janë vërejtur edhe parregullsi në emërimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve të bordeve. Në raste të tjera, qeveria emëroi/zgjedhi drejtor të bordeve individë që nuk i plotësonin kriteret e përzgjedhjes në mënyrë të pavarur dhe pa konflikt interesi me ç'rast rezultoi se nuk ishin ndjekur kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara me ligj.<sup>202</sup>

Gjatë vitit 2021, ekzistoi një ndikim i padrejtë politik mbi emërimet/shkarkimet e zyrtarëve të lartë publikë dhe shërbyesve civilë.<sup>203</sup> Me qëllim të parandalimit të parregullsi dhe për të vendosur një meritokraci sa i përket pozitave të larta të punësimit në shërbimin civil, ndërmarrjet publike dhe agjencitë e pavarura, Ambasada Britanike ndihmoi duke monitoruar procesin. Përderisa ende është herët për një vlerësim të plotë të performancës së projektit britanik për rekrutimin e bazuar në merita, rekrutimet e para tregojnë për një fillim të dobët. Institucionet e Kosovës nuk kanë përmbushur rekomandimet e partnerit britanik për emërimet.<sup>204</sup>

Rastet e emërimit si anëtarë bordin të individëve të lidhur me qeverinë vazhduan edhe në vitin 2021; LVV zgjedhi një ish-kandidat për zgjedhjet nacionale si anëtar të Bankës Qendrore të Kosovës.<sup>205</sup>

**Nuk është shënuar progres**

<sup>197</sup> Radio Evropa e Lirë, Qeveria Kurti bie, 25 mars 2020, në: <https://www.evropalire.org/a/30508373.html>; dhe Albin Kurti zgjidhet Kryeministër i Kosovës, më 3 shkurt 2020, në: <https://www.evropalire.org/a/30415153.html>.

<sup>198</sup> DW, Kosovë: Gjykata Kushtetuese e shpall jokushtetuese Qeverinë e Hotit, 21 dhjetor 2020, në: <https://www.dw.com/sq/kosovë-kushtetuesja-e-shpall-qeverinë-hoti-antikushtetuese/a-56014545>.

<sup>199</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ; 2021.

<sup>200</sup> Observuesi i sistemeve të partive dhe qeverive, Universiteti i Nottinghamit, Baza e të dhënave e OBSH-së, qeverisë, në Evropë dhe më gjerë, në: [https://whogoverns.eu/cabinets/?view=epoca\\_pais&id=7&codigo=xx](https://whogoverns.eu/cabinets/?view=epoca_pais&id=7&codigo=xx).

<sup>201</sup> DW, Kosovë: zgjidhet qeveria e re me kryeministër Albin Kurti, 22 mars, 2021, në: <https://www.dw.com/sq/kosovë-zgjidhet-qeveria-e-re-me-kryeministër-albin-kurtin/a-56955593>.

<sup>202</sup> Instituti Demokratik i Kosovës, Bordet Politike, qershor, 2021

<sup>203</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ,2021.

<sup>204</sup> Instituti GAP, Rekrutim pa merita në institucionet publike, nëntor 2020.

<sup>205</sup> Kallxo.com, njeriu i Vetëvendosjes emërohet anëtar i bordit të BQK-së, 24 nëntor 2021, në: <https://kallxo.com/gjate/njeriu-i-vetevendosjes-emerohet-anetar-ne-bordin-e-bqk-se/>.

## Kënaqshmëria e publikut me punën e qeverisë

Në maj të viti 2021, *Pulsi Publik* i UNDP-së raportoi për një ngritje të ndjeshme të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e qeverisë (59.1%) në krahasim me dhjetorin e vitit 2020 (21.3%). Në maj të vitit 2021 (59.1%), nivelet e kënaqshmërisë ishin po aq të larta sa ishin në prill të vitit 2020 (60.7%), pra në të dyja qeveritë: Kurti I dhe II.<sup>206</sup> Nivelet e kënaqshmërisë në vitin 2021 u rritën për 177.5%.<sup>207</sup> Raportet gjithashtu vënë në dukje një ngritje të besueshmërisë ndaj qeverisë në prill të vitit 2021, krahasuar me nëntorin e vitit 2020.<sup>208</sup> **Progres shumë i mirë**




Fig 18. Kënaqshmëria e publikut me ekzekutivin

## Mbikëqyrja

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nga Kuvendi është një nga çështjet më sfiduese. Në vitin 2020, parlamenti u kritikua kryesisht për ushtrimin e dobët të rolit të tij mbikëqyrës mbi qeverinë. Komisionet parlamentare, pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në hartimin e ligjeve ndërsa dedikojnë kohën minimale për monitorimin e zbatimit të atyre ligjeve. Në vitin 2020, Kuvendi nuk ka miratuar asnjë raport për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.<sup>209</sup>

E njëjta performancë e dobët e ka karakterizuar edhe punën e Kuvendit gjatë vitit 2021. Bazuar në planet e punës së komisioneve parlamentare [në seancën e parë të punës] vetëm 7 nga 14 komisione kishin përfshirë aktivitete të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Në bazë të planeve të tyre vjetore të prezantuara në seancën pranverore, Parlamenti planifikoi të mbikëqyrë 11 ligje. Megjithatë, vetëm një raport mbikëqyrës ishte miratuar në lidhje me legjislacionin e që kishte të bënte me Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere ndërsa pjesa tjetër e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve ishte planifikuar të bëhej më vonë gjatë vitit. Në përgjithësi, vetëm tre komisione kanë ndjekur planet e tyre dhe kanë kryer aktivitete mbikëqyrëse.<sup>210</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Zbatimi i ligjeve

Ligjet e mëposhtme janë zbatuar dobët ose nuk janë zbatuar fare: Ligji për Zyrtarët Publikë, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligji për Ndërmjetësimin, Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji i Punës, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e kështu me radhë. Megjithatë, nuk ka asnjë raport të ofruar për të krahasuar zbatimin e këtyre ligjeve në vitet 2021 dhe 2020.

Numri i akteve ligjore të planifikuara [nga qeveritë] dhe të miratuara [gjatë mandatit të tyre] në raport me ato të planifikuara ndryshonte shumë, me më pak se 50% të ligjeve të miratuara në çdo periudhë qeveritare/legjislative gjatë viteve 2018-2021. Në fakt, ky hendek është zgjeruar edhe më shumë nga viti 2018.<sup>211</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021, janë bërë disa përparime në funksionimin e institucioneve.**

<sup>206</sup> UNDP, Raport i Pulsit Publik XX, 28 korrik, 2021.

<sup>207</sup> Shënim: Për shkak të ndryshimit të qeverive, shifrat për maj të vitit 2021 krahasohen me shifrat e dhjetorit të vitit 2020, përballë shifrave të prillit të vitit 2020.

<sup>208</sup> Anketa mbi opinionin publik të Kosovës; Institut i Kombëtar Demokratik i Kosovës; prill, 2021.

<sup>209</sup> Shqyrtimi post-legjislativ: Parimet dhe mbikëqyrja ndërkombëtare në Kosovë, shtator, 2020 në: <https://www.kas.de/documents/286052/0/Publication+20-09-30+Post-legislative+scrutiny+International+principles+and+oversight+in+Kosovo+%28Eng%29.pdf/5085c598-6ef2-3959-552a-243cc210b17c?version=1.0&t=1609943885902>.

<sup>210</sup> Instituti Demokratik i Kosovës, Raporti i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për seancën pranverore të vitit 2021, gusht 2021,

<sup>211</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi, Kurti II Pritjet dhe rezultatet utopike, Analiza e punës 100 ditore të Qeverisë së Kosovës, korrik, 2021.

## b) Siguria dhe Rendi Publik

### Mjetet e vlerësimit të sigurisë dhe rendit publik përfshijnë:

- *mungesën e dhunës dhe terrorizmit;*
- *dhunën ndëretnike;*
- *aktet e terrorizmit; dhe*
- *gatishmërinë për t'iu bashkuar protestave për arsye politike*

### Mungesa e dhunës dhe terrorizmit

Në vitin 2020, Kosova u rangua në nivelin 38.208 % të Indikatorit të Sabilitetit Politik dhe mungesës së dhunës/terrorizmit - të Bankës Botërore; 0 që tregon situatën pa rrezik dhe 100 i referohet një rreziku të lartë.<sup>212</sup> Në vitin 2021, Kosova u vendos në nivelin me 44.340%.<sup>213</sup> Kjo paraqet një rritje prej 16% në renditje (e shënuar si arritje pozitive) **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 19. Mungesa e dhunës dhe terrorizmit

### Dhuna ndër-etnike

Në vitin 2020 janë raportuar 11 krime kundër pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe të gjitha janë dërguar në prokurori. Në vitin 2021 janë raportuar 14 raste, 8 prej të cilave janë dërguar në prokurori dhe 6 të tjera gjenden nën hetim.<sup>214</sup> **Progres i mirë**

Viti	2020	2021
Rastet e raportuara	11	14
Rastet e sjellura para drejtësisë	11	8
Raporti (%)	100%	57%

Tabela 34. Numri i krimeve të raportuara kundër komuniteteve pakicë

### Aktet e terrorizmit

Asnjë akt terrorist nuk u raportua në vitet 2020 dhe 2021.<sup>215</sup> **Progres shumë i mirë**

### Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave që ndërlidhen me arsyet politike

Në vitin 2021, një numër më i madh i të anketuarve (36.7%) ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike krahasuar me vitin 2020 (30.6%). Kjo paraqet një rritje prej 20% të gatishmërisë për të protestuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.<sup>216</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

<sup>212</sup> Indikatorët e Bankës Botërore mbi qverisjen, Kosovë, në: <https://info.worldbank.org/governance/wgi/Home/Reports>.

<sup>213</sup> Ibid, <https://info.worldbank.org/governance/wgi/Home/Reports>.

<sup>214</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Policia e Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>215</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, raportet e vendit mbi terrorizmin 2020, në: <https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/kosovo/>.

<sup>216</sup> UNDP, Raport i Pulsit Publik XX, 28 korrik, 2021, në: [https://www.ksundp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic\\_governance/public-pulse-xx.html](https://www.ksundp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xx.html).




Fig 20. Gatishmëria për të protestuar

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi sa i përket sigurisë dhe rendit publik.**

### c) Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe opozitës

**Mjetet e vlerësimit të marrëdhënieve ndërmjet qeverisë dhe opozitës përfshijnë:**

- *transferimin demokratik të pushtetit;*
- *praninë e opozitës në parlament; dhe*
- *mbështetjen e opozitës për qeverinë*

#### Transferimi demokratik i pushtetit

Qeveria Kurti II mori detyrën në shkurt të vitit 2021, me një shumicë të fuqishme dhe të paprecedentë në parlament.<sup>217</sup> Procesi i formimit të qeverisë dhe transferimit të pushtetit ishte paqësor.<sup>218</sup> **Progres shumë i mirë**

#### Prania e opozitës në Kuvend

Vendim-marrja në kuvend ndërmjet viteve 2020 dhe 2021 u ndikua shumë nga një atmosferë e polarizuar politike, mungesa e një shumice efektive qeveritare dhe mungesa e kuorumit.<sup>219</sup> Prandaj, është e nevojshme të rishikohet Rregullorja e Punës së Kuvendit.<sup>220</sup>

Në vitin 2021, opozita bojkotoi ose braktisi seancat për shkak të mosmarrëveshjeve me qeverinë. Ndonëse LVV mund të miratonte shumë ligje pa praninë e opozitës, puna e kuvendit ishte afektuar kur votimet kërkonin një shumicë prej 2/3, siç ishte rasti me marrëveshjet ndërkombëtare.<sup>221</sup> **Nuk është shënuar progres**

#### Marrëdhëniet në mes të Qeverisë dhe Opozitës

Marrëdhëniet në mes të Qeverisë dhe të Opozitës karakterizohen me mosmarrëveshje që kanë rezultuar shpesh me mungesën e partive opozitare në Kuvend. Seancën në të cilën u votua Qeveria Kurti II e bojkotuan deputetët e partive opozitare.<sup>222</sup>

Në vitin 2021 janë raportuar raste si të mbështetjes së ofruar nga ana e opozitës po ashtu edhe mungesës së saj në seanca. I tillë ishte rasti i votimit të dy marrëveshjeve ndërkombëtare në gusht të vitit 2021 dhe mungesa e mbështetjes për dy të tjera.<sup>223</sup> Megjithatë, opozita ka përkrahur Qeverinë e LVV-së në zgjedhjen e Presidentit të Kosovës.<sup>224</sup> **Një lloj progresi**

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi në marrëdhëniet në mes të Qeverisë dhe Opozitës.**

<sup>217</sup> Raporti i Komisionit Evropian mbi Kosovën, 2021, në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en).

<sup>218</sup> NDI, Kosovë: Analiza paszgjedhore e Zgjedhjeve Parlamentare të Shkurtit të vitit 2021, 29 Prill 2021

<sup>219</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021.

<sup>220</sup> Ibid dhe raporti i Grupit për Ballkan, Kuvendi i Kosovës: Rritja e Efektivitetit duke Përmirësuar Rregulloren e Punës, prill, 2020.

<sup>221</sup> Instituti Demokratik i Kosovës, Raporti i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për seancën pranverore të vitit 2021, gusht, 2021.

<sup>222</sup> Koha Ditore, Qeveria Kurti votohet me 67 vota pro, 22 mars, 2021, në: <https://www.koha.net/arberi/263482/konjufca-ia-kerkon-vv-se-emrin-e-mandatarit-per-kryeminister/>.

<sup>223</sup> Agjencia Telegrafike Shqiptare, Kosovë, opozita mbështet vetëm dy marrëveshje ndërkombëtare, 6 gusht, 2021, në: <https://ata.gov.al/2021/08/06/%E2%80%8Bkosove-opozita-perkrah-vetem-dy-marreveshje-nderkombetare/>.

<sup>224</sup> Radio Evropa e Lirë, Vjosa Osmani zgjidhet Presidente e Kosovës më 4 prill, 2021 në: <https://www.evropaelire.org/a/31186200.html>.



## d) Rendi kushtetues dhe juridik

### Mjetet e vlerësimit të rendit kushtetues dhe juridik përfshijnë:

- *zbatimin;*
- *shkeljen e rendit kushtetues; dhe*
- *shkelje të tjera nga partitë politike*

### Zbatimi

Në vitin 2020, disa pjesë të legjislacionit kishin mangësi serioze si mospërputhja me Kushtetutën (Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme - ku disa nga kriteret për certifikimin e kandidatëve ishin në kundërshtim me Kushtetutën, sipas vendimit të Gjykatës së Supreme), ose konflikti i ligjeve (Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme me Ligjin për Barazinë Gjinore lidhur me përfaqësimin e grave në institucionet publike). Për më tepër, ka ndryshime të shpeshta të ligjeve, siç është Ligji për Prokurimin Publik, i cili ndryshoi shtatë herë.<sup>225</sup>

Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2021, theksoi se Kosova duhet të përmirësojë kapacitetin administrativ dhe koordinimin në mënyrë që të arrijë zbatimin efektiv të Acquis të BE-së. Nuk ka progres në zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, ndërsa progres i pamjaftueshëm raportohet në zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligjit për Zyrtarët Publikë, Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. **Progres i kufizuar**

### Shkelja e rendit kushtetues

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2021 konfirmoi se Qeveria e Hotit ishte jolegjitime; pasi që u votua me ndihmën e një deputeti me dënim penal, kjo i hapi rrugën zgjedhjeve të parakohshme legjislative.<sup>226</sup>

Dilemat e mëtejshme u shfaqën nëse lideri i atëhershëm kryesor i opozitës Albin Kurti do të lejohej të kandidonte në zgjedhjet parlamentare duke marrë parasysh një ish-dënim me burgim të kushtëzuar të cilin ai nuk e kreu.<sup>227</sup> Megjithatë, ai u lejua të kandidojë dhe të zgjidhet kryeministër.

### Një lloj progresi

Shkelje të tjera nga partitë politike

Nuk ka asnjë shkelje të rendit juridik nga partitë në vitin 2021. **Progres shumë i mirë**

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi sa i përket rendit kushtetues dhe ligjor.**

Stabiliteti politik	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Funksionimi i institucioneve			✓		
Siguria dhe Rendi Publik			✓		
Marrëdhëniet në mes të qeverisë dhe opozitës			✓		
Rendi kushtetues dhe juridik			✓		
<b>Progresi i përgjithshëm</b>			✓		

Progresi i përgjithshëm mbi Stabilitetin Politik

<sup>225</sup> KAS, Shqyrtimi Post-Legjislativ, Parimet dhe Mbikëqyrja Ndërkombëtare në Kosovë, Shtator 2020.

<sup>226</sup> Gjykata Kushtetuese, Vendimet nga seanca shqyrtuese e mbajtur më 21 dhjetor 2020, në: <https://gjk-ks.org/vendimet-nga-seanca-shqyrtuese-e-mbajtur-me-21-dhjetor-2020/>

<sup>227</sup> Balkan Insight, Kosova cakton datën e zgjedhjeve në mes të kontraverzeve kushtetuese, 7 janar 2021, në: <https://balkaninsight.com/2021/01/07/kosovo-sets-election-date-amid-constitutional-controversies/>.

### 3. Zgjedhjet

Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve zgjedhore, janë përdorur nën-indikatorët e mëposhtëm:

1. *administrimi i zgjedhjeve*- ose informacioni mbi regjistrin e votuesve, numërimin e votave, rezultatet e zgjedhjeve dhe transparencën e KQZ-së;
2. *mjedisi i fushatës*- ose informacioni mbi qasjen e partive politike në media, fushatat politike, mjedisin politik dhe masat COVID-19 gjatë zgjedhjeve;
3. *korniza ligjore*- ose informacioni mbi miratimin, rishikimin ose zbatimin e legjislacionit specifik në lidhje me zgjedhjet; dhe
4. *pjesëmarrja e grave* - ose informacioni mbi përfaqësimin e grave në zgjedhje dhe vizibiliteti i grave kandidatë në fushatat politike.



Zgjedhjet dhe nën-indikatorët

#### a) Administrimi i zgjedhjeve

Mjetet e vlerësimit të administrimit të zgjedhjeve përfshijnë:

- *transparencën e KQZ-së;*
- *regjistrin e votuesve;*
- *ditën e zgjedhjeve;*
- *numërimin e votave; dhe*
- *rezultatet*

#### Transparenca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Asnjë parregullsi madhore nuk u raportua në vitin 2020. Në përgjithësi, zgjedhjet ishin të administruara mirë, konkurruese dhe transparente. Megjithatë, KQZ-ja duhet të përmirësojë strukturën e saj organizative duke caktuar terma të qarta të referencës për anëtarët e stafit të saj dhe duke vendosur një hierarki dhe përgjegjësi të qartë për të shmangur dështimet e kontrollit të cilësisë.<sup>228</sup>

Përbërja e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV) ishte transparente dhe gjithëpërfshirëse [të të gjitha partive dhe komuniteteve pakicë], me përjashtim të grave që ishin të nën-përfaqësuara në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Për më shumë, procesi i gjykimit të ankesave dhe parashtrësive nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe Gjykata Supreme ishin kryesisht transparente dhe i paanshëm.<sup>229</sup>

<sup>228</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ,2020

<sup>229</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ,2021.

Në qershor të vitit 2021, Presidenti shkarkoi Kryetarene KQZ-së për shkak të shkeljes së parimeve të paanshmërisë, pavarësisë dhe integritetit gjatë kryerjes së punës së saj. Partitë opozitare dhe përfaqësuesit e OShC-ve e kritikuan vendimin por nuk morën asnjë masë kundër tij.<sup>230</sup> Nuk ka asnjë tregues që sugjeron se kjo gjë e ka penguar transparencën e KQZ-së. **Progres shumë i mirë**

## Regjistri i votuesve

Saktësia e regjistrit të votuesve është sfiduese në të gjitha zgjedhjet, kryesisht për shkak se një numër i konsiderueshëm i personave të vdekur janë ende pjesë e këtij regjistri. Për më tepër, numri i votuesve të regjistruar është po aq i lartë sa numri i popullsisë në vitin 2019.<sup>231</sup> Janë ndërmarrë një sërë iniciativash për pastrimin e listave. Në mes të viteve 2019 dhe 2021, janë larguar rreth 143,000 votues, që përfaqësojnë 7% të listës së vitit 2019.<sup>232</sup>

Përveç kësaj, votimi i diasporës u raportua si sfidues në zgjedhjet e kaluara. Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, banorët e përhershëm të Kosovës që jetojnë përkohësisht jashtë vendit është dashur të paraqesin një kërkesë me email, drejtuar KQZ-së, për t'u përfshirë në regjistrin e votuesve. Kjo ishte një procedurë e rëndë që në mënyrë të pashmangshme ka shpër në gabime.<sup>233</sup> **Një lloj progresi**

## Dita e zgjedhjeve

Vëzhguesit e BE-së i kanë vlerësuar pozitivisht të dy raundet e zgjedhjeve komunale të vitit 2021, të cilat ishin të qeta dhe të rregullta. Megjithatë, janë vërejtur disa parregullsi në lidhje me votimin e asistuar, përdorimin e letërnjoftimeve të skaduar dhe identifikimin e votuesve. Për më tepër, jo të gjitha qendrat e votimit ishin të qasshme për votuesit me lëvizshmëri të kufizuar.<sup>234</sup> Zgjedhjet e Kuvendit të vitit 2021 ishin përgjithësisht të qeta dhe pa incidente serioze.<sup>235</sup> **Progres shumë i mirë**

## Numërimi i votave

Në vitin 2021, numërimi i votave ishte transparent në të dy raundet [e zgjedhjeve lokale]. Numërimi u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në të gjitha qendrat e vizituara të votimit, por në rreth 1/3 prej tyre kishte disa vështirësi lidhur me koordinimin e fletëvotimeve. Megjithatë, kjo nuk ndikoi në integritetin e procesit.<sup>236</sup> Sa i përket zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, raporti i KE-së për vendin kishte theksuar se ishin të dukshme disa mangësi të konsiderueshme, veçanërisht sa i përket numërimit të votave.<sup>237</sup> **Një lloj progresi**

## Rezultatet

Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, u kërkuan 534 ri-numërime, kryesisht për shkak të mospërputhjeve të protokolleve të rezultateve (sidomos për numrin e votave preferenciale) gjë që ndikuan në vonesën e publikimit dhe certifikimit të rezultateve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, janë kërkuar 630 rinumërime, duke përfshirë një ri-numërim pothuajse të plotë të votave në Mitrovicë dhe Podujevë.<sup>238</sup>

Në zgjedhjet e vitit 2020 u kërkua gjithashtu edhe një ri-numërim. KQZ-së iu deshën 52 ditë për të certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2020 krahasuar me 28 ditë që iu deshën për të certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021. Kjo paraqet një rënie prej 46% të numrit të ditëve që iu deshën KQZ-së për të certifikuar rezultatet.<sup>239</sup> **Një lloj progresi**

<sup>230</sup> Ibid.

<sup>231</sup> Shih: Udhëzuesin Zgjedhor për Kosovën, në at <https://www.electionguide.org/countries/id/253/>.

<sup>232</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>233</sup> Ibid.

<sup>234</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>235</sup> Instituti Demokratik i Kosovës, Monitorimi i Fushatës Zgjedhore të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, 14 shkurt, 2021

<sup>236</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>237</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021.

<sup>238</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>239</sup> Evropa e Lirë, Kur do të shpallen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, 20 shkurt 2021, në: <https://www.evropaclire.org/a/kur-shpallen-rezultatet-perfundimtare-te-zgjedhjeve-/31111923.html>; dhe KQZ-ja, KQZ-ja certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës mbajtura më 14 shkurt; 13 mars, 2021, në: <https://web1.kqz-ks.org/kqz-ja-certifikoi-rezultatet-perfundimtare-te-zgjedhjeve-te-parakohshme-per-kuvendin-e-kosoves-te-14-shkurtit-2021/>.




Fig 21. Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi në administrimin e zgjedhjeve.**

## b) Mjedisi i fushatës

**Mjetet e vlerësimit të mjedisit të fushatës përfshijnë:**

- *fushatat konkurruese;*
- *qasjen në media;*
- *masat kundër COVID-19; dhe*
- *mjedisin politik*

### Fushata konkurruese

Fushata për zgjedhjet lokale të vitit 2021 u zhvillua kryesisht përmes mediave sociale, për shkak të masave kufizuese për COVID-19 dhe burimeve të pakta financiare.<sup>240</sup>

Fushata e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021 ishte e gjallë, e decentralizuar dhe konkurruese, me përjashtim të zonave të banuara me shumicë serbe, ku aktivitetet e fushatës së partive opozitare me Listën Serbe ishin shumë pak të dukshme.<sup>241</sup> **Progres i mirë**

### Qasja në media

E kritikuar për pasqyrimin e njëanshëm të zgjedhjeve të kaluara, në zgjedhjet lokale të vitit 2021, RTK-ja e kreu rolin e saj të shërbimit publik me sukses gjatë të dy rundeve zgjedhore/fushatave. RTK-ja ofroi hapësirë të balancuar dhe neutrale të konkurrentëve në lajmet dhe emisionet e saj, megjithëse u fokusua më shumë në partitë e përfaqësuara në parlament. RTK1 ka kontribuar pozitivisht në informimin e votuesve duke organizuar debate të strukturuar mirë dhe informuese ndërmjet kandidatëve (për kryetar komune dhe kuvend). Kjo paanshmëri ishte më pak e pranishme në faqen e RTK-së, e cila i ofroi më shumë hapësirë PDK-së gjatë raundit të parë dhe LDK-së gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve.<sup>242</sup>

Transmetuesit privatë kryesisht e respektuan ligjin, duke ofruar hapësirë të kufizuar, por mjaft të balancuar të lajmeve. Kanalet televizive nuk mundën të ofronin hapësirë për të gjitha garat zgjedhore lokale, por kontribuan duke organizuar debate zgjedhore dhe intervista me kandidatët për kryetarë komunash.<sup>243</sup>

Në vitin 2021 u raportua gjithashtu mbi praninë e lajmeve të rreme dhe çrregullime të shpërndarjes së informacionit. Përndryshe, gjatë zgjedhjeve, partitë politike dhe kandidatët e tyre kryesisht kanë përdorur mediat sociale, veçanërisht Facebook, për t'i kontaktuar votuesit.<sup>244</sup> **Një lloj progresi**

### Masat për COVID-19

Periudha zyrtare e fushatës për raundin e parë të zgjedhjeve lokale ishte 30 ditë. Për shkak të numrit të lartë të rasteve me COVID-19, disa parti opozitare sugjeruan shkurtrimin e saj në pesë ditë; iniciativë kjo e refuzuar nga partia në pushtet. Fushata u karakterizua nga tubime kryesisht të vogla, të organizuara kryesisht në ambient të hapur, zakonisht me një audiencë të targetuar

<sup>240</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>241</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, 2021.

<sup>242</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>243</sup> Ibid.

<sup>244</sup> Demokracia në Veprim, Raport nga monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Kosovës, 14 shkurt, 2021.

dhe në respekt të kufizimeve sanitare. KKZ-të kishin miratuar 1023 tubime, nga të cilat 28 nuk respektuan masat kundër COVID-19.<sup>245</sup>

Fushata e zgjedhjeve nacionale nuk ishte në përputhje me dispozitat në fuqi sa i përket COVID-19. Partitë politike dhe kandidatët nuk respektuan distancën sociale, nuk mbanin maska në çdo kohë dhe nuk përdornin dezinfektues. Për më tepër, megjithëse Ministria e Shëndetësisë e kufizoi numrin e pjesëmarrësve në 30 persona në tubimet e hapësirave të mbyllura dhe 50 për tubimet në hapësira të hapura, numrat e tillë shpesh tejkaloheshin.<sup>246</sup> **Një lloj progresi**

## Mjedisi politik

Në zgjedhjet e vitit 2021, disa organizata, anëtarë të partive politike dhe aktivistë, raportuan manipulimin e mundshëm të zgjedhjeve nga ana e Listës Srpska. Lista Srpska u përpoq të fitonte më shumë se 10 vendet e garantuara, duke fituar edhe në radhët e komuniteteve të tjera pakicë.<sup>247</sup>

Si rezultat, partitë konkurruese të pakicës apeluan rezultatet e zgjedhjeve në lidhje me disa vende të garantuara për komunitetin Boshnjak dhe Rom. PZAP pjesërisht i pranoi ankesat, duke urdhëruar anulimin e disa votave nga zonat me shumicë serbe. Kjo për shkak të shkeljes së parimit të vendeve të garantuara për përfaqësimin e çdo komuniteti joshumicë. Vendimi, i cili u vërtetua edhe me aktvendimin e Gjykatës Supreme, ku rezultoi me humbjen e dy mandateve, për secilën parti nga një ulëse.<sup>248</sup>

Sa i përket zgjedhjeve lokale të vitit 2021, mund të thuhet se Lista Srpska ka monopolizuar jetën politike në komunat ku serbët e Kosovës janë shumicë, duke kufizuar kështu konkurrencën politike dhe mundësinë e votuesve për të votuar.<sup>249</sup> Për më shumë, PZAP aprovoi ankesat e PDK-së lidhur me menaxhimin e votave në komunën e Dragashit, dhe pas një hetimi i anuloi të gjitha fletëvotimet e diasporës dhe urdhëroi një raund tjetër votimi.<sup>250</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

**Në vitin 2021, është shënuar një lloj progresi sa i përket ambientit të zhvillimit të fushatës.**

## c) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me zgjedhjet përfshijnë:

- *Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme;*
- *Ligjin për Zgjedhjet Lokale;*
- *Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike; dhe*
- *Ndryshimin e rregullores së KQZ-së.*

### Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

Nuk është shënuar progres në lidhje me rishikimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.<sup>251</sup> **Nuk ka progres**

### Ligji për Zgjedhjet Lokale

Rishikimi i Ligjit për Zgjedhjet Lokale nuk ishte paraparë për vitin 2021.<sup>252</sup> **Nuk ka progres**

<sup>245</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>246</sup> Demokracia në Zhvillim, Zgjedhjet në kohën e pandemisë: Menaxhimi kundrejt Pasojave, mars, 2021.

<sup>247</sup> DW, A u devijuan votat e pakicave joserbe në zgjedhjet e 14 shkurtit; 5 mars 2021 në: <https://www.dw.com/sq/a-janë-devijuar-votat-e-pakicave-jo-serbe-në-zgjedhjet-e-14-shkurtit/a-56779375>.

<sup>248</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>249</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti Përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>250</sup> Ibid.

<sup>251</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, janar 2022.

<sup>252</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Media dhe Zhvillimi Rural, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2022.

## Ligji për Financimin e Subjekteve Politike

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka miratuar në parim projektligjin për financimin e subjekteve politike më 26 janar, 2020. Projektligji është dërguar në seancë parlamentare në shkurt të vitit 2020, por deri në fund të vitit 2021 nuk është miratuar.<sup>253</sup> **Një lloj progresi**

### Ndryshimet në rregulloren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Në vitin 2021, rregulloret e KQZ-së nuk u ndryshuan. Plotësimi/ndryshimi i akteve nënligjore - Rregulloret e Zgjedhjeve - janë planifikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, duke marrë parasysh rekomandimet nga BE-ja, Raportin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve për zgjedhjet lokale, Raportin e Vëzhguesve të Zgjedhjeve nga Mbretëria e Bashkuar të vitit 2021, praktikat dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të këtyre rregulloreve në praktikë.<sup>254</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021 nuk është shënuar progres sa i përket kornizës ligjore.**

### d) Pjesëmarrja e grave

Mjetet e vlerësimit të pjesëmarrjes së grave përfshijnë:

- përfaqësimin e grave; dhe
- vizibilitetin e kandidateve gra në fushata.

### Përfaqësimi i grave

Sa i përket zgjedhjeve nacionale, në vitin 2021, nga 1067 kandidatë për zgjedhje, 343 prej tyre ishin gra.<sup>255</sup> Nga të gjitha gratë kandidate, 43 prej tyre u zgjodhën deputete në parlament dhe se kjo përqindje përfaqëson 35% të numrit të përgjithshëm të deputetëve.<sup>256</sup> Kur bëjmë krahasimin me vitin 2019, atëherë kishte 1052 kandidatë për zgjedhje, nga të cilat 359 ishin gra që përfaqësonin 34% të numrit të përgjithshëm.<sup>257</sup> Nga të gjitha kandidatet gra, 39 prej tyre (ose 32.5%) u zgjodhën deputete në Parlament.<sup>258</sup> Këto shifra paraqesin një rritje prej 5.8% të numrit të grave kandidate dhe një rritje prej 7.7% të grave të zgjedhura deputete në Parlament në 2021, krahasuar me vitin 2020. **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2019	2021	Ngritja e numrit të grave kandidate (%)
Gratë kandidate	343	359	
Raporti (%)	32.14%	34%	5.8%
Gratë e zgjedhura deputete në Parlament	39	43	
Raporti (%)	32.5%	35%	7.7%

Tabela 35. Përfaqësimi i grave në zgjedhjet nacionale

Pjesëmarrja e grave në zgjedhjet lokale dhe atyre nacionale konsiderohet e ulët, duke reflektuar realitetin e vrazhdë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, vetëm 14 (nga 166), ose 8% e kandidatëve për kryetarë komunash ishin gra dhe vetëm 2 prej tyre kandiduan në bastionet e partive të tyre politike dhe fituan zgjedhjet. Një numër prej 1937 i grave ose 37% prej tyre kandiduan për Asambleenë Komunale në respektim të kuotës minimale prej 30%, ndërsa vetëm 36 apo 12% e tyre kryesuan listat e tyre partiake. Pavarësisht respektimit të kuotës gjinore, partitë politike të cilat janë kryesisht të dominuara nga burrat, ende nuk e kanë trajtuar pabarazinë gjinore në

<sup>253</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, shkurt 2022; dhe Telegrafi, Dështon miratimi i Projektligjit për financimin e partive politike; 22 shkurt, 2022, në: <https://telegrafi.com/desh-ton-miratimi-projektligjit-per-financimin-e-partive-politike/>.

<sup>254</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prishtinë, shkurt, 2022.

<sup>255</sup> Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian, Kosovë 2019, Raporti Përfundimtar.

<sup>256</sup> NDI, Analiza Paszgjedhore e 14 shkurtit, 2021, Zgjedhjet Parlamentare

<sup>257</sup> Demokracia në Veprim, Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2021.

<sup>258</sup> Evropa e Lirë, shumica e grave deputete siguruan vende në Kuvend pa kuotë, në: <https://www.evropaclire.org/a/grate-sigurojne-uleset-ne-kuvend/30258606.html>.

programet dhe statutet e tyre.<sup>259</sup>

Në zgjedhjet nacionale të vitit 2021, partitë politike respektuan kuotën 30% të Ligjit mbi Zgjedhjet, por jo atë të Ligjit për Barazinë Gjinore (kuotën prej 50%). Si rezultat, shumica e partive përveç Lëvizjes Vetëvendosje, mezi e kaluan kuotën prej 30%.<sup>260</sup> Lëvizja Vetëvendosje dhe PDK-ja kishin përqindjen më të madhe të grave kandidatë (38%), krahasuar me LDK-në (30%).<sup>261</sup> Për më tepër, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.<sup>262</sup>

### Progres shumë i mirë

Viti	2017	2021
Gratë kandidatë për kryetare të komunave	8	14
Raporti (%)	4%	8%
Gratë e zgjedhura si kryetare të komunave	0	2
Raporti (%)	0%	5.3%

Tabela 36. Përfaqësimi i grave në zgjedhjet lokale

### Visibiliteti i grave kandidatë në fushata

Në zgjedhjet nacionale të vitit 2021, transmetuesi publik - RTK ka transmetuar gjithsej 56 emisione/debate televizive. Në këto 56 emisione morën pjesë 98 kandidatë, nga të cilët 79 ishin burra dhe vetëm 19 gra (20%).<sup>263</sup> Në zgjedhjet lokale (2021), mediat ofruan qasje shumë të kufizuar për gratë, me përjashtim të RTV Dukagjini që përfshinte një grua kandidatë nga çdo listë zgjedhore për asambleistët e kuvendeve komunale, duke zbutur disi problemin e nën-përfaqësimit.<sup>264</sup>

Në zgjedhjet nacionale, gratë ishin cak i shpesh të përdorimit të gjuhës së njëanshme ndaj tyre, seksizmit dhe manipulimit. Ato ishin subjekt i sulmeve verbale për pozicionet e tyre politike, zgjedhjet e tyre personale të jetës, dukjen/ paraqitjen dhe gjuhën seksiste.<sup>265</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021, është shënuar një progres i kufizuar në pjesëmarrjen e grave.**

Zgjedhjet	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Administrimi i zgjedhjeve			✓		
Ambienti për fushata			✓		
Korniza ligjore	✓				
Përfaqësimi i grave		✓			
Progresi i përgjithshëm		✓			

Progresi i përgjithshëm për zgjedhjet

## 4. Reformat në Administratën Publike

Nën-indikatorët e përdorur për të matur progresin në administratën publike përfshijnë:

- funksionimin i administratës publike* - nëse emërimi dhe/ose shkarkimi i shërbyesve civilë është i lirë nga ndikimi politik;
- ofrimin e shërbimeve* - nëse shërbimet administrative publike janë përmirësuar në nivel lokal dhe qendror;
- financat publike* - nëse janë përmirësuar transparenca buxhetore, procedurat e prokurimit publik etj.;

<sup>259</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve në Kosovë, 2021, Raporti përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021

<sup>260</sup> Demokracia në Veprim, Raport nga monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Kosovës, 14 shkurt 2021.

<sup>261</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021.


<sup>262</sup> Ibid.

<sup>263</sup> Bashkimi Evropian, Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve në Kosovë 2021, Raporti përfundimtar, 17 tetor -14 nëntor 2021.

<sup>264</sup> Ibid.

<sup>265</sup> NDI, 14 shkurt, 2021 Zgjedhjet Parlamentare të Kosovës, Monitorimi i portaleve të lajmeve online dhe mediave sociale, 29 prill, 2021

- d) *përfaqësimin*- nëse është rritur pjesëmarrja e grupeve vulnerabël, si gratë dhe minoritetet; dhe  
 e) *lornizën ligjore*- nëse ligjet dhe strategjitë janë miratuar dhe/ose janë duke u zbatuar.



Administrata Publike dhe nën-indikatorë

### a) **Funksionimi i Administratës Publike**

Mjetet e vlerësimit të funksionimit të administratës publike përfshijnë:

- *emërimet, shkarkimet dhe rekrutimi i bazuar në merita;*
- *Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil; dhe*
- *Ombudspersonin (Avokatin e Popullit).*

#### **Emërimet, shkarkimet dhe rekrutimet të bazuar në merita**

Në vitin 2019-2020, procesi i emërimeve dhe rekrutimeve të bazuar në merita është shënuar me një transparencë dhe drejtësi jo të mjaftueshme kryesisht për shkak të moszbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë.<sup>266</sup> Për shkak të një situatë të tillë, ka pasur thirrje për transparencë dhe drejtësi në procesin e rekrutimit.<sup>267</sup> Ndikimi politik mbi emërimet/shkarkimet e zyrtarëve të lartë publikë dhe nëpunësve civilë ka qenë sfidues për vite me radhë. Kosova ka përmbushur vetëm disa nga zotimet e saj sa i përket aplikimit të kriterëve të bazuara në merita.<sup>268</sup>

Në vitin 2021 u evidentuan dobësi në zbatimin e ligjit, duke lënë hapësirë për ndërhyrjet politike. Rezultati i vendit sipas indikatorit të SIGMA-së është si vijon: rekrutimi dhe shkarkimi i nëpunësve të lartë civilë të bazuar në merita për vitin 2021 ishte 3/5.<sup>269</sup> Kosova ka të njëjtin rezultat që nga viti 2017.<sup>270</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
<b>Rezultati i SIGMA-s për rekrutimet dhe shkarkimet e bazuara në merita</b>	3/5	3/5

Tabela 37. Rekrutimet dhe shkarkimet e bazuara në merita

<sup>266</sup> OECD, Raporti i Monitorimit nga SIGMA, Parimet e Administratës Publike: Kosovë, nëntor, 2021.

<sup>267</sup> GLPS, Monitorimi Nacional i RAP – Kosovë 2019/2020, qershor, 2021

<sup>268</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ; 2021.

<sup>269</sup> OECD, Raporti i Monitorimit nga SIGMA për Kosovën\*, 18 janar, 2022

<sup>270</sup> OECD, Raporti i Monitorimit të SIGMA për Kosovën\*, 21 nëntor, 2022



## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil

Në qershor të vitit 2021, Kuvendi shkarkoi të pesë anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, pas shqetësimeve për ndikimin e tyre politik dhe emërimet e pa bazuara në merita.

Raporti i KE-së bëri thirrje për emërimin e një bordi të ri, në përputhje me procedurat transparente dhe të bazuara në merita.<sup>271</sup> Njëmbëdhjetë deputetë e dërguan çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata nxori vendimin sipas të cilit shkarkimi ishte në përputhje me paragrafin 2, nenin 101 të Kushtetutës.<sup>272</sup> Bordi i ri nuk u emërua gjatë periudhës raportuese. **Nuk është shënuar progres**

## Ombudspersoni (Avokati i Popullit)

Ombudspersoni/Avokati i Popullit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdojnë të trajtojnë të drejtën e qytetarëve për administrim të mirë, megjithatë zbatimi i rekomandimeve nga institucionet përkatëse mbetet i kufizuar.<sup>273</sup> **Progres shumë i mirë**

**Në vitin 2021 është shënuar një progres i pamjaftueshëm në funksionimin e administratës publike.**

## b) Ofrimi i shërbimit

Mjetet e vlerësimit të ofrimit të shërbimit përfshijnë:

- cilësinë e shërbimeve publike;
- digjitalizimin; dhe
- shërbimet komunale.

## Cilësia e shërbimeve publike (niveli qendror)

Miratimi i Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative, funksionimi i Portalit të Qeverisë dhe krijimi i portalit e-Kosova janë veprime pozitive, por nuk e kanë përmirësuar domosdoshmërisht cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe bizneset. Kënaqshmëria e qytetarëve dhe bizneseve me cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike ka pësuar rënie.<sup>274</sup>

Në vitin 2020, kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet publike ishte 2.9 (në një shkallë matjeje nga 1 në 5) ndërsa kënaqshmëria me shërbimet administrative të ofruara nga niveli qendror ishte 3.0.

Në vitin 2021, kënaqshmëria me shërbimet publike ishte 2.7, ndërsa kënaqshmëria me shërbimet administrative nga qeveria ishte 2.8.<sup>275</sup> Kënaqshmëria me shërbimeve publike ishte ulur për 6.9%. **Nuk është shënuar progres**




Fig 22. Kënaqshmëria e publikut me ofrimin e shërbimeve publike

<sup>271</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën; dhe Gazeta Express, Kuvendi shkarkon pesë anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, 30 qershor, 2021, në <https://www.gazetaexpress.com/kuvendi-shkarkon-pese-anetaret-e-keshillit-te-pavarur-mbikeqyres-per-sherbimin-civil/>.

<sup>272</sup> Gjykata Kushtetuese, Njoftim për vendimin në rastin/ çështjen KO 127/21, në <https://gjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ko-127-21/>.

<sup>273</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën; 2021.

<sup>274</sup> OECD, Raporti i monitorimit të SIGMA-s për Kosovën\*, 18 janar, 2022

<sup>275</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri Ballkanik 2021.

## Digjitalizimi

Në vitin 2021, Kosova kishte një rezultat prej 2.8 (në një matje nga 1 deri në 5) për qasjen e qytetarëve në shërbimet publike përmes kanaleve digjitale (shërbimet online, uebsajt, aplikacion të telefonit të menqur). Pas masave për COVID-19, shumë aktivitete u zhvilluan online duke përfshirë arsimin, bizneset, shërbimet nga komunat dhe bankat, duke shënuar një progres solid krahasuar me vitin paraprak.<sup>276</sup>

Megjithatë, ka mungesë të të dhënave për numrin e përdoruesve të shërbimeve elektronike në Kosovë ndërsa shumica e këtyre të dhënave grumbullohen përmes ueb faqeve të institucioneve. Në përgjithësi, e-Kosova ka rritur numrin e shërbimeve elektronike të ofruara për qytetarët, edhe pse ato mbeten të kufizuara.<sup>277</sup> **Një lloj progresi**

### Shërbimet komunale

Në vitin 2021, performanca e komunave në 19 fusha ishte 56.8%, ndërsa në vitin 2020 performanca ishte 57.06%. Pra, cilësia e shërbimeve komunale ishte 0,46% më e ulët krahasuar me vitin paraprak (2020).<sup>278</sup> **Nuk është shënuar progres**




Fig 23. Performanca e shërbimeve komunale

**Në vitin 2021 nuk është shënuar progres në funksionimin e ofrimit të shërbimeve.**

## c) Financat publike

Mjetet e vlerësimit të financave publike përfshijnë:

- procedurat e prokurimit publik;
- transparencën ndaj buxhetit; dhe
- reformën e menaxhimit të financave publike.

### Procedurat e prokurimit publik

Kosova ka një nivel të përgatitjes sa i përket prokurimit publik. Në vitin 2021, vërehet një progres i shënuar sidomos me rritjen e transparencës së prokurimit publik si rezultat i dy moduleve të reja të prokurimit elektronik (monitorimi i zgjeruar i zbatimit të kontratës, dhe rritja e koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP))<sup>279</sup>

Kosova posedon shifrat 4/5 sa i përket publikimit dhe transparencës në lidhje me procedurat e prokurimit publik, dhe kjo shënon rritje krahasuar me rezultatin e arrirë në vitin 2017 (3/4).<sup>280</sup> **Progres i mirë**

### Transparenca buxhetore

Sipas të dhënave, kushtet kryesore për transparencë buxhetore janë krijuar, me raportim të shpeshtë dhe gjithëpërfshirës vjetor dhe publikim në kohë të pasqyrave financiare vjetore nga ana

<sup>276</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri Ballkanik 2021

<sup>277</sup> Vëzhguesi i Agjencës Dixhitale të Kosovës, Raporti i Vendit dhe Udhërrëfyesi për avancimin e Agjencës Dixhitale në Kosovë, qershor, 2021, në: <https://opendatakosovo.org/wp-content/uploads/2021/12/Kosovo-DAO-2021.pdf>.

<sup>278</sup> Raporti i Performancës së Komunave të Kosovës, në: <https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/>

<sup>279</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ; 2021.

<sup>280</sup> OECD, Raport Monitorues i SIGMA-s, Kosovë\*, 18 janar, 2022

e pushtetit qendror dhe lokal. Megjithatë, pasqyrat/raportet financiare nuk shpjegojnë detaje për projektet e investimeve kapitale dhe nuk përmbajnë informacione jo-financiare të performancës. Përveç kësaj, nuk ka monitorim dhe raportim mbi rreziqet fiskale apo raportim transparent mbi performancën financiare të Ndërmarrjeve Publike.<sup>281</sup>

Ekziston transparencë sa i përket buxhetit dhe zbatimit të tij. Për më tepër, informacioni në Portalin për Transparencën fiskale ofrohet dhe është lehtësisht i qasshëm. Sidoqoftë, një vjedhje që ndodhi duke përdorur sistemin e informacionit të menaxhimit financiar të Thesarit, nxiti një rritje të sigurisë së sistemit. Ministria dhe organet përkatëse kanë ende nevojë të hulumtojnë dhe aplikojnë masa të metutjeshme për përmirësimin e sigurisë të sistemeve të TI-së.<sup>282</sup> **Një lloj progresi**

### Reforma në menaxhimin e financave publike

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike për periudhën kohore 2021-2025 është ende në zhvillim e sipër. Ka pasur kërkesa që strategjia e re të përfshijë prokurimin publik dhe kontrollin e brendshëm financiar publik si dhe të adresojë dobësitë e identifikuara në vlerësimin e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiwe Financiare për vitin 2021. Ky vlerësim tregoi se menaxhimi i financave publike në Kosovë është i mirë, krahasuar si me nivelin ndërkombëtar ashtu edhe me atë rajonal, por i nëjti raportoi gjithashtu edhe për një numër mangësish.<sup>283</sup> Për më shumë, sa i përket MFP-së për periudhën kohore 2016-2020, rezultati i vlerësimit të menaxhimit të financave publike në Kosovë ishte mbi mesataren rajonale (3.3 krahasuar me 3.1 për rajonin).<sup>284</sup> **Një lloj progresi**

**Ne vitin 2021 është shënuar një lloj progresi në menaxhimin e financave publike.**

### d) Përfaqësimi

Mjetet e vlerësimit të përfaqësimit të grupeve të marginalizuara përfshijnë:

- *përfaqësimin e grave; dhe*
- *përfaqësimin e komuniteteve pakicë.*

#### Përfaqësimi i grave

Në vitin 2020, 4692 gra i përkisnin kategorisë profesionale, nga të cilat 615 prej tyre mbanin poste drejtuese (menaxhim i nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë).

Në vitin 2021, 4358 gra i përkisnin kategorisë profesionale, nga të cilat 630 kanë ushtruar pozita menaxheriale.<sup>285</sup> Kjo shifër paraqet një ngritje prej 2.44% të grave që kanë pasur pozita menaxheriale gjatë vitit 2021. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 24. Përfaqësimi i grave

#### Përfaqësimi i komuniteteve pakicë

Në vitin 2020, 1813 anëtarë të komuniteteve pakicë kanë punuar në nivelin qendror dhe në atë lokal. Ndërsa në vitin 2021, 1129 pjesëtarë të komuniteteve pakicë kanë punuar në nivelin qendror dhe në atë lokal.<sup>286</sup> Këto shifra paraqesin një rënie prej 37.7% të përfaqësimit të pakicave në nivel

<sup>281</sup> Ibid.

<sup>282</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën ; 2021.

<sup>283</sup> Ibid.

<sup>284</sup> OECD, Raport Monitorues i SIGMA-s, Kosovë\*, 18 janar, 2022

<sup>285</sup> Të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, nëntor, 2022.

<sup>286</sup> Të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, nëntor 2022.

qendror dhe lokal. **Nuk është shënuar progres**




Fig 25. Përfaqësimi i pakicave

**Në vitin 2021 nuk është shënuar asnjë progres në përfaqësimin e komuniteteve pakicë.**

## e) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kuadrit ligjor në lidhje me administratën publike përfshijnë:

- *Ligjin për Paga;*
- *Ligjin për Zyrtarët Publikë;*
- *Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore; dhe*
- *harmonizimin e ligjeve me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative.*

### Ligji për Paga

Në vitin 2021, Gjykata Kushtetuese anuloi në tërësi Ligjin për Pagat. Kosova ka mbetur pa një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative që rregullon kompensimin në sektorin publik për të parandaluar strukturat e padrejta të pagave, abuzimin me shtesat dhe vendim-marrjen diskrecionale.<sup>287</sup> Pagesat bazohen në një rregullore të vitit 2010, e cila nuk siguron gjithëpërfshirje, transparencë, drejtësi dhe trajtim të barabartë. Për më tepër, pagat nuk janë transparente dhe procedurat e ndarjes së pagave bazë nuk janë në përputhje me parimet e meritokracisë, drejtësisë dhe trajtimit të barabartë.<sup>288</sup>

Hartimi i ligjit të ri për pagat është në fazën fillestare dhe është penguar nga mungesa e të dhënave të besueshme për pagat brenda dhe jashtë shërbimit civil.<sup>289</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

### Ligji për Zyrtarët Publikë (LZP)

Ligji për Zyrtarët Publikë nuk është zbatuar sa duhet.<sup>290</sup> Zbatimi këtij ligji filloi në korrik të vitit 2020 dhe është ende në një fazë të hershme. Numri i vendeve të lira të ofruara në konkurset e jashtme për nëpunës civilë dhe pozita të larta drejtuese para dhe pas hyrjes në fuqi të LZP-së në qershor të vitit 2020, ilustron mungesën e zbatimit të LZP-së. Të njëjtat çështje vazhduan edhe në vitin 2021 duke qenë se nuk ka pasur asnjë rekrutim që nga korriku i vitit 2020.<sup>291</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore

Ligji i ri për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore do të duhej të fuqizonte linjat e llogaridhënies, por zbatimi i tij mungon.<sup>292</sup> Si pasojë, ende mungon qeverisja e orientuar drejt rezultateve e agjencive publike dhe se Kosova posedon numrin më të madh të agjencive ekzekutive në rajon në varësi të parlamentit.<sup>293</sup> **Nuk është shënuar progres**

<sup>287</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021.

<sup>288</sup> OECD, Raporti i monitorimit të SIGMA-s rreth Kosovës\*, 18 januar, 2022

<sup>289</sup> Ibid.

<sup>290</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>291</sup> GLPS, Monitor. Nacional i RAP – Kosovë 2019/2020, qershor, 2021.

<sup>292</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>293</sup> OECD, Raporti i monitorimit të SIGMA-s rreth Kosovës\*, 18 januar, 2022

## Harmonizimi i ligjeve (sektorë të caktuar) me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Raporte të ndryshme kanë kërkuar /rekomanduar harmonizimin e ligjeve sektoriale me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, megjithatë një harmonizim i tillë ka qenë i ngadaltë. Në ndërkohë ka qenë e dukshme mungesa e koordinimit të iniciativave të ndryshme që synojnë thjeshtëzimin dhe reduktimin e barrës administrative.<sup>294</sup> Mungesa e harmonizimit të këtyre ligjeve konsiderohet si e dëmshme sa i përket ofrimit të shërbimeve publike dhe se një mungesë e tillë ka shkaktuar paqartësi ligjore si për qytetarët ashtu edhe për bizneset.<sup>295</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021 nuk është bërë asnjë progres lidhur me Kornizën ligjore.**

Administrata publike	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Funksionimi i administratës publike		✓			
Ofrimi i shërbimit	✓				
Financat publike			✓		
Përfaqësimi	✓				
Korniza ligjore	✓				
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓			

Progresi i përgjithshëm mbi Administratën Publike

<sup>294</sup> Raport i Grupit për Ballkan, Reforma e Administratës Publike në Kosovë: Luftë e vazhdueshme për ta bërë atë; gusht, 2020; dhe OECD, Raporti i Monitorimit të SIGMA-s, Kosovë\*, 18 janar, 2022, and European Commission, Country Report Kosovo 2021, at

<sup>295</sup> Raport i Grupit për Ballkan, Reforma e Administratës Publike në Kosovë: Luftë e vazhdueshme për ta bërë atë; gusht, 2020.



**Dimensioni IV**

---

**EKONOMIA**

## Përmbledhje dhe analizë

Bashkimi Evropian është treg i përbashkët i 27 shteteve anëtare, prandaj rritja dhe zhvillimi ekonomik janë vendimtare për të.<sup>296</sup> Ekonomia i referohet ekzistencës së një ekonomie funksionale të tregut dhe kapacitetit për të përballuar presionet konkurruese dhe fuqitë tregtare brenda unionit.<sup>297</sup> Kriteret ekonomike përfshihen në kuadër të Bllokut II: Kriteret Ekonomike të PKZMSA-s, dhe të njëjtat janë esenciale për përafrimin dhe anëtarësimin në BE.<sup>298</sup>

Përveç kësaj, kriteret ekonomike janë vendosura në Shtyllën II: Konkurrueshmëria, Investimet dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm në kuadër të ARE II (ERA II). Vëmendje e madhe i kushtohet nxitjes së investimeve direkte, përmirësimit të mjedisit të biznesit, përmbushjes së objektivave të efikasitetit të energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme, trajtimit të sfidave prioritare mjedisore, si dhe zbatimit të reformave të prokurimit publik.<sup>299</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve ekonomike, përdoret një indikator:**

### 1. Zhvillimi Ekonomik

**Ky indikator përdor një sërë nën-indikatorësh për të matur progresin në këtë sektor:**


- a) *Stabilitetin makroekonomik*- ose të dhëna mbi rritjen e GDP-së, GDP-së për kokë banori, bilancin tregtar dhe të ardhurat;
- b) *Mjedisin e biznesit*- ose informacion për firmat e sapo regjistruara dhe ato të shuara, madhësia e ekonomisë informale dhe disponueshmëria e statistikave në sektorin e ekonomisë;
- c) *Investimet*- ose të dhënat për IHD-të dhe riorganizimin e KIESA-së;
- d) *Punësimin dhe sigurinë në punë* - ose informata në lidhje me shkallën e punësimit, vdekjet në vendin e punës dhe numrin e punonjësve që kanë sigurim shëndetësor;
- e) *Kapitalin njerëzor*- ose të dhëna mbi migrimin dhe kapitalin njerëzor; dhe
- f) *Kornizën ligjore*- nëse ligjet dhe strategjitë janë miratuar dhe/ose janë duke u zbatuar.

<sup>296</sup> Faqja zyrtare e internetit e Bashkimit Evropian, në: [https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/key-facts-and-figures/economy\\_en](https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/key-facts-and-figures/economy_en).

<sup>297</sup> Komisioni Evropian, Kriteret Ekonomike për anëtarësim në BE, në: [https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-and-fiscal-policy-coordination/international-economic-relations/enlargement-and-neighbouring-countries/enlargement/economic-accession-criteria\\_en](https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-and-fiscal-policy-coordination/international-economic-relations/enlargement-and-neighbouring-countries/enlargement/economic-accession-criteria_en).

<sup>298</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016 .

<sup>299</sup> Axhenda e Reformës Evropiane për Kosovën (ERA) II, 2020.



Zhvillimi ekonomik dhe nën-indikatorët

## a) Stabiliteti makroekonomik

Mjetet e vlerësimit të stabilitetit makroekonomik përfshijnë:

- rritjen e GDP-së;
- GDP-në për kokë banori;
- bilancin tregtar; dhe
- të ardhurat

### Rritja e GDP-së

Në vitin 2021, GDP ishte 7,160 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 3% (6,961 milionë euro) krahasuar me vitin 2020.<sup>300</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2020	2021
<b>GDP</b>	6,961 mil EUR	7,160 mil EUR
<b>Raporti (%)</b>		3%

Tabela 38. Rritja e GDP-së

### GDP për kokë banori

Në vitin 2020, GDP për kokë banori ishte 3,993 USD, ndërsa në vitin 2021 ishte 4,300 USD. Kjo paraqet një rritje prej 8%.<sup>301</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2020	2021
<b>GDP për kokë banori</b>	3,993 USD	4,300 USD
<b>Raporti (%)</b>		8%

Tabela 39. GDP për kokë banori

<sup>300</sup> Ministria e Financave, broshurë informative për qytetarët: Buxheti i Republikës së Kosovës – 2021/i Rishikuar

<sup>301</sup> World Bank/ Banka Botërore, GDP për kokë banori (Kosovë), në: <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?locations=XK>.



## Bilanci tregtar

Në vitin 2020, eksportet ishin 474,883,720,28 Euro, ndërsa importet ishin 3,296,634,863,1 Euro dhe bilanci tregtar ishte -2,821,751,142,82 Euro.

Në vitin 2021, eksportet ishin 749,720,392,43 euro, ndërsa importet ishin 4,652,751,344,00 euro dhe bilanci tregtar ishte -3,903,030,951,57 euro. Kjo paraqet një rritje negative prej 38% të bilancit tregtar në vitin 2021.<sup>302</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
<b>Eksportet</b>	474,883,720.28 EUR	749,720,392.43 EUR
<b>Importet</b>	3,296,634,863.1 EUR	4,652,751,344.00 EUR
<b>Bilanci tregtar</b>	-2,821,751,142.82 EUR	-3,903,030,951.57 EUR
<b>Raporti (%)</b>		-38%

Tabela 40. Bilanci tregtar

## Të ardhurat

Në vitin 2020, të ardhurat totale të qeverisë ishin 2,205,629 euro. Në vitin 2021, të ardhurat e qeverisë ishin 2,645,876 euro, duke përfaqësuar një rritje prej 20% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.<sup>303</sup> **Progres i kufizuar**

Viti	2020	2021
<b>Të ardhurat e Qeverisë</b>	2,205,629 EUR	2,645,876 EUR
<b>Raporti (%)</b>		20%

Tabela 41. Të ardhurat e Qeverisë

**Në vitin 2021 nuk është shënuar asnjë progres sa i përket stabilitetit makroekonomik.**

## b) Mjedisi i biznesit

### Mjetet e vlerësimit të mjedisit të biznesit përfshijnë:

- *hendekun në mes të firmave të reja të regjistruara dhe atyre të mbyllura/shuara;*
- *ekonominë informale; dhe*
- *statistikat*

### Hendeku midis firmave të reja të regjistruara dhe atyre të mbyllura/shuara

Në vitin 2020, numri i firmave të reja të regjistruara ishte 9805 ndërsa ai i firmave të mbyllura ishte 1326. Në vitin 2021, numri i firmave të sapo regjistruara ishte 10649, dhe ai i firmave të mbyllura ishte 1608. Kjo paraqet një rritje prej 15% të firmave të shuara në raport me firmat e reja të regjistruara.<sup>304</sup> **Asnjë progres**

Viti	2020	2021
<b>Firmat e reja të regjistruara</b>	9,805	10,649
<b>Firmat e mbyllura/shuara</b>	1,326	1,608
<b>Raporti (%)</b>		15%

Tabela 42. Firmat e reja të regjistruara dhe ato të mbyllura/shuara

## Ekonomia informale

Në ndërkohë që mungojnë të dhënat mbi numrin e saktë të bizneseve të ekonomisë informale si

<sup>302</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nëntor, 2022.

<sup>303</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Seria 4: Statistikat e Llogarive Kombëtare, Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2015-2020, dhe Zyra e Kryeministrit, mbledhja e 56-të e Qeverisë, 26 janar, 2022,.

<sup>304</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet/ T4 2021.

përqindje e GDP-së, raportet tregojnë se në vitet 2020 dhe 2021, sektori informal ishte afërsisht 30% pa asnjë ndryshim të raportuar.<sup>305</sup> **Asnjë progres**




Fig 26. Sektori informal

## Statistikat

Në vitin 2021, statistikat në lidhje me strukturën e biznesit dhe disa statistika afatshkurtra janë pjesërisht në përputhje me *Acquis* të BE-së. Megjithatë, disponueshmëria e këtyre është e kufizuar dhe shihet se iu mungon një kalkulim i dallimit në mes të investimeve publike dhe private ose të dhënat sipas sektorëve.<sup>306</sup> ASK publikon të dhëna tremujore për disa indikatorë ekonomikë dhe ofron një regjistër të bizneseve.<sup>307</sup> Banka Qendrore e Kosovës publikon edhe të dhëna të ndara në periudha kohore për sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm.<sup>308</sup> Në përgjithësi, publikimi i këtyre të dhënave është përmirësuar me kalimin e viteve. **Progres i pamjaftueshëm**

**Nuk është shënuar progres sa i përket mjedisit të biznesit në vitin 2021.**

## c) Investimet

Mjetet e vlerësimit të investimeve përfshijnë:

- rrjedhën e IHD; dhe
- riorganizimin e KIESA-s.

### Rrjedha e Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

Në vitin 2020, flukset hyrëse të IHD-ve kanë arritur në 345.7 milionë euro, ndërsa në vitin 2021, IHD ishin 421 milionë euro. Kjo paraqet një rritje prej 22% të fluksit hyrës të IHD-ve.<sup>309</sup> **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 27. Rrjedha hyrëse e IHD

## Ri-organizimi i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Ri-organizimi i KIESA-së (përmirësimi i skemave të saj mbështetëse, ofrimi i shërbimeve

<sup>305</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021; dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, Republika e Kosovës, 2020; neni IV: Konsultimet - Komunikatë për shtyp; Raporti i Stafit; dhe deklarata e Drejtorit Ekzekutiv për Republikën e Kosovës, shkurt, 2021, në: <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2021/02/17/Republic-of-Kosovo-2020-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-50104>.

<sup>306</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021

<sup>307</sup> Shihni për më shumë informacion në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/economy/statistical-business-register>.

<sup>308</sup> Banka Qendrore e Kosovës, seri/periudha kohore, në: <https://bqk-kos.org/statistics/time-series/?lang=en>.

<sup>309</sup> Kallxo.com, Investimet e huaja direkte në Kosovë janë rritur në vitin 2021, të udhëhequra nga Gjermania, 1 janar, 2022, në: <https://kallxo.com/lajm/investimet-e-huaja-direkte-ne-kosove-shenojne-rritje-ne-vitin-2021-prin-gjermania/> dhe Ministria e Ekonomisë, Indikatorët makroekonomikë, në: <https://me.rks-gov.net>.

këshillimore për NVM-të dhe shtimi i një njësie të kujdesit të mëtejshëm për investitorët konsiderohet të jetë mjaft nevojshëm. Sipas KIESA-së, një sërë skemash mbështetëse u lansuan në vitin 2021, si grantet për makineri prodhuese/përpunuese, projekti i Bankës Botërore për Konkurrueshmërinë dhe Gatishmërinë për Eksport (që mbështetin NMV-të për asete, standardizim, certifikim, marketing, këshillime e kështu me radhë). Skema këshilluese është pjesë e Projektit CERP të Bankës Botërore, Aktiviteti 4 - Qasje në shërbime dhe trajnime për zhvillimin e biznesit sipas thirrjes publike. Për më tepër, shërbimet e kujdesit të mëtejshëm për investitorët përfshijnë kujdesin e ofruar për investitorët pas kryerjes së investimit, lehtësimin e organizimit të takimeve, pjesëmarrjen në konferenca e takime të B2B-ve dhe informacione të tjera rreth ndryshimeve të reja në ligje, taksa dhe informacione të tjera shtesë.<sup>310</sup>

Për sa i përket ri-organizimit, nuk është raportuar asnjë progres. **Nuk është shënuar progres Në vitin 2021, nuk është shënuar progres sa i përket investimeve.**

#### d) Punësimi dhe siguria në punë

Mjetet e vlerësimit të punësimit dhe sigurisë në punë përfshijnë:

- *sigurimin shëndetësor;*
- *incidentet fatale në vendin e punës; dhe*
- *nivelin e papunësisë*

#### Sigurimi shëndetësor

Kosova në vitin 2020 kishte 92,690 polisa me vlerë 16,720,116 euro, ndërsa në vitin 2021 kishte 165,048 polica me vlerë 21,922,048 euro.<sup>311</sup> Kjo paraqet një rritje prej 31% të vlerës së polisës së sigurimit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.




Fig 28. Poliset e sigurimit

Megjithatë, edhe pse një pjesë e vogël e fuqisë punëtore mbulohet nga sigurimet shëndetësore private, shumica e punëtorëve në Kosovë nuk posedojnë sigurime shëndetësore dhe se nuk ekziston sigurim shëndetësor për punonjësit në rastet e sëmundjeve apo lëndimeve në vendin e punës.<sup>312</sup> Po ashtu, miratimi i Ligjit për Sigurime Shëndetësore është vonuar.<sup>313</sup> **Një lloj progresi**

#### Incidentet fatale në punë

Në vitin 2021, raporti mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë ka bërë të ditur për një sërë problemesh që kanë të bëjnë me të drejtat e punonjësve në vendin e punës në Kosovë duke përfshirë: kapacitetet e pamjaftueshme të inspektorateve të punës, mungesën e statistikave të besueshme për aksidentet dhe sëmundjet në punë, mbikëqyrjen e kufizuar shëndetësore, mungesën e sigurisë sociale në rast të lëndimeve në punë, dialogun e pamjaftueshëm social, mungesën e programeve mbi SSHP dhe hulumtimet e pamjaftueshme në këtë fushë.

Këto mangësi rezultojnë në aksidente të shpeshta të rënda në punë të përcellura me sëmundje që

<sup>310</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga KIESA, Prishtinë, shkurt, 2022..

<sup>311</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Prishtinë, nëntor, 2022.

<sup>312</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të Drejtave Sociale 2021; Ri-shikim për Kosovën\*, 2021, në: <https://www.esap.online/download/docs/ESAP-Social-Rights-Pillar-Report-Kosovo.pdf/f72dc00af90c0fbc60354508ce1c3931.pdf>

<sup>313</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021

fitohen gjatë ushtrimit të profesioneve, veçanërisht në sektorin e ndërtimit.<sup>314</sup> Për më tepër, nuk ekziston asnjë mekanizëm kompensimi për incidentet fatale dhe jo fatale në punë.<sup>315</sup>

Në vitin 2020, kanë ndodhur 11 incidente fatale në punë ndërsa në vitin 2021, numri i incidenteve fatale në punë ishte 9. Kjo paraqet një rënie prej 18% e incidenteve të tilla në vitin 2021.<sup>316</sup> **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 29. Incidentet fatale në punë

### Niveli i papunësisë

Në vitin 2020, niveli i papunësisë ishte 25.9%.<sup>317</sup> Ndërsa, në vitin 2021, kjo shifër ishte 25.8%.<sup>318</sup> Kjo paraqet një ulje prej 0.38% të niveleve të papunësisë në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**




Fig 30. Niveli i papunësisë

**Progres i pamjaftueshëm është shënuar sa i përket punësimit dhe sigurisë në punë.**

### e) Kapitali njerëzor

Mjetet e vlerësimit të kapitalit njerëzor përfshijnë:

- *fluksin e migrimit; dhe*
- *kapitalin njerëzor*

### Fluksi i migrimit

Në vitin 2020, fluksi i migracionit NETO ishte 2819. Imigrimi ishte 11543 dhe emigrimi 8724.<sup>319</sup> Në vitin 2021, fluksi i migracionit NETO ishte -38606. Imigrimi ishte 4122 dhe emigrimi 42728.<sup>320</sup> Në vitin 2021, fluksi i migracionit NETO kaloi përgjatë një tendence negative në krahasim me vitin 2020, duke nënkuptuar se numri i emigrantëve tejkaloi numrin e imigrantëve.

<sup>314</sup> ILO, Profili i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe dialogut social në Kosovë, 28 maj, 2021

<sup>315</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të Drejtave Sociale 2021 rishikimi për Kosovën\*, 2021, në: <https://www.esap.online/download/docs/ESAP-Social-Rights-Pillar-Report-Kosovo.pdf/f72dc00af90c0fbc60354508ce1c3931.pdf>

<sup>316</sup> Inspektorati i Punës, Raport i Punës për vitin 2021, 4 Shkurt, 2022 dhe Raporti i Punës për vitin 2020, 22 mars, 2021

<sup>317</sup> Ministria e Financave, Seria 5: Statistikat sociale, Anketa e fuqisë punëtore TM1 2020 dhe Seria 5: Statistikat sociale, Anketa e fuqisë punëtore TM1 2020.

<sup>318</sup> Ibid.

<sup>319</sup> ASK, Vlerësimi Vjetor i Popullsisë 2020, qershor, 2021, në: <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vleresimi-i-popullsisë-2020.pdf>; dhe raporti i Grupit për Ballkan, Kosova: Trendet e Migracionit kërkojnë një përgjigje të re politike, shtator, 2020; dhe Statistikat mbi migracionin, lejet e qëndrimit, shtetësinë dhe azilin për vendet në zgjerim, botimi I vitit 2020; në: <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/4031688/10361659/KS-03-20-002-EN-N.pdf/26f0dc16-4a08-2707-f8d5-8b1b84794169>; dhe Departamenti i OKB-së për Ekonominë dhe Çështjet Sociale, Dinamika e Popullsisë, në: <https://population.un.org/wpp/>.

<sup>320</sup> Vlerësimi i Popullsisë, 2021 në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/population-assessment-2021>.

Raporte të tjera kanë vënë në pah ndër të tjera edhe rritjen e migrimit të punonjësve të shëndetësisë, kryesisht mjekëve dhe infermierëve.<sup>321</sup> **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021	Trendi
Migrimi Neto	2,819	-38,606	Negativ
Imigrimi	11,543	4,122	
Emigrimi	8,724	42,728	

Tabela 43. Migrimi Neto

### Kapitali Njerëzor

Në vitin 2020, Indeksi i Kapitalit Njerëzor ishte 0.57.<sup>322</sup> Kjo shifër ishte më e ulët në krahasim me mesataren e rajonit, por më e lartë se mesatarja e vendeve me nivel të njëjt të të hyrave.<sup>323</sup> Nuk ka të dhëna të disponueshme për vitin 2021.<sup>324</sup>

Viti	2020	2021
IKN	0.57	/

Tabela 44. Kapitali njerëzor

**Në vitin 2021, nuk është shënuar ndonjë progres sa i përket kapitalit njerëzor.**

### f) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore ligjor në lidhje me ekonominë përfshijnë:

- *Strategjinë për Punësim dhe Politika Sociale;*
- *Ligjin e Punës; dhe*
- *Ligjin për Këshillin Socio-Ekonomik.*

### Strategjia e Punësimit dhe Politikës Sociale

Zbatimi i Strategjisë Sektoriale 2018-2022 është i ulët.<sup>325</sup> Për më tepër, qeveria nuk ka miratuar ndonjë strategji të re sektoriale. **Progres i pamjaftueshëm**

### Ligji i punës

Përkundër rekomandimeve, Ligji i ri i punës nuk u miratua në vitin 2021. Ligji i Punës (Nr. 03/L-212), i miratuar në vitin 2010, është ende në fuqi.<sup>326</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për Këshillin Socio -Ekonomik

Gjatë vitit 2021 nuk u miratua Ligji i ri për Këshillin Socio-Ekonomik i cili ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve, vendim-marrjen dhe performancën e përgjithshme të këtij këshilli. Ligji (Nr. 04/L-008), i miratuar në vitin 2011, është ende i në fuqi.<sup>327</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021, nuk u shënuar asnjë progres sa i përket kornizës ligjore.**

<sup>321</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021 dhe RCC, Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të Drejtave Sociale 2021 Ri-shikimi për Kosovën\*, 2021, në: <https://www.esap.online/download/docs/ESAP-Social-Rights-Pillar-Report-Kosovo.pdf/f72dc00af90c0fbc60354508ce1c3931.pdf>

<sup>322</sup> Banka Botërore, Indeksi i Kapitalit Njerëzor të Kosovës 2020; tetor, 2020, në: [https://databank.worldbank.org/data/download/hci/HCI\\_2pager\\_KXX.pdf](https://databank.worldbank.org/data/download/hci/HCI_2pager_KXX.pdf)

<sup>323</sup> Banka Botërore, Indeksi i Kapitalit Njerëzor të Kosovës më i ulët se mesatarja rajonale, por më i lartë se mesatarja për grupin e saj të ardhurave, thotë Raporti i Bankës Botërore, 16 shtator, 2020, në: <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/09/16/kosovo-human-capital-index-lower-than-regional-average-but-higher-than-the-average-for-its-income-group-says-world-bank-report>

<sup>324</sup> Shih: Banka Botërore, Projekti i Kapitalit Njerëzor, në: <https://www.worldbank.org/en/publication/human-capital>

<sup>325</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021, dhe Raporti i Vlerësimit: Zbatimi i Strategjisë Sektoriale të MPMS-së në vitet 2018 dhe 2019, nëntor, 2022

<sup>326</sup> Ligji i Punës Nr. 03/L-212 në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>327</sup> Ibid.

Zhvillimi ekonomik	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Stabiliteti makroekonomik	✓				
Mjedisi i biznesit	✓				
Investimet	✓				
Punësimi dhe siguria në punë		✓			
Kapitali njerëzor	✓				
Korniza ligjore	✓				
Progresi i përgjithshëm	✓				

Progresi i përgjithshëm rreth ekonomisë



**Dimensioni V**

---

# **ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM**

## Përmbledhje dhe analizë


Zhvillimi i qëndrueshëm është një parim thelbësor i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe një objektive prioritarë për politikën e brendshme dhe të jashtme.<sup>328</sup>

PKZMSA e Qeverisë ka vendosur politikën e zhvillimit të qëndrueshëm, si energjia dhe mjedisi, në kuadër të Bllokut III: Standardet Evropiane - Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me *Acquis* të BE-së.<sup>329</sup> Për më tepër, të dyja fushat e politikave janë vendosur nën Shtyllën II: Konkurrueshmëria, Investimet dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm të ERA II.<sup>330</sup>

Për sa i përket energjisë, fokusi është vendosur në sigurinë e furnizimit me energji, përmirësimin e konkurrencës, promovimin e energjisë së ripërtitshme dhe rritjen e qasjes në tregun e energjisë.<sup>331</sup> Sa i përket mjedisit, theksi vihet kryesisht në cilësinë e ujit dhe të ajrit, menaxhimin e mbeurinave, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rrezikut, kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ), zhurmën dhe pylltarinë.<sup>332</sup>

**Për të matur progresin në Zhvillimin e Qëndrueshëm janë përdorur indikatorët e mëposhtëm:**

1. Energjia
2. Mjedisi



Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe indikatorët

Kosova është e përkushtuar për arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm përmes procesit të integritimit evropian. Vendi ka ndërmarrë disa hapa pozitivë në Agjendën 2030, veçanërisht për krijimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm (KKZHQ) i cili është përgjegjës për koordinimin e veprimit të qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit për periudhën kohore 2016-2021.

### 1. Energjia

Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve mbi energjinë, janë përdorur këta nën-indikatorë:

- a) *Furnizimi me energji* - ose informacion në lidhje me mbështetjen e vendit në thëngjill, sigurinë e furnizimit, humbjet komerciale dhe planifikimin dhe investimet në sektorin e energjisë;
- b) *Efikasiteti i energjisë* - ose informacion në lidhje me zbatimin e fondit të efikasitetit të energjisë, kursimet e energjisë, emetimet e CO2 dhe përmirësimin e termocentraleve;
- c) *Energjia e ripërtitshme* - ose të dhëna për burimet e rinovueshme të energjisë dhe planet për burimet alternative të energjisë; dhe
- d) *Korniza ligjore* - nëse ligjet dhe strategjitë janë miratuar dhe/ose janë duke u zbatuar.

<sup>328</sup> Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Komisioni Evropian, në: [https://ec.europa.eu/info/strategy/international-strategies/sustainable-development-goals\\_en](https://ec.europa.eu/info/strategy/international-strategies/sustainable-development-goals_en).


<sup>329</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.

<sup>330</sup> Agjenda e Reformave Evropiane për Kosovë (ERA) II, 2020.

<sup>331</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.

<sup>332</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.





Energjia dhe nën-indikatorët

### a) Furnizimi me energji

Mjetet e vlerësimit të furnizimit me energji përfshijnë:

- mbështetjen në thëngjill;
- humbjet komerciale;
- sigurinë e furnizimit; dhe
- planifikimin dhe investimet.

#### Mbështetja me thëngjill

Në tremujorin e fundit të vitit 2020 (TM4 2020), vlera e prodhimit të qymyrit ishte 2.37 milionë tonë, ndërsa sasia bruto e energjisë elektrike të prodhuar në termocentralet ishte 1.796, 3 GWh.<sup>333</sup>

Në vitin 2021 (TM4 2021) vlera e prodhimit të thëngjilli ishte rreth 2.35 milionë tonë. Sasia bruto e energjisë elektrike të prodhuar në termocentralet ishte 1,833.05 GWh; 24.4% më pak se në 2020.<sup>334</sup> Kjo paraqet një rritje prej 2% të prodhimit të energjisë elektrike nga thëngjilli. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021	Raporti (%)
Thëngjill (milion tonë)	2,370.7	2,352.8	
Energjia elektrike e prodhuar nga thëngjilli (vlera bruto)	1,796.3	1,833.05	2%

Tabela 45. Prodhimi i energjisë nga thëngjilli

#### Humbjet komerciale

Në vitin 2020, 1,055,257 (20, 27%) ishin humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes. Ndërsa, në vitin 2021, humbjet arritën në 990,280 (20.27%).<sup>335</sup> Në vitin 2020, humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes ishin 12.56%, ndërsa humbjet komerciale përbënin 12.84% të kërkesës për shpërndarje.<sup>336</sup> Në vitin 2021, humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes ishin 12.46% ndërsa humbjet komerciale 12.11%.

**Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Totali i humbjeve	20.27%	20.27%

Tabela 46. Humbjet komerciale

<sup>333</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bilanci i Energjisë në Kosovë, TM4 2020, 12 shkurt, 2021, në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/energy-balance-in-kosovo-q4-2020>.

<sup>334</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bilanci i Energjisë në Kosovë, TM4 2021, 12 nëntor, 2022, në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/energy-balance-in-kosovo-q4-2021>.

<sup>335</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike dhe Termike për Vitin 2021, dhjetor, 2020,; dhe Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike dhe Termike për Vitin 2020, dhjetor 2019.

<sup>336</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti vjetor 2020, mars 2021 dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, Dokumenti punues i Stafit të Komisionit, Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës (2021-2023), 22 prill, 2021.

## Siguria e furnizimit

Në vitin 2020 (tremujori i katërt), Kosova ka importuar 759.0 GWh energji elektrike.<sup>337</sup> Në vitin 2021 (tremujori i katërt), Kosova ka importuar 900.7GWh energji elektrike.<sup>338</sup> Këto shifra paraqesin një rritje prej 18.6% të sasisë së energjisë së importuar në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**




Fig 31. Importet e energjisë

## Planifikimi dhe investimet

Në vitin 2020, 51.6 GWh ishte sasia e energjisë së gjeneruar nga burime alternative (p.sh. hidrocentrale).<sup>339</sup> Në vitin 2021, sasia për të njëjtën ishte 70.6 GWh.<sup>340</sup> Kjo paraqet një rritje prej 36.6% të energjisë së prodhuar nga burime alternative. **Një lloj progresi**




Fig 32. Energjia elektrike e prodhuar nga burime alternative

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres sa i përket furnizimit me energji.**

## b) Efikasiteti i energjisë

Mjetet e vlerësimit të efikasitetit të energjisë përfshijnë:

- *Fondin e Eficiencës së Energjisë;*
- *termocentralet;*
- *efikasitetin e energjisë në ndërtesat e banimit;*
- *projektet e eficiencës së energjisë në komuna;*
- *monitorimin e kursimeve të energjisë; dhe*
- *Statistikat për emetimet e CO2.*

## Fondi i Eficiencës së Energjisë

Kosova u bë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që themeloi një Fond për Eficiencën e Energjisë në vitin 2019 me qëllim të rritjes së eficiencës së energjisë dhe respektimit të reformave thelbësore që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë.<sup>341</sup> Në ndërkohë, ka pasur kërkesa të vazhdueshme lidhur

<sup>337</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bilanci i Energjisë në Kosovë, TM4 2020, 12 shkurt 2021.

<sup>338</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bilanci i Energjisë në Kosovë, TM3 2021, 12 nëntor 2022.

<sup>339</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bilanci i Energjisë në Kosovë, TM4 2020, 12 shkurt, 2021.

<sup>340</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bilanci i Energjisë në Kosovë, TM3 2021, 12 nëntor, 2022.

<sup>341</sup> FKEE, Kosova lançon Fondin për Eficiencë të Energjisë, në: <https://fkee-rks.net/en/kosovo-launches-energy-efficiency-fund/> dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nisja e Fondit për Eficiencë të Energjisë, një nxitje për energji më të pastër, 28 janar, 2019, në: [https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/57253/energy-efficiency-fund-launched-incentive-cleaner-energy\\_en?fbclid=IwAR0hfOF6vWr\\_oMESJiyooocn6hInqAXnB\\_QS109gb9RIP1nPo8w5B6d5Eaw](https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/57253/energy-efficiency-fund-launched-incentive-cleaner-energy_en?fbclid=IwAR0hfOF6vWr_oMESJiyooocn6hInqAXnB_QS109gb9RIP1nPo8w5B6d5Eaw).

me paraqitjen e të dhënave të këtij fondi.<sup>342</sup> Zbatimi i aktiviteteve është duke vazhduar, por ato janë mjaft të kufizuara. Për më tepër, në faqen zyrtare të internetit nuk jepet asnjë informacion përtej vitit 2020.<sup>343</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

### Termocentralet

Sistemi energjetik i Kosovës konsiderohet shumë jo-fleksibil dhe ku 98% e energjisë elektrike prodhohet nga termocentralet e vjetruara dhe shumë ndotëse të linjitet. Kjo ka ndikuar në ndotjen tashmë të madhe të ajrit në Kosovë dhe problemet që lidhen me degradimin e mjedisit dhe çështjet shëndetësore. Në një situatë të tillë, u rekomandua që puna për dekomisionimin e pjesëve të vjetruara të termocentraleve të vazhdojë. Që nga viti 2020 është duke u punuar, si rezultat pritet që nivelet e emetimeve të gazit të vendosen në përputhje me Acquis të BE-së.<sup>344</sup>

Ekziston nevoja për rritjen e investimeve në pajisjet e kontrollit të ndotjes në përputhje me kërkesat dhe standardet e BE-së dhe uljen e orëve të operimit për të reduktuar ndotjen.<sup>345</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Efikasiteti i energjisë në ndërtesat e banimit

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë nuk ka të dhëna për eficiencën e energjisë në ndërtesat e banimit për vitin 2020.

Në vitin 2021, zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në sektorin e amvisërive ka përfshi 962 shtëpi dhe 26 objekte (hyrje) me një vlerë totale prej 12.55 milionë eurove.<sup>346</sup>

### Projektet e eficiencës së energjisë në komuna

Në vitin 2020, projektet e eficiencës energjetike në komuna ishin 3.08 milionë euro, ndërsa në vitin 2021 vlera e projekteve të tilla arriti në 8.79 milionë euro.<sup>347</sup>

Në vitin 2020, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë publikoi një thirrje për aplikime për komunat për të rritur eficiencën e energjisë në ndërtesa si pjesë e Projekteve Komunale të Eficiencës së Energjisë (PKEE).<sup>348</sup> **Progres shumë i mirë**




Fig 33. Projektet e eficiencës së energjisë në komuna

### Monitorimi i kursimeve të energjisë

Ekziston nevoja për krijimin e një Platforme të Monitorimit dhe Verifikimit (PMV) në përputhje me Ligjin për Eficiencën e Energjisë.<sup>349</sup> Trajnimi për përdorimin e PMV-ve iu ofrua zyrtarëve komunal në vitin 2020, por në vitin 2021, nuk u raportua asnjë progres.<sup>350</sup>

<sup>342</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën .

<sup>343</sup> Shihni: Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në: <https://fkee-rks.net/sq/home/>.

<sup>344</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>345</sup> CEE Balkan Watch Network, Mbaje ose mbylle, shtator, 2021, në: <https://www.balkangreenfoundation.org/uploads/files/2021/September/07/Al-PERMBAJU-OSE-MBYLL1631004379.pdf>.

<sup>346</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Prishtinë, nëntor, 2022.

<sup>347</sup> Ibid.

<sup>348</sup> Shih: Thirrjen Publike të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në: [https://fkee-rks.net/file/repository/Thirrja\\_Publike\\_ALB\\_1.pdf](https://fkee-rks.net/file/repository/Thirrja_Publike_ALB_1.pdf).

<sup>349</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Kosovë: Raporti Vjetor i zbatimit, 1 nëntor 2021

<sup>350</sup> Balkan Green Energy News, Trajnim online për Komunat e Kosovës\* mbi PMV, 13 maj, 2020.

Nisur nga kriza energjitike, në vitin 2021, qeveria ka miratuar një sërë masash për kursimin e energjisë, monitorimin dhe verifikimin, duke përfshirë ndalimin e prodhimit të kriptovalutave, ndërprerjet e rregullta të energjisë elektrike në baza ditore, një rritje të çmimeve të energjisë për familjet që konsumojnë mbi 800 KWh, kufizimet e aktivitete komerciale që përdorin energji/caktimin e kushteve të veçanta për aktivitete tregtare dhe kufizimet në tregtimin e energjisë/caktimin e kushteve të veçanta për tregtimin e energjisë.<sup>351</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Statistikat për emetimet e CO2

Banka Botërore publikon rregullisht të dhëna për emetimet e CO2 (tonë metrikë për kokë banori) në mbarë botën, megjithatë, për Kosovën nuk ka të dhëna për vitin 2020 apo vitin 2021. Raportet e tjera ofrojnë të dhëna vetëm për vitet e mëparshme.<sup>352</sup> Në vitin 2020, gazi serrë vjetor ishte 10,266 Gg (Giga gram) CO2 eq, (ekuivalent) ose rreth 10.2 milion ton CO2.<sup>353</sup> Nuk ka të dhëna të publikuara për emetimet e Co2 në vitin 2021.

Është raportuar se mungon legjislacioni që përcakton sistemet kombëtare për politika, masa dhe projeksione, duke e vendosur Kosovën në mospërputhje me Rregulloren (BE) 525/2013. Përpilimi inventarit të Gazrave Serrë është duke shënuar progres. Një ligj për ndryshimet klimatike është planifikuar për në fund të vitit 2022.<sup>354</sup>

**Në vitin 2021, është shënuar një progres i pamjaftueshëm sa i përket efijencës së energjisë.**

## c) Energjia e ripërtërishme

Mjetet e vlerësimit të energjisë së ripërtërishme përfshijnë:

- *investimet;*
- *energjinë nga burimet e ripërtërishme; dhe*
- *energjinë nga burimet alternative*

### Investimet

Sipas Zyrës së Rregullatorit për Energji, nuk ka të dhëna për investime në energji të ripërtërishme.

Në vitin 2021, Kosova ka bërë përparim të pamjaftueshëm duke rritur pjesën e saj të energjisë së ripërtërishme dhe investimet në efikasitetin energjetik të ndërtesave publike.<sup>355</sup> Në vitin 2020, Kosova bëri disa përparime duke rritur investimet në energjinë e ripërtërishme, si rrjedhojë ka arritur objektivat e vitit 2020 sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe duke zhvilluar ndërlidhjen me rrjetet energjetike të rajonit.<sup>356</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

<sup>351</sup> Prishtina Insight, kriza energjetike e Kosovës ndalon prodhimin e kriptomonedhave, 5 janar, 2022, në: <https://prishtinainsight.com/kosovos-energy-crisis-halts-cryptocurrency-production/>, Ministria e Financave në: <https://me.rks-gov.net> dhe Gazeta Blic, Këto janë masat që pritet të zbatohen pas shpalljes së emergjencës energjetike, dhjetor, 2021, në: at <https://gazetablic.com/keto-jane-masat-qe-pritet-te-aplikohen-pas-shpalljes-se-gjendjes-emergjente-te-energji-se-ne-kosove/>.

<sup>352</sup> Qeveria e Kosovës, Ministria e Energjisë dhe Mjedisit, Mjedi i Kosovës- 2020, Raporti i indikatorëve mjedisorë, në: [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedi\\_i\\_Kosovës\\_2020\\_Raport\\_i\\_treguesve\\_mjedisorë\\_-\\_ANGLISHT.pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedi_i_Kosovës_2020_Raport_i_treguesve_mjedisorë_-_ANGLISHT.pdf).

<sup>353</sup> Raporti vjetor për mjedisin i vitit 2020.

<sup>354</sup> Komuniteti i Energjisë, Indikatorët e Zbatimit, në: <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/CLIM.html>.

<sup>355</sup> Raport i Komisionit Evropian për Kosovën, 2022, në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en).

<sup>356</sup> Raport i Komisionit Evropian për Kosovën, 2021\_

## Energjia nga burimet e ripërtëritshme

Në vitin 2020, Kosova ka prodhuar 262.8 GWh energji të ripërtëritshme (hidro, erë dhe diellore). Në vitin 2021, janë prodhuar 305.3 GWh energji të ripërtëritshme.<sup>357</sup> Kjo paraqet një rritje prej 16% të energjisë së ripërtëritshme të prodhuar në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 34. Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme

## Energjia nga burimet alternative të energjisë

Qeveria planifikon të punojë në përmirësimin e menaxhimit të kapaciteteve ekzistuese energjetike, si bazë për një furnizim të qëndrueshëm me energji dhe si një rrugë e sigurt drejt tranzicionit dhe dekarbonizimit të energjisë. Për më tepër, Qeveria kërkon të aplikojë masa mjedisore për përmirësimin e termocentralit Kosova B dhe dekompozimin e aseteve jofunksionale të termocentralit Kosova A. Kohëve të fundit, përmes Fondit për Eficiencën e Energjisë, qeveria synon të aplikojë masa për eficiencën e energjisë në mënyrë që të zgjerojë skemat financiare për të mbështetur financiarisht bizneset dhe familjet.<sup>358</sup> Megjithatë, ende nuk është hartuar Strategjia e re e Energjisë, e cila pritet të hartojë plane të tilla që përfshijnë edhe zhvillimin e burimeve alternative të energjisë. **Progres i mirë**

**Në vitin 2021 është shënuar progres i pamjaftueshëm sa i përket energjisë së ripërtëritshme.**

### d) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me energjinë përfshijnë:

- Përditësimin e Strategjisë së Energjisë;
- Rregullimin e tarifave të energjisë; dhe
- Planin Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës.

## Strategjia e Energjisë

Është krijuar grupi punues për hartimin e një Strategjie të re të Energjisë që mbulon periudhën kohore 2022-2031. Megjithatë, Strategjia nuk është hartuar dhe as miratuar në vitin 2021.<sup>359</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Rregullimi i tarifave të energjisë

Miratimi i një plani për rregullimin gradual të tarifave të energjisë është një nga rekomandimet në raportin e fundit për vendin.<sup>360</sup> Nuk raportohet asnjë progres në vitin 2021, megjithatë, janë marrë masa të ndryshme për të siguruar përdorimin efikas të energjisë elektrike që shpjen në stabilitet dhe qëndrueshmëri. Në veçanti, më 27 tetor 2021, Zyra e Rregullatorit për Energji miratoi të ashtuquajturat tarifa me pakicë të energjisë elektrike, me ku ndër të tjera parashikohen tarifa më

<sup>357</sup> ASK, Bilanci i Energjisë TM4 2021, 14 shkurt, 2022

<sup>358</sup> Qeveria e Kosovës, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, maj, 2021

<sup>359</sup> Balkan Green Energy News, Kosova do të miratojë objektivat e ndarjes së burimeve të rinovueshme për 2031, 2050, 19 nëntor, 2021, në: <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-to-adopt-renewables-share-targets-for-2031-2050/> and at <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-working-group-on-drafting-the-national-energy-strategy-2022-2031-was-presented/>; dhe Zyra e Kryeministrit, Grupi Punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2022-2031 u prezantua, më 18 nëntor, 2021, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-working-group-on-drafting-the-national-energy-strategy-2022-2031-was-presented/>.

<sup>360</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021.

të ulëta të energjisë nëse energjia elektrike përdoret në periudha të caktuara kohore gjatë ditës.<sup>361</sup>  
**Nuk është shënuar progres**

## Plani i integruar Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK)

Nuk është miratuar ndonjë Plan Kombëtar i integruar i Energjisë dhe Klimës (PKEK). Në mungesë të Ligjit për Ndryshimet Klimatike, nuk ka bazë ligjore për PKEK.<sup>362</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021, nuk është shënuar asnjë progres sa i përket kornizës ligjore.**


Energjia	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Furnizimi me energji	✓				
Efikasiteti i energjisë		✓			
Energjia e ripërtëritshme					
Korniza ligjore	✓				
Progresi përgjithshëm	✓				

Progresi i përgjithshëm për Energjinë

## 2. Mjedisi

Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kritereve mjedisore, janë përdorur nën-indikatorët e mëposhtëm:

- Cilësia e ajrit*- ose përmirësimet e cilësisë së ajrit përmes zhvillimit të planeve mbi cilësinë e ajrit, pajtueshmërisë me tavanet e emetimeve, procesit të monitorimit në kohë reale dhe ndalimit të thëngjillit për ngrohje;
- Menaxhimi i ujit dhe i tokës* - ose ofrim i informacioneve në lidhje me nivelin e furnizimit me ujë, ujin e pijshëm, efikasitetin e menaxhimit të burimeve ujore, cilësinë e tokës dhe ndotjen e ujit;
- Menaxhimi i mbeturinave* - ose informacion në lidhje me menaxhimin e deponive ilegale, vendndodhjet e deponive dhe planet e menaxhimit të mbeturinave në nivelin lokal;
- Menaxhimi i pyjeve*- ose të dhëna mbi shpyllëzimin dhe ripyllëzimin;
- Korniza ligjore*- nëse ligjet dhe strategjitë janë miratuar dhe/ose nëse ato janë duke u zbatuar



Mjedisi dhe nën-indikatorët

<sup>361</sup> Tarifat e KESCO-s, 27 tetor, 2021 në: [https://www.kesco-energy.com/Uploads/Data/Docs/2021-Tarifatmepakiceteenergjiaselektrike\\_galbdxN2a.pdf](https://www.kesco-energy.com/Uploads/Data/Docs/2021-Tarifatmepakiceteenergjiaselektrike_galbdxN2a.pdf).

<sup>362</sup> Ibid dhe Komuniteti i Energjisë, Indikatorët e zbatimit, në: <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/CLIM.html>.

## a) Cilësia e ajrit

### Mjetet e vlerësimit të cilësisë së ajrit përfshijnë:

- *planet mbi cilësinë e ajrit;*
- *pajtueshmërinë me tavanin e emetimeve;*
- *ndalimin e thëngjillit për ngrohje; dhe*
- *monitorimin në kohë reale*

### Planet e cilësisë së ajrit

Shumë qytete në Kosovë kanë ajër me cilësi të dobët. Niveli i ndotjes shpesh kërcënon qytetet e mëdha si Pekini, Mumbai dhe Nju Delhi.<sup>363</sup> Prandaj, komunat me nivele të larta të ndotjes së ajrit duhet të përgatisin plane që kanë të bëjnë me cilësinë e ajrit më qëllim të reduktimit të ndotjes.<sup>364</sup>

Një plan i tillë deri më tani është hartuar vetëm në komunën e Drenasit.<sup>365</sup>

Po ashtu, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është në fazën e rishikimit të Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit. Me këtë rast është paraparë të merren disa masa për të zëvendësuar përdorimin e thëngjillit për djegie. Zbatimi i këtyre masave/veprimeve do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit në vend.<sup>366</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

### Pajtueshmëria me tavanin e emetimeve

Kosova vazhdon të mbështetet shumë në thëngjill dhe se një gjë e tillë nuk është në përputhje me kufijtë e emetimeve të përcaktuara sipas Planit të saj Kombëtar për Reduktimin e Emetimeve (PKRE).<sup>367</sup>

Në vitin 2020, të dhënat treguan se Kosova ka tejkaluar kufijtë me tre ndotësit; SO<sub>2</sub>, Pluhur, NO<sub>x</sub>. Ata ishin 4.25 herë mbi tavanin e lejuar - deri në 5,867 ton, një rritje prej 5,042 tonësh të emetuar në vitin 2018. Vetëm Kosova B e ka thyer tavanin kombëtar të pluhurit me 3.85 herë, duke lëshuar gjithsej 5,314 ton pluhur në atmosferë. Njësia B2 emetoi 6.64 herë mbi tavanin e lejuar duke e bërë atë emetuesin më të keq.<sup>368</sup>

Në mars të vitit 2021, Komisioni Evropian filloi një procedurë për adresimin e shkeljeve (rasti ECS-08/21) dhe ftoi Kosovën që të adresojë dështimet e saj në përputhje me kufijtë e saj të emetimeve në PKRE për 2018-2019. Sekretariati arriti në përfundimin se Kosova dështoi të përmbushë një ose më shumë nga tavanet (për dioksidin e squfurit, oksidet e azotit dhe pluhurin) në PKRE. Për më tepër, Kosova dështoi të ofrojë skenarë të emetimeve që do të siguronin pajtueshmëri në vitet e ardhshme. Nuk ka në dispozicion asnjë informacion i mëtejshëm në lidhje me progresin drejt korigjimit të mospërputhshmërisë.<sup>369</sup>

PKRE parashikon që Kosova B1 do t'i nënshtrohet rikonstruksionit, dhe se edhe B2 do të ndjekë një shembull të tillë, në mënyrë që të mund të jetë në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale për nivelet kufitare të emetimeve, por procesi i rinovimit nuk do mund të përfundojë para vitit 2023. **Nuk është shënuar progres**

<sup>363</sup> Open Knowledge Repository , Menaxhimi i ndotjes së ajrit në Kosovë, 2009-20, në: <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/33041>.

<sup>364</sup> Raport i Komisionit Evropian për Kosovën - 2021, në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en).

<sup>365</sup> Komuna e Drenasit, Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit 2020-2024, në: <https://kk.rks-gov.net/gllgoc/wp-content/uploads/sites/10/2020/01/Plani-Lokal-i-Veprimit-per-Cilesi-te-Ajrit-2020-2024.pdf>. dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raporti për përmbushjen e detyrimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar-qershor 2021, në <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/09/Raporti-per-permbushjen-e-obligimeve-te-komunave-nga-Agjenda-Evropiane-Janar-Qershor-2021.pdf>.

<sup>366</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Prishtinë, mar, 2022.

<sup>367</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën - 2021

<sup>368</sup> CEE Balkan Watch Network, Mbaje ose mbylle, shtator, 2021, në: <https://www.balkangreenfoundation.org/uploads/files/2021/September/07/AI-PERMBAJU-OSE-MBYLLE1631004379.pdf>.

<sup>369</sup> Ibid.

## Ndalimi i thëngjillit për ngrohje

Kosova mbështetet shumë në përdorimin e thëngjillit për ngrohje. Vetëm katër komuna kanë sisteme të ngrohjes qendrore, dhe ato kryesisht mbështeten në thëngjill (94%) dhe naftë (6%).<sup>370</sup> Masat e vendosura; të cilat nevojiten për të zbatuar ndalimin e përdorimit të thëngjillit për ngrohje, janë të pamjaftueshme dhe jo efektive.<sup>371</sup> Për më tepër, Kosova nuk e ka vlerësuar potencialin e saj për bashkëgjenerim me efikasitet të lartë dhe ngrohje e ftohje qendrore efikase, siç kërkohet nga Direktiva për Eficiencën e Energjisë.<sup>372</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Monitorimi në kohë reale

Monitorimi në kohë reale i cilësisë së ajrit është efektiv dhe mund të shihet në portalin e cilësisë së ajrit.<sup>373</sup> **Progres shumë i mirë**

**Në vitin 2021, është shënuar progres i pamjaftueshëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit.**

## b) Menaxhimi i ujit dhe tokës

Mjetet e vlerësimit të menaxhimit të ujit dhe tokës përfshijnë:

- Furnizimin me ujë;
- Menaxhimin e burimeve ujore;
- Ujin e pijshëm;
- Ndotjen e ujit; dhe
- Cilësinë e tokës.

### Furnizimi me ujë

Në vitin 2020, furnizimi i familjeve me ujë të pijshëm ishte 50.7 milionë m<sup>3</sup>/vit. Në vitin 2021, furnizimi ishte 53.13 milionë m<sup>3</sup>/vit.<sup>374</sup> Kjo paraqet një rritje prej 5%. **Progres i pamjaftueshëm**

Viti	2020	2021
Furnizim me ujë	50.7 mil m <sup>3</sup> / vit	53.13 mil m <sup>3</sup> / vit
Raporti (%)		5%

Tabela 47. Water supply

### Menaxhimi i burimeve ujore

Monitorimi i sasisë së ujit bëhet nëpërmjet rrjetit hidrometrik, i cili përbëhet nga një sërë stacionesh matëse përgjatë lumenjve. Në vitin 2021, trendi i nivelit mesatar vjetor të ujit ishte 1926 (cm) që krahasuar me vitin 2020 (kur niveli i ujit ishte 2143 cm) tregon një trend negativ.<sup>375</sup> Këto shifra paraqesin një rënie prej 10.1% të sasisë së ujit në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**




Fig 35. Menaxhimi i burimeve ujore

<sup>370</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Kosovë: Raporti Vjetor i Implementimit, 1 nëntor, 2021.

<sup>371</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën - 2021,

<sup>372</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Kosovë: Raporti Vjetor i Implementimit, 1 nëntor, 2021.

<sup>373</sup> IQ Air, Cilësia e ajrit në Kosovë, në: <https://www.iqair.com/kosovo>.

<sup>374</sup> ASK, Statistikat e Ujit në Kosovë 2020-2021, 18 mars, 2022=

<sup>375</sup> Ibid



## Ujë i pijshëm

Në vitin 2020, rreth 96.84% e popullsisë në Kosovë kishte qasje në ujë të pijshëm përmes sistemeve publike, ndërsa 3.16% e tyre nuk kishin qasje.<sup>376</sup>

Në vitin 2021, rreth 96.88% e popullsisë në Kosovë furnizohej me ujë përmes sistemit publik, ndërsa 3.12% e popullsisë nuk kishte qasje në ujë të pijshëm<sup>377</sup> **Asnjë progres**

Viti	2020	2021
Qasja në ujë të pijshëm (% e popullatës)	96.84	96.88%
Nuk ka qasje në ujë të pijshëm (% e popullatës)	3.16	3.12

Tabela 48. Qasja në ujë të pijshëm

## Ndotja e ujit

Me rritjen e nivelit të ndotjes në Kosovë, cilësia e ujit ka pësuar rënie.<sup>378</sup> Problemi i ndotjes gjithandejpo mbyl lumenjtë e Kosovës dhe po ndotë ujin e pijshëm. Qeveritë e njëpasnjëshme kanë bërë pak për të ndaluar këtë fenomen.<sup>379</sup> Ekziston nevoja për ngritjen e një sistemi efektiv të monitorimit të ujit, publikimin e të dhënave dhe ndërmarrjen e masave të përhershme për uljen e ndotjes së ajrit dhe ujit.<sup>380</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Cilësia e tokës

Monitorimi i tokave, për sa i përket aspekteve mjedisore të ndotjes, është në përgjegjësinë e Institutit Hidrometeorologjik. Në vitet 2020 dhe 2021, Kosova nuk kishte asnjë program apo monitorim të rregullt të cilësisë së tokës. Ky aktivitet realizohet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike.<sup>381</sup> Progresi në konsolidimin dhe mbrojtjen e tokës është i pamjaftueshëm.<sup>382</sup>

### Progres i pamjaftueshëm

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres në menaxhimin e ujit dhe të tokës.**

## c) Menaxhimi i mbeturinave

### Mjetet e vlerësimit të menaxhimit të mbetjeve përfshijnë:

- planet e integruara të menaxhimit të mbeturinave komunale;
- vendgrumbullimet ilegale; dhe
- vendosjen e lokacioneve të reja për deponitë.

### Planet e integruara komunale për menaxhimin e mbeturinave (PKMM)

Një lloj progresi u raportua në vitin 2021, me miratimin e planeve moderne të menaxhimit të integruar të mbeturinave komunale në disa komuna.<sup>383</sup> Në fakt, 26 komuna kanë hartuar PKMM-të për komunat e tyre përkatëse ndërsa 11 nuk e kanë bërë një gjë të tillë.<sup>384</sup> **Një lloj progresi**

Viti	2021	Raporti (%)
PKMM-të e miratuara (komunat)	26	70.3%
PKMM-të jo të miratuara (komunat)	11	29.7%
<b>Totali</b>	<b>37</b>	<b>100%</b>

Tabela 49. Planet komunale të menaxhimit të mbeturinave

<sup>376</sup> ASK, Statistikat e Ujit në Kosovë 2020-2021, 18 Mars 2022=

<sup>377</sup> Statistikat e Ujit në Kosovë 2020-2021=.

<sup>378</sup> Projekti Borgen, Cilësia e ujit në Kosovë, një shqetësim ndërkombëtar, korrik, 2017, në: <https://borgenproject.org/water-quality-in-kosovo-concern/>.

<sup>379</sup> Balkan Insight, Ndotja e përhapur po mbyl lumenjtë e Kosovës dhe po ndotë ujin e pijshëm. Qeveritë e njëpasnjëshme kanë bërë pak për ta ndaluar atë, më 20 korrik, 2020

<sup>380</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021

<sup>381</sup> Raporti vjetor i mjedisit për vitin 2020; në: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Shqip%20WEB.pdf>.

<sup>382</sup> Ibid.

<sup>383</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021

<sup>384</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport për përbushjen e detyrimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-

## Deponitë ilegale

Nga 1489 në vitin 2020, numri i deponive ilegale shënoi rënie me 1189 në vitin 2021.<sup>385</sup> Kjo paraqet një rënie prej 20%. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 36. Deponitë ilegale

## Vendosja e lokacioneve të reja për deponitë

Gjatë viteve 2020 dhe 2021 nuk u ndërtua ndonjë deponi e re për grumbullimin e mbeturinave.<sup>386</sup>

**Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021 u shënuar progres pamjaftueshëm sa i përket menaxhimit të mbeturinave.**

## d) Menaxhimi i pyjeve

Mjetet e vlerësimit të menaxhimit të pyjeve përfshijnë:

- shpyllëzimin
- masat kundër shpyllëzimit; dhe
- ripyllëzimin

## Shpyllëzimi

Shpyllëzimi në Kosovë është i ndaluar me ligj. Megjithatë, veprime të kundërligjshme, si p.sh. prerjet ilegale të pyjeve ndodhin. Aktivitetet e tilla paraqesin shqetësim të madh, duke ditur rolin e pyjeve në jetën e njeriut, përfshirë ndikimin në sigurimin e ujit të pijshëm, ajrit të pastër, sekuestrimin e karbonit dhe luftimin e efekteve të ndryshimeve klimatike globale.<sup>387</sup>

Në vitin 2020, Kosova humbi 971 ha (0.26%) sipërfaqe të mbuluara me drunjë /pemë, ndërsa në vitin 2021 humbi 520 ha (0.14%) sipërfaqe të tillë.<sup>388</sup> Kjo paraqet një rënie prej 46% të humbjes së sipërfaqeve me drunjë /pemë. **Një lloj progresi**




Fig 37. Sipërfaqja e mbuluar me drunjë/pemë

## Masat kundër shpyllëzimit

Meqenëse shpyllëzimi është i ndaluar me ligj, nuk ka plane në asnjë dokument strategjik që e ndalon këtë fenomen.<sup>389</sup> **Nuk është shënuar progres**

Qershor 2021, 2021.

<sup>385</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021

<sup>386</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit, Prishtinë, Nëntor 2022;

<sup>387</sup> Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet në Kosovë, neni 3, pika 3.7 në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>; Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, Prishtinë, Nëntor 2022.

<sup>388</sup> Global Forest Watch, Kosovë, në: <https://bit.ly/3XoEYgn>.

<sup>389</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, Prishtinë, nëntor 2022.

## Ripyllëzimi

Në vitin 2020 janë pyllëzuar 235 hektarë, ndërsa në vitin 2021, janë pyllëzuar 309.30 hektarë.<sup>390</sup> Këto shifra tregojnë për një rritje prej 31.6% të ripyllëzimit në vitin 2021. **Një lloj progres**

**Në vitin 2021 është shënuar një progres i kufizuar në menaxhimin e pyjeve.**




Fig 38. Ripyllëzimi

## e) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore në lidhje me mjedisin përfshijnë:

- Zbatimin e Strategjisë për Ndryshimet Klimatike;
- Planin e Veprimit për Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike;
- Harmonizimin i Ligjit për Mbeturina; dhe
- Ligjin për Pyjet

### Strategjia përe Ndryshime Klimatike

Strategjia për Ndryshime Klimatike për periudhën 2019-2028 është ende në një fazë të hershme. Për më tepër, korniza strategjike legjislativë nuk është përshtatur me qëllimet strategjike të BE-së që rrjedhin nga Marrëveshja e Gjellbër Evropiane.<sup>391</sup> Zbatimi i Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike është i pjesshëm. Shkak i vonësave është COVID-19, por edhe mungesa e fondeve për projekte që kanë kosto të lartë financimi.<sup>392</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Plani i veprimit për Strategjinë përe Ndryshimeve Klimatike

Plani i Veprimit i Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike për periudhën 2021-2023 nuk është hartuar ende.<sup>393</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Harmonizimi i Ligi për Mbeturinat

Ligji për Mbeturina duhet të harmonizohet më tej me Direktivën Kornizë për Mbeturina.<sup>394</sup> Nuk raportohet asnjë progres për vitin 2021 në këtë fushë. **Nuk është shënuar progres**

### Ligji për Pyjet

Në vitin 2021 nuk është miratuar Strategjia për Pyjet dhe gjithashtu nuk është miratuar Ligji për Pyjet.<sup>395</sup> **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres sa i përket kornizës ligjore.**

<sup>390</sup> Raporti i Gjellbër, dhe intervista e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, Prishtinë, nëntor, 2022.

<sup>391</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>392</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Prishtinë, mars, 2022.

<sup>393</sup> Ibid.

<sup>394</sup> Ibid.

<sup>395</sup> Ibid dhe Shih: Kuvendi i Kosovës, në: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet-dhe-ligjet/>.

Mjedisi	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Cilësia e ajrit		✓			
Menaxhimi i ujit dhe i tokës	✓				
Menaxhimi i mbeturinave		✓			
Menaxhimi i pyjeve		✓			
Korniza Ligjore	✓				
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓				

Progresi i përgjithshëm për Mjedisin



**Dimensioni VI**

---

**EDUKIMI**

## Përmbledhje dhe analizë

BE-ja është e përkushtuar në zhvillimin e arsimit cilësor sipas nenit 165 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së (TFBE).

Arsimi fokusohet në përmbushjen e kërkesave kryesore në lidhje me përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, reformimin e arsimit profesional dhe zhvillimin e trajnimeve dhe politikave që sigurojnë punësim më të lartë, përvetësimin e aftësive dhe përfshirje më të lartë sociale.<sup>396</sup> Kriteret e arsimit janë vendosur në Bllokun III: Standardet Evropiane - Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis të BE-së në PKZMSA.

Përveç kësaj, arsimi është gjithashtu i vendosur nën Shtyllën III: Punësimi, Arsimi dhe Shëndetësia në ERA II. Ai fokusohet në përmirësimin e cilësisë së sektorit të arsimit, sigurimin e transparencës, qeverisjen e sistemit arsimor dhe rritjen e qasjes në arsim.<sup>397</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve të arsimit, përdoret një indikator:**

### 1. Ofrimi i qasjes në arsim

**Ky indikator përdor nën-indikatorët e mëposhtëm për të matur progresin në këtë sektor:**

- Shpenzimet për arsim* ose informacion mbi shpenzimet në arsimin publik dhe privat, shpenzimet për studentë, shpenzimet për kërkim shkencor dhe infrastrukturë;
- Qasjen në arsim* ose të dhëna për regjistrimin e studentëve, shkallën e diplomimit, braktisjen shkolle nga ana e vajzave dhe nxënësve të komunitetit RAE dhe numrin e institucioneve parashkollore;
- Qeverisjen dhe cilësinë e arsimit* - ose përmirësimet në tekste dhe planprograme shkollore, procesi i emërimit të drejtorëve të shkollave dhe anëtarësimi në AKA-së në ENQA;
- Përafrimin me tregun e punës* - ose informacioni mbi përshtatjen e kurikulave të arsimit profesional dhe programet e trajnimit me tregun e punës.



Arsimi dhe nën-indikatorët

Disponueshmëria e të dhënave mbetet një pengesë për vlerësimin e progresit kur bëhet fjalë për arsimin. Kosovës i mungojnë të dhënat për shumicën e indikatorëve social. Edhe pse MASHTI regjistron numrin e nxënësve/studentëve, mungesa e të dhënave të klasifikuara sipas grupmoshave dhe grupeve vulnerabël, krijon vështirësi në ndarjen e qartë të përqindjeve të pjesëmarrjes në arsim.<sup>398</sup>

<sup>396</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA).

<sup>397</sup> Agjenda e Reformës Evropiane për Kosovën (ERA) II, 2020.

<sup>398</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale 2021- Rishikimi për Kosovën\*, 2021

## a) Shpenzimet në arsim

Mjetet e vlerësimit të shpenzimeve në arsim përfshijnë:

- shpenzimet publike dhe private për arsimin;
- shpenzimet për nxënës/studentë;
- shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- shpenzimet për kërkime/hulumtime; dhe
- shpenzimet për infrastrukturë dhe investime

### Shpenzimet publike dhe private në arsim

Në vitin 2020, qeveria ndau 52,420.95 euro për arsim gjë që ishte 3,5% e totalit të buxhetit prej 1,511,112.70 euro.<sup>399</sup>

Në vitin 2021, Qeveria e Kosovës ka ndarë 65,116.45 euro për arsimin, që përbën 3,43% të totalit të buxhetit të përgjithshëm prej 1,869,000.00 euro.<sup>400</sup> Këto shifra nuk paraqesin ndryshim të theksuar sa i përket shpenzimeve në arsim. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Shpenzimet në arsim	52,420.95 EUR	65,116.45 EUR
Totali i buxhetit	1,511,112.70 EUR	1,869,000.00 EUR
Shpenzimet në arsim (%)	3.46%	3.48%

Tabela 50. Shpenzimet në arsim

### Shpenzimet për nxënës

Në vitin 2020, shpenzimet publike për nxënës në sistemin arsimor parauniversitar ishin rreth 781 euro.<sup>401</sup> Nuk ka të dhëna nga MASHTI për vitin 2021.

### Shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara

Në vitin 2020, shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara ishin 1,524,047.67 euro, ndërsa në vitin 2021, shpenzimet për të njëjtit ishin 1,707,150.46 euro.<sup>402</sup> Këto shifra shënojnë një rritje prej 12% të shpenzimeve në vitin 2021. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 39. Shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara

### Shpenzimet në kërkime/hulumtime

Sipas Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK), shpenzimet për kërkime/hulumtime kanë qenë të njëjta çdo vit që nga viti 2017.<sup>403</sup> **Nuk është shënuar progres**

<sup>399</sup> Ministria e Financave, Qarkorja Buxhetore 2020/01

<sup>400</sup> Ministria e Financave, Broshura informative për qytetarët: Buxheti i Republikës së Kosovës – 2021/ i Rishikuar.

<sup>401</sup> Organizata për ngritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), Transparencës dhe Përgjegjshmërisë në Universitetet Publike të Kosovës, në: <http://orca-ks.org/ep-content/uploads/2020/10/Finance-management-2.pdf>.

<sup>402</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Prishtinë, nëntor, 2022.

<sup>403</sup> MASHTI, Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK),.

## Shpenzimet për infrastrukturë dhe investime

Në vitin 2020, shpenzimet për infrastrukturë dhe investime si salla të gjimnastikës, pajisje laboratorike, pajisje materiale të ndryshme dhe renovime ishin 2,064,480.00 euro, ndërsa në vitin 2021 shpenzimet për projekte të njëjta arritën në 2,275,376.10 euro.<sup>404</sup> Këto shifra paraqesin një rritje prej 10.2%. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 40. Shpenzimet në infrastrukturë dhe investime

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres sa i përket shpenzimeve në arsim.**

## b) Qasja në Arsim

Mjetet e vlerësimit të qasjes në arsim përfshijnë:

- regjistrimin e nxënësve / studentëve;
- shkallën e diplomimit;
- fëmijët me nevoja të veçanta;
- shkallën e braktisjes së shkollës nga komuniteti RAE;
- shkallën e braktisjes së shkollës nga vajzat; dhe
- institucionet parashkollore.

### Regjistrimi i nxënësve / studentëve

Në vitin akademik 2019/20, në arsimin e lartë janë regjistruar 73.517 (ose 8.7%) nxënës, ndërsa në të gjitha nivelet arsimore janë regjistruar 849.386 nxënës.<sup>405</sup>

Në vitin akademik 2020/21, në arsimin e lartë janë regjistruar 95.335 (11%) studentë, ndërsa në të gjitha nivelet arsimore janë regjistruar 861.622 nxënës.<sup>406</sup>

Këto shifra paraqesin një rritje prej 26, 4% të numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin e lartë në vitin 2021. **Një lloj progresi**

Viti	2019/20	2020/21
Regjistrimi i nxënësve në arsimin e lartë	73,517	95,335
Totali i numrit të nxënësve	849,386	861,622
Rritja e numrit të nxënësve të regjistruar (%)	8.7%	11%
Raporti (%)		26.4%

Tabela 51. Regjistrimi i studentëve në arsimin e lartë

### Shkalla e diplomimit

Në vitin akademik 2019/2020 janë diplomuar (niveli BA) 5997 studentë.<sup>407</sup> Ndërsa në vitin akademik 2020/2021 pati 6193 të diplomuar.<sup>408</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

<sup>404</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrëtar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Prishtinë, nëntor, 2022.

<sup>405</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020, qershor, 2020

<sup>406</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021, qershor, 2021

<sup>407</sup> ASK, Statistikat rreth Arsimit në Kosovë 2020/2021, qershor 2021

<sup>408</sup> ASK, Statistikat rreth Arsimit në Kosovë 2020/2021, qershor 2021



Viti	2019/20	2020/21
Studentë të diplomuar (diplomë bachelor)	5,997	6,193
Totali i numrit të studentëve	849,386	861,622
Ngritja e numrit të studentëve të diplomuar (%)	0.70%	0.71%
Raporti (%)		1.4%

Tabela 52. Shkalla e diplomimit

### Fëmijët me nevoja të veçanta

Në vitin 2021, kishte 55 ndihmës mësues dhe 86 asistentë.<sup>409</sup> Asnjë e dhënë nuk është ofruar nga MASHTI për vitin 2020.

### Shkalla e braktisjes së shkollimit nga komuniteti RAE

Në vitin 2020, 63 nxënës të komunitetit RAE e kanë braktisur shkollën (klasat 1-9), nga të cilët 36 ishin djem dhe 27 vajza. Për më tepër, 4 nxënës të klasave 10-12 e braktisën shkollën në vitin 2020.

Në vitin 2021, 51 nxënës nga komuniteti RAE kanë braktisur shkollën (klasat 1-9), prej të cilëve 28 ishin djem dhe 23 vajza. Gjithashtu, 2 nxënës të klasave 10-12 e braktisën shkollën në vitin 2021.<sup>410</sup> Shkalla e braktisjes së shkollës në mesin e komunitetit RAE është ulur me një mesatare prej 38% në vitin 2021. **Një lloj progresi**

Viti	2020	2021	Raporti (%)
Klasat 1-9	63	51	-19%
Klasat 10-12	4	2	-50%
Rritje mesatare për klasat 1-9 dhe 10-12			-38%

Tabela 53. Shkalla e braktisjes së shkollës në mesin e komunitetit RAE

### Shkalla e braktisjes së shkollës tek vajzat

Sipas të dhënave, 0.1% e vajzave kanë braktisur arsimin fillor dhe të mesëm dhe 0.5% kanë braktisur arsimin e lartë në vitin akademik 2019/2020.

Në vitin akademik 2020/2021, 0.04% e vajzave kanë braktisur arsimin fillor, 0.05% arsimin e mesëm dhe 0.5% arsimin e lartë.<sup>411</sup> **Një lloj progresi**

Viti	2019/20	2020/21	% Rritje	Progress
Arsimi fillor	0.1%	0.04%	- 60%	<b>3 – progres i mbrë</b>
Arsimi i mesëm	0.1%	0.05%	- 50%	<b>2 – një lloj progresi</b>
Arsimi terciar	0.5%	0.5%	0%	0 – nuk është shënuar progres
Progresi mesatar				<b>2 – një lloj progresi</b>

Tabela 54. Vlerësimi i braktisjes së shkollës nga vajzat

### Institucionet parashkollore

Në vitin akademik 2019/2020, në Kosovë ishin 44 institucione parashkollore.<sup>412</sup> Numri i institucioneve parashkollore në vitin akademik 2020/2021 ishte 49.<sup>413</sup> Këto të dhëna paraqesin një rritje prej 11.4% të numrit të institucioneve parashkollore. **Progres i pamjaftueshëm**

<sup>409</sup> KEC, Vlerësimi i Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë për vitet 2017-2021: Arritje të pamjaftueshme, maj, 2021.

<sup>410</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan Balkans Group me një zyrtar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Prishtinë, nëntor, 2022

<sup>411</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shënime statistikore: Të dhëna për arsimin parauniversitar, 2021/22 dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shënime statistikore: Të dhëna për arsimin parauniversitar, 2019/20

<sup>412</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shënime statistikore: Të dhëna për arsimin parauniversitar, 2019/20

<sup>413</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shënime statistikore: Të dhëna për arsimin parauniversitar, 2021/22




Fig 41. Numri i institucioneve parashkollore

**Në vitin 2021 është shënuar progres i pamjaftueshëm sa i përket qasjes në arsim.**

### c) Qeverisja dhe cilësia e arsimit

Mjetet e vlerësimit të qeverisjes dhe cilësisë së arsimit përfshijnë:

- vlerësimet e PISA-së;
- tekstet dhe kurikulat;
- anëtarësimi i AKA-së në ENQA; dhe
- emërimi i drejtorëve të shkollave.

#### Vlerësimet e PISA-s

Aktualisht nuk ka të dhëna të disponueshme – Vlerësimi i PISA-s për vitin 2021 do të bëhet në vitin 2022.

#### Tekstet dhe kurikulat

Në Kosovë, për vitet 2020 dhe 2021, mungojnë në masë të madhe të dhënat për cilësinë e teksteve shkollore. Në vitin 2020, MASHTI njoftoi se qeveria është duke punuar për një projektligj të ri për tekstet shkollore i cili do të përmirësonte cilësinë e teksteve shkollore.<sup>414</sup> **Nuk është shënuar progres**

#### Anëtarësimi i AKA-së në SCEA

Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) është në proces aplikimi për të rifituar anëtarësimin në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). ENQA e revokoi anëtarësimin e AKA-së në shtator 2019, për shkak të mos respektimit të rregullave dhe standardeve të saj.<sup>415</sup> **Nuk është shënuar progres**

#### Emërimi i drejtorëve të shkollave

Tek rekrutimi i drejtorëve të shkollave vërehet një progres i pamjaftueshëm në procesin e rekrutimit të bazuar në meritokraci. Kandidatët duhet t'i nënshtrohen njërit prej programeve të kualifikimit të MASHTItë, megjithatë, vendimi mbetet ende tek kryetarët e komunave, gjë që në shumë raste varet nga preferencat politike.<sup>416</sup> **Progres pamjaftueshëm**

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres në qeverisjen dhe cilësinë e arsimit.**

### d) Përafrimi me tregun e punës

Mjetet e vlerësimit të përafrimit me tregun e punës përfshijnë:

- përshtatjen e kurrikulës; dhe
- trajnimet profesionale

<sup>414</sup> KosovaPress (2022), Nagavci: me Projektligjin për tekstet shkollore synojmë të përmirësojmë cilësinë e teksteve; në: <https://kosovapress.com/en/nagavci-ëith-the-draft-laë-on-textbooks-ëe-aim-to-improve-the-quality-of-textbooks/>.

<sup>415</sup> Prishtina Insight, Agjencia Kosovare e Akreditimit e shkëputur nga organizata e rrjetit evropian, 3 tetor, 2019, në: <https://prishtinainsight.com/kosovo-accreditation-agency-axed-from-european-netëork-organization/>.

<sup>416</sup> Ministria e Arsimit, Shëndetësisë dhe Shkencës, Strategjia për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës 2016-2020.

## Përshtatja e kurikulës

Ekziston nevoja për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe trajnimeve profesionale në të gjitha nivelet dhe për përshtatjen e kurrikulave me nevojat e tregut të punës.<sup>417</sup> **Nuk është shënuar progres**

## Trajnimet profesionale

Sfidat e mëposhtme vazhdojnë t'i pengojnë shkollat e AAP-së: kurrikulat për lëndët profesionale nuk janë në përputhje me standardet profesionale, dhe kurrikulat për lëndët e përgjithshme nuk janë specifike dhe relevante për profilet përkatëse.<sup>418</sup>

Për të ndihmuar në harmonizimin e kurrikulave të Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) me nevojat e tregut të punës, LUX-DEV ka zbatuar projektin KSV/020 -Mbështetja e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (Reforma e AFP-së) në Kosovë, në të cilin objektivi kryesor është zhvillimi i kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut të punës.<sup>419</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

**Në vitin 2021 nuk është shënuar progres në përshtatjen e kurrikulave me tregun e punës.**

Siguria në arsim	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Shpenzimet në arsim	✓				
Qasja në arsim		✓			
Qeverisja dhe cilësia e arsimit	✓				
Qeverisja dhe cilësia e arsimit	✓				
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓				

Progresi i përgjithshëm për Arsimin

<sup>417</sup> Raport i Komisionit Evropian për Kosovën – Barometri i shkathtësive të Kosovës 1.0 në: <http://alled.eu/ep-content/uploads/2022/02/Kosovo-Skill-Barometer.pdf>.

<sup>418</sup> ALLED, Zbatimi i sigurimit të cilësisë në nivel të ofruesve në gjendjen e Kosovës, në: <http://alled.eu/ep-content/uploads/2021/07/Quality-assurance-ENG.pdf>.

<sup>419</sup> Shihni më shumë rreth projektit në: <https://luxdev.lu/en/activities/project/KSV/020>.



**Dimensioni VII**

---

**SHĚNDETĚSIA**

## Përmbledhje dhe analizë

BE-ja është e angazhuar për përmirësimin e shëndetit bazuar në nenin 168 të TFEU-së. Shëndeti Publik fokusohet në arritjen e objektivave të përbashkëta, gjenerimin e ekonomive në masë, bashkimin e resurseve dhe trajtimin e sfidave të përbashkëta si pandemitë, rezistencën antimikrobike, sëmundjet kronike ose ndikimin ndaj rritjes së jetëgjatësisë në sistemet e kujdesit shëndetësor.<sup>420</sup> Shëndetësia është vendosur në Bllokun III: Standardet Evropiane - Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis të BE-së në PKZMSA. Sipas MSA-së, Kosova kërkon të përmbushë kërkesat e mëposhtme: përmirësimet shëndetësore dhe parandalimin e sëmundjeve, krijimin e strukturave administrative që funksionojnë mirë, mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, përmirësimet në kujdesin dhe sigurinë shëndetësore, promovimin e jetesës së shëndetshme, etj.<sup>421</sup>


Përveç kësaj, shëndetësia është gjithashtu e vendosur në kuadrin e Shtyllës III: Punësimi, Arsimi dhe Shëndetësia, në kuadër të ERA II. Konkretisht, fokusi është në forcimin e funksioneve kryesore të sistemit shëndetësor duke hartuar strategjinë e re sektoriale shëndetësore dhe duke zbatuar politikën e përgjithshme të sigurimit shëndetësor.<sup>422</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve shëndetësore, përdoret vetëm një indikator:**

### 1. Shëndeti Publik

**Me qëllim të matjes së progresit në këtë sektor, ky indikator përdor nën-indikatorët e mëposhtëm:**

- Qasjen në kujdesin shëndetësor*- ose informacion mbi krijimin e një skeme të kujdesit shëndetësor universal, funksionimin e një sistemi informacioni shëndetësor publik, shpenzimet shëndetësore dhe qasjen e mjekëve për person/individ;
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor*- ose informacion në lidhje me kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet shëndetësore dhe nivelin e korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor;
- Menaxhimi i COVID-19*- ose të dhëna për kapacitetet e vaksinimit dhe të kujdesit shëndetësor;
- Infrastrukturën*- ose informacionet mbi personelin dhe numrin e shtretërve;
- Kornizën ligjore* - nëse ligjet dhe strategjitë janë miratuar dhe/ose janë duke u zbatuar.



Shëndeti publik dhe nën-indikatorët

<sup>420</sup> Komisioni Evropian, Shëndeti Publik, në at [https://ec.europa.eu/info/policies/public-health\\_en](https://ec.europa.eu/info/policies/public-health_en).

<sup>421</sup> Qeveria e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.

<sup>422</sup> Agjenda e Kosovës për Rrefoformë Evropiane (ERA) II, 2020.

## a) Qasja në kujdesin shëndetësor

Mjetet e vlerësimit të aksesit në kujdesin shëndetësor përfshijnë:

- skemën e kujdesit shëndetësor universal;
- sistemin informativ të shëndetit publik;
- shpenzimet në shëndetësi; dhe
- numrin e mjekëve specialistë.

### Skema e kujdesit shëndetësor universal

Pavarësisht planeve, Qeveria ende nuk e ka prezantuar Skemën Universale të Kujdesit Shëndetësor. Ligji për Sigurimet Shëndetësore (2013/04-L-249) është ende i aplikueshëm.<sup>423</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Sistemi informativ i shëndetit publik

Vlerësohet se nuk është arritur progres në mbrojtjen e shëndetit me aplikimin e pjesshëm të sistemit bazë të informacionit shëndetësor. Kjo situatë ka vënë në pah kërkesën për një shtrirje të mëtejshme të sistemit të informacionit shëndetësor.<sup>424</sup>

Në të kaluarën, një sërë pengesash kanë vështirësuar zbatimin e Sistemit të Integruar të Informacionit Shëndetësor të Unifikuar, duke përfshirë mungesën e planifikimit dhe koordinimit të aktiviteteve, vonesat në vendosjen e mekanizmave të koordinimit dhe monitorimit ndër-institucional, procedurat e stërzgjatura të prokurimit për sigurimin e pajisjeve dhe pajisjeve hardware and software, mungesa e mirëmbajtjes së sistemit, trajnimi joefikas dhe joadekuat në përdorimin e sistemit, vonesa në ofrimin në kohë të informacionit nga ana e qendrës së bazës së të dhënave dhe vonesa në sigurimin e gjendjes civile të qytetarëve.<sup>425</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Shpenzimet në shëndetësi

Në vitin 2021, Kosova ka ndarë 8.20% të buxhetit të saj për shëndetësinë.<sup>426</sup> Buxheti i përgjithshëm i vitit 2021 për sektorin e shëndetësisë është rritur me 10%, krahasuar me vitin 2020. Pavarësisht kësaj rritjeje, pjesa e përgjithshme e shpenzimeve për shëndetësi është rreth 3% e GDP-së. **Nuk është shënuar progres**

### Mjekët specialistë

Në vitin 2020, nga 3984 mjekë specialistë, 3555 ishin të angazhuar në spitale publike dhe 429 në spitale private.<sup>427</sup> Në vitin 2021 numri i mjekëve specialistë të angazhuar në spitalet publike ishte 3283 dhe i atyre në spitalet private 446 ose në total gjithsej 3729.<sup>428</sup> Kjo paraqet një rënie prej -6,4% të numrit të mjekëve specialistë në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**




Fig 42. Numri i mjekëve specialistë në spitalet publike dhe private

<sup>423</sup> Shih Portalin Shtetëror, në: <https://ëëë.rks-gov.net/AL/f263/shendetesia/sigurimet-shendetesore>.

<sup>424</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021

<sup>425</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit, Sistemi Informativ Shëndetësor përballë me vështirësi gjatë zbatimit, 29 dhjetor, 2017, në: <https://ëëë.zka-rks.org/neës/sistemi-informativ-shendetesor-ballafaqohet-me-veshtiresi-gjate-zbatimit/>.

<sup>426</sup> Ministria e Financave, broshura informative për qytetarët: Buxheti i Republikës së Kosovës – 2021 I Rishikuar.

<sup>427</sup> KAS, Health Statistics 2021 at <https://ask.rks-gov.net/media/7067/statistikat-e-sh%C3%ABndet%C3%ABsis%C3%AB-2021.pdf>

<sup>428</sup> ASK, Statistikat rreth shëndetësisë -2020 në: <https://ask.rks-gov.net/media/6320/statistikat-e-shendetesise-2020.pdf>.

**Në vitin 2021, nuk është shënuar progres sa i përket qasjes në kujdesin shëndetësor.**

## b) Cilësia e kujdesit shëndetësor

Mjetet e vlerësimit të cilësisë së kujdesit shëndetësor përfshijnë:

- *kënaqshmërinë e pacientëve; dhe*
- *korupsionin në shëndetësi.*

### Kënaqshmëria e pacientëve

Në vitin 2021, kënaqshmëria e pacientëve ndaj kujdesit shëndetësor është vlerësuar me 2.7 (në një vlerësim shkallësh nga 1 deri në 5).<sup>429</sup>

Sipas Departamentit të Mjekësisë Sociale në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për vitet 2020 dhe 2021, nuk ka të dhëna lidhur me kënaqshmërinë e pacientëve ndaj kujdesit shëndetësor.

### Korrupsioni në shëndetësi

Në vitin 2021, 71.7% e të anketuarve besonin se kujdesi shëndetësor ishte i afektuar nga korrupsioni.<sup>430</sup> Ndërsa, në vitin 2020, 73% e të anketuarve besonin se kujdesi shëndetësor ishte afektuar nga korrupsioni.<sup>431</sup> Këto shifra paraqesin një rënie prej 1.78%. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 43. Perceptimi i publikut mbi korrupsionin në shëndetësi

**Në vitin 2021 është shënuar një progres i pamjaftueshëm sa i përket cilësisë së kujdesit shëndetësor.**

## c) Masat për COVID-19

Mjetet e vlerësimit të masave për COVID-19 përfshijnë:

- *vaksinimin; dhe*
- *kapacitetet e kujdesit shëndetësor.*

### Vaksinimi

Në vitin 2021, 50% e popullsisë ishin të vaksinuar pjesërisht ndërsa 45% ishin të vaksinuar plotësisht. Kjo shënon një rritje prej 100% nga viti 2020, kur vaksinat nuk ishin të disponueshme.<sup>432</sup>

**Progres i mirë**

<sup>429</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri Ballkanik 2021, në: <https://ëëë.rcc.int/balkanbarometer/home>.

<sup>430</sup> Ibid.

<sup>431</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri Ballkanik 2020, në: [https://ëëë.rcc.int/download/docs/2020-06-Balkan-BarometerPublic-Opinion\\_final.pdf/bf27f9fc10de8a02df9db2b60596f0cd.pdf](https://ëëë.rcc.int/download/docs/2020-06-Balkan-BarometerPublic-Opinion_final.pdf/bf27f9fc10de8a02df9db2b60596f0cd.pdf).

<sup>432</sup> Shih: Ministrinë e Shëndetësisë në: <https://msh.rks-gov.net/sq/statistikat-covid-19/>.




Fig 44. Vaksinimi kundër COVID-19

## Kapacitetet e kujdesit shëndetësor

Kosova u përball me shumë sfida gjatë periudhës së COVID-19, siç është përgatitja jo e mirë e spitaleve të Kosovës për t'iu përgjigjur krizës, mungesa e oksigjenit të mjaftueshëm, furnizimeve, ventilatorëve, shtretërve spitalorë, personelit dhe pajisjeve të nevojshme për mbrojtjen e infermierëve dhe mjekëve. **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021 është shënuar progres i pamjaftueshëm në masat kundër COVID-19 në 2021.**

## d) Infrastruktura

Mjetet e vlerësimit të infrastrukturës së kujdesit shëndetësor përfshijnë:

- *shtretërit spitalorë;*
- *personelin; dhe*
- *shpenzimet për mjekim jashtë vendit.*

### Shtretërit spitalorë

Në vitin 2020, spitalet e përgjithshme kishin 1975 shtretër, ndërsa në vitin 2021 të njëjtit kishin 1986 shtretër.<sup>433</sup> Kjo paraqet një rritje të lehtë prej 0.5% të shtretërve spitalorë. **Progres i pamjaftueshëm**




Fig 45. Numri i shtretërve spitalorë

### Personeli

Në vitin 2021, 13448 ishte numri i personelit në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.<sup>434</sup> Në vitin 2020, numri për të njëjtit ishte 13518.<sup>435</sup> Këto shifra shënojnë një rënie prej 0.5% të personelit në vitin 2021. **Nuk është shënuar progres**




Fig 46. Numri i personelit shëndetësor

### Shpenzimet për mjekim jashtë vendit

Në vitin 2020 janë shpenzuar 7,999,984.49 euro për subvencione për trajtim mjekësor të qytetarëve

<sup>433</sup> ASK, Statistikat mbi Shëndetësinë, 2020, tetor 2021, në: <https://ask.rks-gov.net/media/6449/health-statistics-2020.pdf>; Statistikat mbi Shëndetësinë 2021, në: <https://ask.rks-gov.net/media/7067/statistikat-e-sh%C3%ABnder%C3%ABsis%C3%AB-2021.pdf>

<sup>434</sup> ASK, Statistikat mbi shëndetësinë për vitin 2021, në: <https://ask.rks-gov.net/media/7067/statistikat-e-sh%C3%ABnder%C3%ABsis%C3%AB-2021.pdf>

<sup>435</sup> ASK, Statistikat mbi Shëndetësinë për vitin 2020, Tetor 2021, në: <https://ask.rks-gov.net/media/6449/health-statistics-2020.pdf>



jashtë institucioneve shëndetësore publike, ndërsa në vitin 2021 për të njëjtën çështje janë shpenzuar 9,400,993.08 euro.<sup>436</sup> Në vitin 2021, 17.5% më shumë para u shpenzuan për mjekim të qytetarëve jashtë vendit. **Nuk është shënuar progres**

Viti	2020	2021
Shpenzimet për mjekim jashtë vendit	7,999,984.49 EUR	9,400,993.08 EUR
Raporti (%)		17.5%

Tabela 54. Shpenzimet për mjekim jashtë vendit

**Nuk është shënuar progres sa i përket infrastrukturës në vitin 2021.**

### e) Korniza ligjore

Mjetet e vlerësimit të kornizës ligjore ligjor në lidhje me kujdesin shëndetësor përfshijnë:

- *Ligjin për Sigurime Shëndetësore;*
- *Strategjinë e Sektorit të Shëndetësisë; dhe*
- *Strategjinë e Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor.*

#### Ligji për Sigurimet Shëndetësore

Miratimi i Ligjit për sigurime shëndetësore është vonuar.<sup>437</sup> Ligji për Sigurimet Shëndetësore i vitit 2013 është ende në fuqi.<sup>438</sup> **Nuk është shënuar progres**

#### Strategjia e Sektorit të Shëndetësisë

Në vitin 2021, disa nga sfidat që lidhen me zbatimin e pamjaftueshëm të strategjisë përfshijnë: mungesën e qasjes në kujdesin shëndetësor për 1/5 e popullsisë, shpenzimet për shërbimet diagnostikuese dhe mosrimbursimin e barnave pavarësisht qasjes falas në kujdesin shëndetësor dhe mungesa e alokimit të fondeve për nevojat bazë të kujdesit shëndetësor.<sup>439</sup> Nevojitet zbatim i mëtejshëm i strategjisë. **Nuk është shënuar progres**

#### Strategjia e Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor

Sipas të dhënave, Strategjia e Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor për vitin 2021 është miratuar.<sup>440</sup> **Progres shumë mirë**

**Në vitin 2021 është shënuar progres i kufizuar sa i përket Kornizës Ligjore.**

Shëndeti publik	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Qasja në kujdesin shëndetësor	✓				
Kujdesi shëndetësor cilësor		✓			
Masat për Covid-19		✓			
Infrastruktura	✓				
Korniza ligjore		✓			
Progresi i përgjithshëm	✓				

Progresi i përgjithshëm për Shëndetësinë

<sup>436</sup> Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prishtinë, nëntor, 2022.

<sup>437</sup> Raport i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2021, në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en).

<sup>438</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-209 në: <https://msh.rks-gov.net/ep-content/uploads/2013/11/201304-249-Laë-on-health-insurance.pdf>.

<sup>439</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021,

<sup>440</sup> Ministria e Shëndetësisë, Plani Strategjik për promovimin dhe edukimin shëndetësor i vitit 2021



**Dimensioni VIII**

---

**MARRËDHËNIET  
E MIRA  
FQINJËSORE**

## Përmbledhje dhe analizë

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë një kriter i rëndësishëm për matjen e progresit të një vendi që aspiron BE-në dhe një parakusht për paqen dhe stabilitetin në rajon.<sup>441</sup>

Në rastin e Kosovës, këtij kriteri i kushtohet rëndësi shtesë, veçanërisht në aspektin e dialogut me Serbinë. Marrëdhëniet e mira fqinjësore radhiten në kuadër të Bllokut I: Kriteret Politike të PKZMSA-së të cilat theksojnë obligimin e Kosovës për vendosjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve të mira me të gjitha vendet në rajon dhe rritjen e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, si ekonomia, siguria, të drejtat dhe liritë e njeriut etj.<sup>442</sup> Ky kriter gjithashtu fokusohet në vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe anëtarësimet e reja në iniciativat dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.<sup>443</sup>

**Për të vlerësuar nëse Kosova ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve sa i përket marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, përdoret një indikator:**

### 1. Bashkëpunimi

Ky indikator përdor një sërë nën-indikatorësh për të pasqyruar progresin në këtë sektor:

- Marrëdhëniet bilaterale* - ose informacione mbi takimet e zhvilluara dhe marrëveshjet e arritura në mes të Kosovës dhe vendeve fqinje;
- Bashkëpunimi rajonal* - ose informacione në lidhje me pjesëmarrjen e Kosovës në iniciativat rajonale, anëtarësimet në organizata të reja, zhvillimet në zbatimin e Agjendës së Gjellbër dhe Tregut të Përbashkët Rajonal;
- Dialogu me Serbinë* - ose informacion mbi procesin e dialogut të lehtësuar nga BE-ja, zbatimin e marrëveshjeve dhe identifikimin e personave të zhdukur.



Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe nën-indikatorët

#### a) Marrëdhëniet bilaterale

Mjetet e vlerësimit të marrëdhënieve bilaterale përfshijnë:

- *marrëdhëniet me Shqipërinë;*
- *marrëdhëniet me Malin e Zi;*
- *marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut; dhe*
- *marrëdhëniet me Bosnjën dhe Hercegovinën.*

#### Marrëdhëniet me Shqipërinë

Në vitin 2021 janë zhvilluar disa takime në mes të zyrtarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë. Në takimin e 7-të të përbashkët, në nëntor të vitit 2021, Kosova dhe Shqipëria nënshkruan 13

<sup>441</sup> EEAS, Mogherini: Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimi në Ballkanin Perëndimor, thelbësor për perspektivën e tyre në BE, maj, 2019, në: [https://ëëë.eeas.europa.eu/node/62177\\_en](https://ëëë.eeas.europa.eu/node/62177_en).

<sup>442</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), 2016.

<sup>443</sup> Ibid.

marrëveshje.<sup>444</sup> **Progres shumë i mirë**

### Marrëdhëniet me Malin e Zi

Kosova ka ruajtur marrëdhënie të mira me Malin e Zi. Në mars të vitit 2021, Zëvendëskryeministri i Malit të Zi vizitoi Prizrenin. Në qershor të viti 2021, Kosova dhe Mali i Zi nënshkruan një marrëveshje për eliminimin e taksës së sigurimit të automjeteve për hyrjen në territoret e tyre përkatëse.<sup>445</sup>

Në shtator të vitit 2021, Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi priti në takim të ngarkuarin e ri me punë në Ambasadën e Malit të Zi në Kosovë, Mirsad Biboviq. Diskutimi u fokusua në projekte të ndryshme infrastrukturore.<sup>446</sup> I ngarkuari i ri me Punë në Ambasadën e Malit të Zi është takuar edhe me Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Diskutimi u fokusua në projektet e përbashkëta infrastrukturore që lidhin Kosovën dhe Malin e Zi, si rruga Deçan-Plavë dhe rruga Pejë-Rozhajë si dhe menaxhimi i COVID-19.<sup>447</sup>

Në tetor të vitit 2021, Kryeministri i Kosovës zhvilloi një takim me Zëvendëskryeministrin e atëhershëm të Malit të Zi, Dritan Abazoviq. Diskutimi u fokusua në procesin e integritit evropian dhe euroatlantik, agjendën e reformave, luftën kundër korrupsionit, lehtësimin e lëvizjes së lirë dhe heqjen e barrierave që pengojnë zhvillimin më të madh ekonomik dhe investimet në të dyja vendet.<sup>448</sup> **Një lloj progresi**

### Marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut

Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë vazhduar të ruajnë marrëdhëniet e tyre të mira. Në veçanti, të dy vendet janë duke punuar për arritjen e një marrëveshjeje për hapjen e Pikës Hekurudhore Kufitare (PHK).<sup>449</sup>

Është duke u punuar gjithashtu për zgjerimin e gazsjellësit Trans-Adriatik dhe është në proces e sipër një studim fizibiliteti për gazsjellësin në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.<sup>450</sup>

Në nëntor, Kosova dhe Maqedonia e Veriut zhvilluan një takim të përbashkët, duke konfirmuar marrëdhëniet e tyre të mira dhe zbatimin e interesave të përbashkëta që sigurojnë paqen dhe stabilitetin për Ballkanin Perëndimor.<sup>451</sup>

Në vitin 2021 u zhvilluan edhe disa takime të tjera që konfirmuan marrëdhëniet e mira fqinjësore në mes të dyja vendeve. Në ndërkohë, është zhvilluar një takim në mes të Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe Presidentit të Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski. Një tjetër takim është mbajtur në mes të Kryeministrit Kurti dhe Ministrit të Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani. Ata të dy diskutuan mbi interesat e përbashkëta të vendeve dhe përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe. Zëvendëskryeministri Bislimi ka zhvilluar një takim edhe me ambasadorin e Maqedonisë së Veriut, Shpresa Jusufi. Ata kanë diskutuar për koordinimin e disa vizitave të zyrtarëve nga Kosova në Maqedoninë e Veriut.<sup>452</sup> **Progres shumë i mirë**

<sup>444</sup> Zyra e Kryeministrit: Është mbajtur mbledhja e shtatë e përbashkët e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, 2021 në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-seventh-joint-meeting-of-the-government-of-kosovo-and-the-government-of-albania-čas-held/>.

<sup>445</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2021.

<sup>446</sup> Zyra e Kryeministrit, Zëvendëskryeministri Bislimi, priti në takim të Ngarkuarin e ri me Punë në Ambasadën e Malit të Zi në Kosovë, Mirsad Biboviq, 22 shtator, 2021, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/deputy-prime-minister-bislimi-hosted-in-a-meeting-the-neë-charge-daffaires-at-the-embassy-of-montenegro-in-kosovo-mirsad-biboviq/>.

<sup>447</sup> Zyra e Kryeministrit; Zëvendëskryeministri Bislimi, priti në takim të Ngarkuarin e ri me Punë në Ambasadën e Malit të Zi për Kosovë, Mirsad Biboviq, 22 shtator, 2021, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister-kurti-hosted-in-a-meeting-the-neë-charge-daffaires-at-the-embassy-of-montenegro-in-kosovo-mirsad-biboviq/>.

<sup>448</sup> Zyra e Kryeministrit, Kryeministri Albin Kurti u takua me Zëvendëskryeministrin e Malit të Zi Dritan Abazovic, 14 tetor, 2021, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister-albin-kurti-met-ëith-deputy-prime-minister-of-montenegro-dritan-abazoviq/>.

<sup>449</sup> Ibid.

<sup>450</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>451</sup> Kryeministri i Kosovës, Takimi i përbashkët në mes të dy qeverive, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, është konfirmim i marrëdhënieve të shkëlqyera dhe zbatim i interesit të përbashkët për Ballkanin Perëndimor si rajon i paqes së qëndrueshme, 2021, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-joint-meeting-of-the-tëo-governments-the-republic-of-kosovo-and-the-republic-of-north-macedonia-is-a-confirmation-of-the-excellent-relations-and-implementation-of-common-interests-for-the-ëester/>.

<sup>452</sup> Kryeministri i Kosovës, Kryeministri Kurti priti Presidentin e Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, më 15 dhjetor, 2021 në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister-kurti-received-the-president-of-north-macedonia-stevo-pendarovski/>.

## Marrëdhëniet me Bosnjën dhe Hercegovinën

Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina nuk kanë zhvilluar ende marrëdhënie formale/zyrtare. Bosnja dhe Hercegovina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, gjithashtu ekziston një regjim i rreptë i vizave ndërmjet të dy vendeve.<sup>453</sup> **Nuk është arritur progres**

**Një lloj progresi është arritur gjatë vitit 2021 sa i përket marrëdhënieve bilaterale.**

### b) Bashkëpunimi rajonal

Mjetet e vlerësimit të bashkëpunimit rajonal përfshijnë:

- *marrëveshjet e nënshkruara;*
- *Tregun e Përbashkët Rajonal;*
- *Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor*
- *Strategjinë për anëtarësim dhe pjesëmarrje në organizatat rajonale;*
- *anëtarësimin në organizata të reja; dhe*
- *bashkëpunimin në iniciativat rajonale.*

### Marrëveshjet e nënshkruara

Marrëveshja rajonale për tarifën e roaming-ut “roam (bredh) si në shtëpi” (MRTR), e nënshkruar në Samitin Dixhital të Ballkanit Perëndimor në Beograd, filloi zbatimin në korrik të vitit 2021.<sup>454</sup>

Përveç kësaj, Kosova vazhdon të mbajë marrëdhënie të shkëlqyera politike, ekonomike dhe kulturore me Turqinë. Në qershor të vitit 2021, në kuadër të Samitit të SEECIP-së u mbajtën një sërë takimesh.<sup>455</sup> Asnjë marrëveshje tjetër nuk është raportuar për këtë periudhë kohore. **Një lloj progresi**

### Tregu i përbashkët rajonal (TPR)

Në vitin 2021, u emërua Sherpa ose Koordinatori Kombëtar i Procesit të Berlinit, këshilltari Kryeministrit për i cili ndër tjera është përgjegjës për zbatimin e TPR-së.<sup>456</sup> Sherpa koordinon dhe drejton katër grupe pune për TPR: Grupin Punues për marrëveshjen e lëvizjes së lirë me karta identiteti, Grupin Punues për marrëveshjen për lëvizjen e shtetasve të vendeve të treta në Ballkanin Perëndimor, Grupin Punues për marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve akademike dhe Grupin Punues për marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve profesionale të doktorëve të mjekësisë, stomatologëve dhe arkitektëve.<sup>457</sup> **Një lloj progresi**

### Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2020, qeveria miratoi një sërë aktesh ligjore dhe dokumentesh në lidhje me Agjendën e Gjellbër të Ballkanit Perëndimor.<sup>458</sup>

Në vitin 2021, qeveria miratoi akte ligjore të tjera në lidhje me mbrojtjen e specieve, mbetjet, ndotjen, pyjet si dhe mbrojtjen e tokës bujqësore. Sa i përket impianteve të mëdha me djege (IMG), Kosova ka përparuar dukshëm me miratimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e IMG-së dhe Direktivës për Emetimet Industriale në korrik të vitit 2021.<sup>459</sup> **Një lloj progresi**

<sup>453</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

<sup>454</sup> Ibid.

<sup>455</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën .

<sup>456</sup> Raporti i Grupit për Ballkan, Kosova në Iniciativat Rajonale: Korniza Institucionale dhe Koordinimi, 2021.

<sup>457</sup> Ibid

<sup>458</sup> Koncepti Dokumenti për Ndryshimet Klimatike, Udhëzimi Administrativ (UA) nr. 01/2020 për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, UA nr. 11/2020 për përcaktimin e kërkesës teknike dhe kërkesave të tjera për qeset plastike dhe UA nr. 12/2020 për përcaktimin e llojeve të egra të bimëve dhe mbrojtjen e tyre dhe mbrojtjen rreptësisht të kafshëve

<sup>459</sup> UA Nr. 07/2021 për rregullat dhe standardet e shkarkimeve për emetimet në ajër nga burimet stacionare të ndotjes, Koncepti Dokumenti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, UA për emetimet në ajër nga burimet stacionare të ndotjes, Strategjia për zhvillimin e pyjeve 2022-2030, Strategjia për komunikim dhe Informacion për Sektorin e Pylltarisë në Kosovë 2021-2025, “Task Force” për Mbrojtjen dhe Përdorimin Ligjor të Pyjeve, miratimi i termave të referencës për funksionimin e kësaj task force, miratimin e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-

## Strategjia për anëtarësim në organizatat rajonale

Qeveria ende nuk ka krijuar një qasje strategjike do të rriste anëtarësimin dhe pjesëmarrjen në organizata dhe iniciativa të reja rajonale.<sup>460</sup> **Nuk është shënuar progres**

### Anëtarësimi në organizata të reja

Kosova mbetet e nënpërfaqësuar në organizatat dhe iniciativat rajonale. Kosova i është bashkuar disa nismave të rëndësishme rajonale si Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Traktati i Komunitetit të Transportit (TCT), Komuniteti i Energjisë (EnC), Iniciativa Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI), Organizata Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), ose Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF).<sup>461</sup>

Gjatë vitit 2021, Kosova nuk është anëtarësuar ndonjë organizate të re rajonale. **Nuk është shënuar progres**

### Bashkëpunimi në iniciativat rajonale

Kosova ka një përfaqësim të ulët në organizatat dhe iniciativat rajonale. Në veçanti, Kosova merr pjesë në organizatat dhe iniciativat e mëposhtme rajonale, duke përfshirë Iniciativën Brdo-Brijuni, Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (EnN), Iniciativën Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI), Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO), Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Traktatin e Komunitetit të Transportit (TCT) dhe Fondin e Ballkanit Perëndimor (WBF).<sup>462</sup>

Megjithatë, Kosova është anëtare e plotë vetëm në gjashtë organizatat dhe iniciativat e mëposhtme: Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR), Traktati i Komunitetit të Transportit (TCT), Komuniteti i Energjisë (EnN), Iniciativa Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI), Organizata Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO), dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF).<sup>463</sup>

Në vitin 2021, Kosova nuk arriti t'i bashkohet asnjë initiative të re rajonale. **Nuk është shënuar progres**

**Në vitin 2021 është shënuar progres i pamjaftueshëm sa i përket bashkëpunimit rajonal.**

## c) Dialogu me Serbinë

Mjetet e vlerësimit të dialogut me Serbinë përfshijnë:

- *dialogun e lehtësuar nga BE-ja;*
- *zbatimin e marrëveshjeve; dhe*
- *personat e zhdukur.*

### Dialogu i lehtësuar nga BE-ja

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është duke vazhduar.<sup>464</sup> Dialogu rifilloi në vitin 2020 pasi që Kosova hoqi tarifën 100% për mallrat e importuara nga Serbia.<sup>465</sup> Raporti i Komisionit Evropian për vendin për vitin 2021 thekson detyrimin e Kosovës në mbajtjen e përkushtimit të saj për zbatimin e marrëveshjeve të mëhershme të arritura në dialog me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare zyrtare dypalëshe me Serbinë.<sup>466</sup> **Nuk është shënuar progres**

<sup>2028</sup>, dhe Koncept Dokumenti për Tokat Bujqësore

<sup>460</sup> Raporti i Grupit Ballkanik, Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi i Kosovës në Organizatat Rajonale - Hartimi i boshllëqeve dhe mundësive, 2021.

<sup>461</sup> Ibid.

<sup>462</sup> Ibid.

<sup>463</sup> Ibid.

<sup>464</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021

<sup>465</sup> Ibid.

<sup>466</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021 Report, 2021.

## Zbatimi i marrëveshjeve

Nga të gjitha marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (në kuadër të dialogut të udhëhequr nga BE-ja), disa janë zbatuar mjaftueshëm, disa pjesërisht, ndërsa të tjerat nuk janë zbatuar fare. Kjo është pjesërisht për shkak të rritjes së tensioneve nga të dyja palët.<sup>467</sup>

Në vitin 2021, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje për targa pas vendimit të Kosovës për të aplikuar masat e reciprocitetit. Marrëveshja është duke u zbatuar dhe grupet e punës vazhdojnë të takohen në Bruksel.<sup>468</sup> **Progres i pamjaftueshëm**

## Personat e zhdukur

Janë ende 1639 persona të zhdukur të identifikuar nga lufta e fundit në Kosovë.<sup>469</sup> **Nuk është shënuar progres**

Bashkëpunimi	Nuk është shënuar progres	Progres i kufizuar	Një lloj progresi	Progres i mirë	Progres shumë i mirë
Marrëdhëniet bilaterale			✓		
Bashkëpunimi rajonal		✓			
Dialogu me Serbinë	✓				
Progresi i përgjithshëm		✓			

Progresi i përgjithshëm për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë

**Në vitin 2021 nuk është shënuar asnjë progres sa i përket dialogut me Serbinë.**

<sup>467</sup> Raporti i Grupit për Ballkan, Dialogu i Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Arritjet dhe Sfidat, shtator, 2020

<sup>468</sup> Regjimi i Ngjites së Targave Kosovë-Serbi hyn në fuqi më 4 tetor, 2021, në: <https://balkaninsight.com/2021/10/04/kosovo-serbia-license-plates-sticker-regime-comes-into-force/>.

<sup>469</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021, .

## ANEKSI I. PROGRESI I KOSOVËS NË NUMRA

Me qëllim të matjes së progresit të shënuar në Kosovë për vitin 2021, është përdorur një metodologji unike me 8 dimensione: Sundimi i Ligjit, Të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, Demokratizimi, Ekonomia, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Arsimi, Shëndetësia dhe Marrëdhëniet e Fqinjësisë së Mirë. Çdo dimension përfshin 14 indikatorë dhe 65 nën-indikatorë. Nën-indikatorët përdorin 235 mjete vlerësimi të cilat janë zhvilluar si kritere për vlerësimin e progresit të arrirë në sektorin/fushën specifike. Bazuar në metodologji, progresi i institucioneve paraqitet në pesë nivele: nuk është shënuar progres, 'progres i pamjatuësishëm', 'një lloj progresi', 'progres i mirë' dhe 'progres shumë i mirë', në varësi të zhvillimeve të shënuara në vitin 2021, në krahasim me vitin paraprak (2020). Përveç kësaj, ky seksion paraqet progresin në vlera numerike (duke përdorur shkallët 0-4), ku 0 është e barabartë me nuk është shënuar progres, 1 – progres i pamjaftueshëm, 2 – një lloj progresi, 3 – progres i mirë dhe 4 - progres shumë i mirë.

### DIMENSIONI I: SUNDIMI I LIGJIT (SL)

Progresi në fushën e sundimit të ligjit është vlerësuar si i kufizuar me një rezultat të përgjithshëm prej 1.57/4. Në mesin e indikatorëve, progresi në gjyqësor është më i dukshëm (2/4), i ndjekur nga lufta kundër korrupsionit (1, 45/4) dhe lufta kundër krimit të organizuar (1,26/4). Në kuadër të gjyqësorit, institucionet e Kosovës kanë arritur progres shumë të mirë në kornizën ligjore (4/4), progres të mirë në llogaridhënie (3.5/4), një lloj progresi në efikasitet dhe efektivitet (2/4), dhe progres të pamjaftueshëm në transparencë (1.6 /4), qasje në drejtësi (1.3/4), administrim të drejtësisë (1.4/4) si dhe pavarësi dhe paanshmëri (0.3/4). Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, vërehet një lloj progresi në konfiskimin e pasurisë (3/4) dhe kornizën ligjore (2/4), progres i pamjaftueshëm në perceptimin publik mbi korrupsionin (1/4) e parandalimin e tij (0,3/4) si dhe nuk është shënuar progres në masat kundër korrupsionit të nivelit të lartë (0.7/4). Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, është arritur progres i mirë në masat kundër trafikimit të personave (3.75/4), progres i pamjaftueshëm është shënuar në masat kundër krimit të organizuar (1.25/4), terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (1/4) dhe kornizës ligjore (1/4), ndërsa nuk është shënuar progres në luftën kundër drogës/narkotikëve (0.6/4) dhe/apo pastrimit të parave (0/4).

SUNDIMI I LIGJIT (SL)	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Gjyqësori</b>						
Efikasiteti dhe efektiviteti			✓			2
Pavarësia dhe paanshmëria	✓					0,3
Llogaridhënia				✓		3,5
Transparenca		✓				1,6
Qasja në drejtësi		✓				1,3
Administrimi i Drejtësisë		✓				1,4
Korniza Ligjore					✓	4
<b>Progresi i përgjithshëm</b>			✓			<b>2</b>
<b>Lufta kundër korrupsionit</b>						
Perceptimi publik mbi korrupsionin		✓				1
Parandalimi	✓					0,3
Masat kundër korrupsionit të nivelit të lartë	✓					0,7
Konfiskimi i pasurisë				✓		3
Korniza ligjore			✓			2



Progresi i përgjithshëm		✓				1,4
<b>Lufta kundër krimit të organizuar</b>						
Niveli i krimit të organizuar						-
Masat kundër krimit të organizuar		✓				1,25
Droga/narkotikët	✓					0,6
Pastrimi i parave	✓					0
Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm		✓				1
Trafimi i qenieve njerëzore				✓		3,75
Korniza ligjore		✓				1
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓				<b>1,26</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI II: TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË THEMELORE

Vlerësimi në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore raportohet të jetë pa asnjë progres me një rezultat të përgjithshëm prej 0.95/4. Progresi në të drejtat civile dhe politike (1.12/4) dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (1/4) është i pamjaftueshëm, ndërsa nuk ka progres sa i përket kornizës ligjore (0.75/4). Në kuadër të të drejtave civile dhe politike, është raportuar progres i mirë në barazinë gjinore, veçanërisht në lidhje me përfaqësimin e grave në nivel qendror, një lloj progresi është shënuar sa i përket të drejtave të fëmijëve pasi ka filluar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijut, ndërsa nuk vërehet përparim në lirinë e shprehjes, lirinë e fesë ose lirinë e organizimit.

TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË THEMELORE	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Të Drejtat Themelore</b>						
Të drejtat civile dhe politike		✓				1.12
Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore		✓				1
Korniza ligjore	✓					0.75
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓					<b>0.95</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI III: DEMOKRATIZIMI

Progresi në fushën e demokratizimit është i pamjaftueshëm me një rezultat të përgjithshëm prej 1.5/4. Progresi në media dhe shoqërinë civile (1.5/4), sa përket zgjedhjeve (1.6/4) dhe administratës publike (1/4) është i pamjaftueshëm, ndërsa progresi në stabilitetin politik është i mirë (2.13/4). Në kuadër të mediave dhe shoqërisë civile, mund të themi se është shënuar një lloj progresi sa i përket shoqërisë civile (2.66/4), progres i pamjaftueshëm në lirinë e medias (1.75/4) ndërsa nuk është shënuar progres kur kemi të bëjmë me kornizën ligjore (0). Në kuadër të stabilitetit politik, ekziston një lloj progresi që ka të bëjë me sigurinë dhe rendin publik (2.25/4), rendin kushtetues dhe ligjor (2.3/4), marrëdhëniet midis qeverisë dhe opozitës (2/4) dhe funksionimin e institucioneve (2/4). Në kuadrin e zgjedhjeve, sipas të dhënave është shënuar një lloj progresi në administratën zgjedhore (2.8/4) dhe mjedisin e fushatës (2/4), progres i pamjaftueshëm në përfaqësimin e grave (1.16/4) dhe nuk është shënuar progres sa i përket kornizës ligjore (0.5). Brenda administratës publike, një lloj progresi është arritur në financat publike (2.3/4), progres i

pamjaftueshëm në funksionimin e administratës publike (1.33/4) dhe nuk është arritur progres në ofrimin e shërbimeve (0.66/4), përfaqësimin (0.5/4) dhe kornizën ligjore (0.25/4).

DEMOKRATIZIMI	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Media dhe Shoqëria Civile</b>						
Liria e medias		✓				1.75
Shoqëria civile			✓			2.66
Korniza ligjore	✓					0
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓				<b>1.5</b>
<b>Stabiliteti politik</b>						
Funksionimi i institucioneve			✓			2
Siguria dhe Rendi Publik			✓			2.25
Marrëdhëniet në mes të qeverisë dhe opozitës			✓			2
Rendi kushtetues dhe juridik			✓			2.3
<b>Progresi i përgjithshëm</b>			✓			<b>2.13</b>
<b>Zgjedhjet</b>						
Administrimi i zgjedhjeve			✓			2.8
Mjedisi i fushatës			✓			2
Korniza ligjore	✓					0.5
Pjesëmarrja e grave		✓				1.16
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓				<b>1.6</b>
<b>Administrata Publike</b>						
Funksionimi i administratës publike		✓				1.33
Ofrimi i shërbimeve	✓					0.66
Financat publike			✓			2.3
Përfaqësimi	✓					0.5
Korniza ligjore	✓					0.25
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓				<b>1</b>
<b>Demokratizimi</b>						
Media dhe shoqëria civile		✓				1.5
Stabiliteti politik			✓			2.13
Zgjedhjet		✓				1.6
Administrata publike		✓				1
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓				<b>1.5</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI IV: EKONOMIA

Sipas të dhënave, nuk ka progres të shënuar sa i përket ekonomisë në tërësi, megjithëse raportohet për një progres të pamjaftueshëm sa i përket punësimit dhe sigurisë në punë (1/4). Nuk është shënuar progres sa i përket mjedisit të biznesit (0.33/4), investimeve (0.5/4), stabilitetit makroekonomik (0.75/4), kapitalit njerëzor (0/4) dhe kornizës ligjore (0.33/4). Mosbalancimi tregtar, një hendek i konsiderueshëm midis firmave /bizneseve të sapo regjistruara dhe atyre të mbyllura/shuara, një sektor i madh i ekonomisë informale, investime të pamjaftueshme të huaja direkte dhe niveli i lartë i papunësisë, janë disa nga sfidat e pranishme në këtë dimension.

EKONOMIA	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Zhvillimi ekonomik</b>						
Stabiliteti makroekonomik	✓					0.75
Mjedisi i biznesi	✓					0.33
Investimet	✓					0.5
Punësimi dhe siguria në punë		✓				1
Kapitalit njerëzor	✓					0
Korniza ligjore	✓					0.33
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓					<b>0.5</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI V: ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Sipas të dhënave, është shënuar progres i pamjaftueshëm sa i përket mjedisit (1/4), dhe nuk është bërë progres në energji (0, 76/4). Në kuadër të energjisë, është shënuar progres i pamjaftueshëm në fushën e energjisë së ripërtëritshme/ rinovueshme (1.3/4) dhe efikasitetit të energjisë (1.25/4), por nuk ka progres sa i përket furnizimit me energji (0.5/4) apo kornizës ligjore (0/4). Ndërsa në kuadër të mjedisit, është shënuar progres i pamjaftueshëm në cilësinë e ajrit (1.25/4) dhe menaxhimin e mbeturinave (1/4), ndërsa nuk ka progres sa i përket kornizës ligjore (0/4) dhe menaxhimit të ujit dhe të tokës (0.4/4). Sipas raportimit, janë të nevojshme përmirësimet në kornizën ligjore, rritjen e furnizimit me energji, diversifikimin e burimeve të energjisë, miratimin e një plani kombëtar të integruar mbi klimën dhe energjinë, arritjen e përputhshmërisë me tavanin e emetimeve dhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Energjia</b>						
Furnizimi me energji	✓					0.5
Efikasitetit të energjisë		✓				1.25
Energjia e rinovueshme		✓				1.3
Korniza ligjore	✓					0
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓					<b>0.76</b>

Mjedisi						
Cilësia e ajrit		✓				1.25
Menaxhimi i ujit dhe i tokës	✓					0.4
Menaxhimi i mbetjeve		✓				1
Menaxhimi i pyjeve		✓				1.33
Korniza ligjore						0
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓	✓				<b>1</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI VI: ARSIMI

Ndonëse mungojnë të dhënat për sektorin e arsimit si për vitin 2021 ashtu edhe për vitin 2020, bazuar në të dhënat e disponueshme, nuk raportohet progres dhe se rezultati i përgjithshëm vlerësohet të jetë 0.77/4. Për sa i përket indikatorëve, të dhënat tregojnë se është shënuar progres i pamjaftueshëm sa i përket qasjes në arsim (1.5/4), megjithatë, nuk vërehet përparim në qeverisjen dhe cilësinë e arsimit (0.3/4), shpenzimet në arsim (0.5/4) dhe përafrimin me tregun e punës (0,5/4). Pandemia sigurisht që ka ndikuar në cilësinë e arsimit, por shumica e pengesave në lidhje me dimensionin mbi arsimin kanë vazhduar të jenë prezent edhe me kalimin e kohës. Rritja e shpenzimeve për arsimin, rritja e shkallës së regjistrimit të studentëve në arsimin terciar dhe përafrimi i kurrikulave me nevojat e tregut të punës janë disa nga fushat ku progresi ka ngecur. Për më tepër, prodhimi i më shumë të dhënave për sektorin mund të sigurojë një kuptim dhe qartësim më të mirë të progresit të arritur më këtë fushë.

ARSIMI	0	1	2	3	4	Progresi në numra
Educational provision						
Shpenzimet në arsim	✓					0.5
Qasja në arsim		✓				1.5
Qeverisja dhe cilësia në arsimi	✓					0.3
Përafrimi me tregun e punës	✓					0.5
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓					<b>0.77</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI VII: SHËNDETI

Sipas të dhënave, nuk është bërë progres në shëndetin publik me një rezultat të përgjithshëm prej 0.82/4. Për sa i përket indikatorëve, është shënuar një progres i pamjaftueshëm për Covid-19 (1.5/4) kryesisht lidhur me vaksinimin. Raportohet për një progres të kufizuar në kujdesin shëndetësor cilësor (1/4), dhe kornizën ligjore (1,3/4), por nuk raportohet përparim në qasjen në kujdesin shëndetësor (0/4), dhe infrastrukturë (0,3/4). Infrastruktura dhe kapacitetet e dobëta shëndetësore, mungesa e një sistemi të kujdesit shëndetësor universal dhe zbatimi i pamjaftueshëm i një sistemi të informacionit shëndetësor janë disa nga fushat thelbësore që kanë nevojë për përshtatje dhe përmirësim.

SHËNDETI	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Shëndeti Publik</b>						
Qasja në kujdesin shëndetësor	✓					0
Kujdesi shëndetësor cilësor		✓				1
Masat për Covid-19		✓				1.5
Infrastruktura	✓					0.3
Korniza ligjore		✓				1.3
<b>Progresi i përgjithshëm</b>	✓					<b>0.82</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë

## DIMENSIONI VIII: MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË

Sipas vlerësimit, është shënuar progres i pamjaftueshëm në fushën e marrëdhënieve të fqinjësisë së mire me një rezultat të përgjithshëm prej 1.28/4, megjithatë, përcaktimi sasior i progresit në këtë fushë është më i vështirë në krahasim me dimensionet e tjera. Në mesin e indikatorëve, është shënuar një lloj progresi sa i përket marrëdhënieve bilaterale/ dypalëshe (2.5/4), ndërsa nuk ka pothuajse fare progres në aspektin e bashkëpunimit rajonal (1/4) dhe dialogut me Serbinë (0.3/4).

MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË	0	1	2	3	4	Progresi në numra
<b>Bashkëpunimi</b>						
Bilateral Relations			✓			2.5
Bashkëpunimi Rajonal		✓				1
Dialogu me Serbinë	✓					0.33
<b>Progresi i përgjithshëm</b>		✓				<b>1.28</b>

0 - Asnjë progres | 1 - Progres i kufizuar | 2 - Një lloj progresi | 3 - Progres i mirë | 4 - Progres shumë i mirë



Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë e pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvojë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigorozë, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme, për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikat, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumented he platforma të reja:

**Dialogu Politik** promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave.

**Forumi I Politikave** (një Forum I Avokimit të Nivelit të Lartë-Mendimtar) u angazhua për të përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucionale.

**Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi** (një Forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile) synon të komunikojë, promovojë dhe forcojë dialogun drejt normalizimit të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

**Gratë në politikë** promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazhohet të forcoj ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

**Platforma për Dialogun** promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut.

**Komponenti i Mbështetjes nga Eksportët** siguron mbështetje për qeverinë dhe institucionet kryesore në fushat e politikave, paqes dhe agjendat e shtet-ndërtimit.



Norwegian Embassy